



The World Bank Centre for Financial Reporting Reform

Raportit për respektimin e standardeve
dhe kodeve të kontabilitetit dhe auditimit

Azhurnim

Kosova

Qershor 2012

Shkurtesat kryesore	ii
Falënderimet	iii
Përmbledhje Ekzekutive	iv
I. Sfondi.....	1
I.A Programi RRSK.....	1
I.B Konteksti ekonomik	2
II. Korniza e kontabilitetit dhe auditimit: Ndryshimet kryesore nga viti 2006 ..8	
II.A Korniza ligjore	8
II.B Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit.....	14
II.C Arsimi dhe aftësimi për kontabilitet	15
II.D Vendorsja e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit.....	18
II.E Zbatimi i standardeve të kontabilitetit dhe auditimit.....	20
III. Praktikat e vëzhguara të raportimit dhe auditimit	21
III.A Statusi i aprovimit të SNRF-ve në Kosovë	21
III.B Rishikimi i pasqyrave financiare.....	22
III.C Perceptimet e cilësisë së raportimit financiar	22
IV. Rekomandimet.....	24
Aneks 1. Përmbledhja e rishikimit të pasqyrave financiare	27
Aneksi 2: Statusi i rekomandimeve të RRSK K&A të vitit 2006	29
Aneksi 3: Tabela e Përputhshmërisë (DRAFT)	33

Shkurtesat kryesore

ACCA	Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar
AMIK	Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës
AKM	Autoriteti Kosovar i Mirëbesimit
BE	Bashkimi Evropian
BQK	Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BSNAK	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit në Kontabilitet (ish EDCOM)
BSNAS	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë
BSNK	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit
DOA	Deklarata e Obligimit të Anëtarësisë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IDH	Investimet Direkte të Huaja
IFJ	Institucion Financiar Jobankar
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
KISNRF	Komiteti i Interpretimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
KKRF	Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MSA	Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit
NMV	Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla
NPP	Ndërmarrje në Pronësi Publike
NPP	Ndërmarrje në Pronësi Shoqërore
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
RRSK	Raportet për Respektimin e Standardeve dhe Kodeve
SHKÇAK	Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
SIP	Subjekt i Interesit Publik
SKK	Standardet e Kontabilitetit të Kosovës
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNE	Standardi Ndërkombëtar i Edukimit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

VALUTA: EURO

Zëvendës Presidenti Rajonal	Philippe H. Le Houerou
Drejtori/esha ei Shtetit	Jane Armitage
U.D. Menaxheri i Shtetit	Marius Koen
Shefi i CFRR	Henri Fortin
Udhëheqësi i ekipit të detyrës	Jan Tyl

Falënderimet

Ky raport është përgatitur nga një ekip i kryesuar nga Jan Tyl (ECCAT) i Bankës Botërore dhe Akram El-Shorbagi (MNAFM), Lulzim Zeka (Konsultant) dhe Anna Czarniecka (Konsultant), në bazë të një rishikimi diagnostik të kryer nga tetori 2011 deri në prill 2012. Rishikimi është kryer nëpërmjet një procesi pjesëmarrës që përfshiu palë të ndryshme të interesuara vendore, me përkrahjen e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës (BQK), profesionin e kontabilitetit dhe profesionistët vendorë, bashkësitë vendore akademike dhe të biznesit si dhe Zyrën e Bankës Botërore në Prishtinë. Komentet dhe sugjerimet janë marrë nga Denis Boskovski (ECCMK), Liam Coughlan (ECCAT), Henri Fortin (ECCAT), Jon Hooper (Këshilli i Raportimit Financiar i MB), si dhe Jamil Sopher (Konsultant), si dhe nga KKRF. Ekipi i detyrës i falënderon të gjithë për mbështetjen dhe komentet e marra.

Raporti është aprovuar për botim nga Ministria e Financave më 15 prill 2013.

Përmbledhje Ekzekutive

i. Ky raport është një azhurnim i Raportit të vitit 2006 për Respektimin e Standardeve dhe Kodeve (RRSK) në kontabilitet dhe auditim (K & A) në Republikën e Kosovës (Kosovë). Objektivi kryesor i RRSK 2006 ka qenë për të ndihmuar Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të atëhershme në forcimin e praktikave të K&A, për të përkrahur rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe për të përmirësuar aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve vendore. Për këtë azhurnim, një fokus i veçantë është vendosur në analizimin e ndryshimeve të rëndësishme në (a) kornizën ligjore për standardet dhe praktikën e K&A; (b) profesionin e K&A; (c) cilësinë e arsimit të kontabilitetit në nivel terciar; (d) zbatimin e kërkesave të K&A si brenda profesionit ashtu edhe nga rregullatorët në sektorin financiar dhe (ç) standardet e raportimit financiar në sektorin bankar. Raporti fokusohet edhe në vlerësimin e shkallës së përafrimit të kornizës institucionale të Kosovës për raportimin financiar të korporatave me *acquis communautaire* të BE¹. Ky azhurnim i RRSK K&A do të japë gjithashtu kontribut në azhurnimin e Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (PVSF).

ii. Kosova është një kandidat potencial për anëtarësim në BE dhe ka një popullsi të vlerësuar të jetë 1,800,000 në vitin 2010. Bruto produkti vendor (BPV) i saj për kokë banori është vlerësuar të jetë 3,059 \$ në vitin 2010. Përdorimi i euros si valutë lokale de facto ka zvogëluar dukshëm luhatjet e kursit të këmbimit dhe ka ndihmuar që inflacioni të mbahet i ulët. Ekonomia e Kosovës varet shumë nga dërgesat e emigrantëve. Duke pasur parasysh ambiciet e shtetit për të hyrë në BE, ky raport i azhurnuar bën krahasimin e kornizës së raportimit financiar të korporatave në Kosovë me përvojën ndërkombëtare dhe praktikën e mira në kontabilitet dhe auditim, kryesisht në shtetet anëtare të BE, në mënyrë që të vlerësohet cilësia e informacionit financiar dhe të jepen rekomandime të politikave.

iii. Edhe pse Banka Botërore, Komisioni Evropian dhe USAID-i kanë dhënë përkrahje të qëndrueshme për reformë që nga viti 2006, situata e raportimit financiar të korporatave nuk ka ndryshuar në mënyrë dramatike që nga RRSK i fundit. Ndryshimi më i rëndësishëm ishte miratimi i një ligji të ri të raportimit financiar në korrik 2011 dhe ngritja e pragut për kërkesë ligjore për auditim. Edhe pse ligji i ri e afron kornizën ligjore me *acquis*, do të kërkohej edhe ndryshime tjera për të arritur harmonizim të plotë me *acquis*.

iv. Në sektorin financiar, rregulloret që kërkojnë kujdes dhe mbikëqyrja e kujdesshme janë forcuar ndjeshëm. Ligji i ri për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (Ligji i ri për bankat) u miratua në prill 2012. Ende nuk ka treg të letrave me vlerë në Kosovë.

v. Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë është zhvilluar shpejt gjatë viteve të fundit dhe organizata kombëtare profesionale, SHKÇAK, u bë anëtare e Federatës

¹ *Acquis communautaire* është një term francez që i referohet tërësisë së përgjithshme të ligjeve të Komunitetit Evropian, i përbërë nga objektivat e KE-së, rregullat thelbësore, politikat dhe, në veçanti, legjislacioni primar dhe sekondar dhe e drejta precedente - të gjitha të cilat janë pjesë e rendit juridik të Bashkimit Evropian (BE). Kjo përfshin të gjitha traktatat, rregulloret dhe direktivat e miratuara nga institucionet e BE-së, si dhe gjykimet e dhëna nga ana e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. *Acquis* është dinamik, vazhdimisht zhvillohet siç ndryshon Komuniteti, dhe është fundamental. Shtetet Anëtare janë të detyruara ta respektojnë atë (www.eurofound.europa.eu/areas/industrialrelations/dictionary/definitions/acquiscommunautaire.htm).

Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) në vitin 2010. SHKÇAK përballet me sfida të rëndësishme për përmirësimin e detyrimeve të veta si anëtar i FNK, sidomos në lidhje me fushat e etikës, sigurimit të cilësisë dhe disiplinës. Ka pasur pak progres në integrimin e arsimimit për kontabilitet në universitete me kualifikimet profesionale, megjithatë, në këtë fushë kërkohen më shumë përpjekje.

vi. Në anën e përputhshmërisë, ndryshimi më i rëndësishëm që nga viti 2006 është përmirësimi brenda organit të mbikëqyrjes bankare. Zbatimi i kërkesave të kontabilitetit në mesin e subjekteve jo-bankare mbetet një sfidë dhe ka pasur pak përmirësim që nga viti 2006. Rregullatori i raportimit financiar në Kosovë, Bordi i Kosovës për Standardet mbi Raportimin Financiar (BKSFR), që kurrë nuk ka qenë plotësisht funksional, është zëvendësuar nga Këshilli i Kosovës për Raportimin Financiar (KKRF) në vitin 2011. Megjithatë nuk është bërë asnjë ndryshim i rëndësishëm në modelin operativ të rregullatorit dhe, përveç nëse kjo trajtohet, ka shumë mundësi që KKRF do të ndjekë gjurmët e BKSFR-së. Ende duhet të ndërmerren hapa drejt themelimit të një sistemi të sigurimit të cilësisë në përputhje me Direktivën e Auditimit Ligjor në BE.

vii. RRSK i K&A në vitin 2006 pati paraqitur një varg rekomandimesh. Deri më sot, nuk është vepruar për të zbatuar shumë nga këto rekomandime, dhe për shumicën prej tyre që janë zbatuar ende ka nevojë për punë shtesë.

Përmbledhje e rekomandimeve

viii. Ndërsa të gjitha rekomandimet e politikave të parashtruara në Seksionin VI të këtij raporti janë të rëndësishme, ka disa tema thelbësore, të cilat ekipi i RRSK i konsideron të jenë "faktorët kritikë të suksesit" për zhvillimin e rritjes së besueshme dhe efikase të infrastrukturës së raportimit financiar, rritjen ekonomike (duke përfshirë mobilizimin e kapitalit investues) dhe luftën kundër korrupsionit.

ix. Këta faktorë kritikë të suksesit bazohen në katër parime si në vijim:

- **Qartësia e objektivave për reformë** – që përpjekjet për përafrimin me *acquis* të kenë sukses, është e rëndësishme që të identifikohen mangësitë dhe të trajtohen si duhet me ndryshimin e legjislacionit përkatës. Ekipi i RRSK ka përgatitur draft tabelat preliminare të përputhshmërisë (krahimit) që do të diskutohen me Ministrinë e ekonomisë dhe financave (MEF);
- **Implementimi efektiv** – ndryshimi i legjislacionit nuk do të zgjidhë sfidat në vetvete. Legjislacioni duhet të implementohet dhe të zbatohet dhe një zyrtar duhet të caktohet për mbikëqyrjen dhe koordinimin e procesit të reformës;
- **Kapaciteti institucional** – Institucionet e krijuara për të mbikëqyrur dhe për të zbatuar respektimin e ligjit duhet të kenë personel adekuat dhe teknikisht të jenë kompetente. "Kompetenca" në këtë kontekst përfshin aftësinë për të kuptuar dhe interpretuar standardet relevante ndërkombëtare dhe rregulloret në fuqi në Kosovë.
- **Aleancat** – ku ka nevojë të forcohet kapaciteti, palët duhet të punojnë së bashku për të arritur rezultatet e dëshiruara.

x. Bazuar në këto parime, veprimet e prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme janë identifikuar dhe janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme. Në mënyrë që të trajtohen me sukses, një plan veprimi që përmban hapat e ardhshëm do të ishte shumë i dobishëm. REPARIS rajonal ofron një platformë, ku mund të formulohet dhe diskutohet një plan i tillë, duke shfrytëzuar përvojat e vendeve të tjera në rajon, duke përfshirë Kroacinë (e cila ka arritur harmonizimin me *acquis* në këtë fushë).

Objektivi	Veprimet e rekomanduara të prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme dhe organizimet institucionale	Institucionet Kryesuese
Zhvillimi i një strategjie për të përmirësuar infrastrukturën e raportimit financiar në Kosovë	Përdorimi i tabelave të përputhshmërisë për të identifikuar dallimet ndërmjet ligjit aktual dhe <i>acquis communautaire</i> (draftet janë përgatitur nga ekipi i RRSK), të caktohet një zyrtar përgjegjës për reformë dhe të ndryshohet ligji për t'u harmonizuar me <i>acquis</i> .	MEF, KKRF SHKÇAK dhe donatorët
	Për të siguruar përcjelljen dhe zbatimin me kohë të këtij azhurnimi të RRSK, të kërkohet përkrahja e donatorëve që të ndihmojnë me plotësimin e tabelës së përputhshmërisë dhe hartimin e amendamenteve të kërkuara.	
	Me ndihmën e donatorëve, të mbahen ekspertët për të ndihmuar përgatitjen dhe implementimin e ndryshimeve në ligj.	
	Të sqarohet cilat standarde të kontabilitetit zbatohen me cilin lloj të subjektit biznesor.	
	Të merren hapat fillestarë drejt vendosjes së një sistemi të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë për funksionin e auditimit ligjor.	
Zhvillimi i një regjimi transparent të raportimit financiar që i ndihmon investimeve të huaja	Rishikimi i kërkesës për të publikuar pasqyrat financiare për të siguruar që institucioni që i është caktuar detyra e mbledhjes së pasqyrave e ka kapacitetin që ta zbatojë kërkesën me efektivitet. Shqyrtoni mundësinë që të i caktohet detyra Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë.	MEF
	Krijimi i një strategjie, me ndihmën e donatorëve, që të përmirësohet performanca, funksionaliteti dhe kapaciteti i KKRF.	MEF, KKRF dhe donatorët

Objektivi	Veprimet e rekomanduara të prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme dhe organizimet institucionale	Institucionet Kryesuese
Forcimi i sistemit arsimor për kontabilitetin	Promovimi i integritetit të universitetit dhe arsimit profesional	MEF, universitetet, SHKÇAK
	Azhurnimi dhe rritja e cilësisë së arsimit të kontabilitetit në nivelin terciar.	Universitetet
	SHKÇAK duhet të ndajë resurset e veta me universitetet; dhe në minimum, një pjesë e programit të trajnimit për teknik të kontabilitetit duhet të bartet te universitetet.	SHKÇAK

Një qëllim afatgjatë kryesor për Kosovën është që të ketë sistem të fuqishëm dhe efektiv të sigurimit të cilësisë në auditim dhe sisteme disiplinore dhe sanksionuese në fuqi. Si anëtar i FNK, SHKÇAK duhet të luajë një rol udhëheqës në të, në bashkëpunim me KKRF.

I. Sfondi

I.A Programi RRSK

1. Ky vlerësim i praktikave të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë është pjesë e një nisme të përbashkët të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), për të përgatitur raporte për Respektimin e Standardeve dhe Kodeve (RRSK). Vlerësimi duhet të përqendrohet në pikat e forta dhe të dobëta të mjedisit të kontabilitetit dhe auditimit, dhe se si ato ndikojnë në cilësinë e raportimit financiar të korporatave. Kjo përfshin një përmbledhje të kërkesave të detyrueshme dhe praktikës aktuale, duke përdorur Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)² dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)³ si bazë krahasimi. Kjo mbështetet në përvojën ndërkombëtare dhe praktikën e mira të rregulloreve për kontabilitet dhe auditim. Ky vlerësim gjithashtu merr parasysh kërkesat përkatëse të ligjeve të BE-së (*acquis communautaire*).

2. Që nga fillimi i tij në fillim të vitit 2000, programi i Kontabilitetit dhe Auditimit RRSK (K&A) ka bërë vlerësimin e mjedisit të K&A në më shumë se njëqind vende të botës, duke përfshirë të gjitha përveç njëres nga vendet e Evropës dhe Rajonit të Azisë Qendrore. Iniciativa RRSK K&A ka, në përgjithësi, dy qëllime kryesore:

- Për të vlerësuar cilësinë e standardeve kombëtare për K&A, kryesisht duke i krahasuar ato me SNRF dhe SNA, dhe duke vlerësuar pajtueshmërinë me këto standarde.
- Për të ndihmuar shtetin në zhvillimin e një plani të veprimit për përmirësimin e kornizës institucionale që ndihmon regjimin e raportimit financiar dhe auditimit të korporatave.

Për të përmbushur këto objektiva, fushëveprimi dhe zbatimi i standardeve duhet të vlerësohet në kornizën e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të shtetit, dhe përmirësimet e rekomanduara duhet të përshtaten me rrethanat specifike të vendit.

3. **Ky vlerësim është një azhurnim i RRSK për K&A të parë për Kosovën, që është botuar në qershor 2006⁴.** Prandaj, objektivi kryesor është të kuptohet dhe të përshkruhet progresi i arritur që nga ajo kohë, veçanërisht për sa i përket implementimit të standardeve ndërkombëtare dhe praktikave më të mira, si dhe shkallës së harmonizimit të Kosovës me *acquis* në lidhje me raportimin financiar.

² Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar lëshohen nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit (BNSK), një organizatë e pavarur që vendos standardet e kontabilitetit e bazuar në Londër, Mbretëria e Bashkuar. BNSK ka njoftuar në prill 2001 se standardet e saj kontabël do të quhen "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)". Gjithashtu në prill 2001, BNSK njoftoi se do të miratojë të gjitha Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) të lëshuara nga Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (KSNK). Në këtë raport, termi SNRF përfshin edhe SNRF edhe SNK si dhe interpretimet përkatëse.

³ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) janë standardet e lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

⁴ RRSK K&A 2006 mund të gjendet në:

<http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/EXTCENFINREPREF/0,,contentMDK:21569478~menuPK:7356128~pagePK:64168445~piPK:64168309~theSitePK:4152118,00.html>

I.B Konteksti ekonomik

4. **Kosova është vend pa dalje në det dhe kufizohet me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në jug, Shqipërinë në perëndim dhe Malin e Zi në veriperëndim. Rripi i mbetur kufitar është me Serbinë Qendrore dhe mbetet objekt i mosmarrëveshjeve.** Qyteti më i madh dhe kryeqyteti i Kosovës është Prishtina (shkruhet Prishtinë ose Priština). Emri Kosovë ka përfaqësuar një numër të entiteteve të ndryshme me kufij të ndryshëm gjatë shekujve. Ka pasur edhe periudha kur asnjë subjekt politik nuk ka ekzistuar me emrin e Kosovës. Kufijtë e sotëm datojnë që nga viti 1946.

5. **Pas përfundimit të luftës së Kosovës të vitit 1999, Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (UNSCR) 1244 vendosi Kosovën nën administrimin e përkohshëm të OKB-së (UNMIK). Një deklaratë e pavarësisë u miratua më 17 shkurt 2008 nga Kuvendi i Kosovës.** Në korrik të vitit 2010, me votë dhjetë-me-katër, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë nxori një opinion këshillues se deklarata nuk ishte në shkelje të të drejtës ndërkombëtare dhe deklaroi se "Gjykata kështu arrin në përfundimin se, duke marrë të gjithë faktorët së bashku, autorët e deklaratës së pavarësisë të 17 shkurtit 2008 nuk kanë vepruar si një prej Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në kuadër të Kornizës Kushtetuese, por si persona që kanë vepruar së bashku në cilësinë e tyre si përfaqësues të popullit të Kosovës jashtë kornizës së administratës së përkohshme".⁵ Në datën 16 shkurt 2012, 87 vende anëtare të OKB-së e kanë njohur Kosovën.⁶ Më 29 qershor 2009, Kosova u bë anëtare e plotë e Bankës Botërore dhe FMN-së.⁷

6. **Në vitin 2011, popullata e Kosovës është vlerësuar të jetë 1.8 milion, nga të cilat 45% jetojnë në zonat urbane. Me një BPV për kokë banori prej 2,368 Euro⁸, Kosova është një nga vendet më të varfra në Evropë⁹, dhe nivelet e të ardhurave janë sa rreth dy të tretat e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.** Varfëria mbetet e përhapur, por ka qenë në rënie - sipas të dhënave të fundit në dispozicion (nga viti 2009), 34% e popullsisë jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë, dhe rreth 12% janë në varfëri ekstreme. Varfëria e skajshme është joproporcionalisht e lartë në mesin e fëmijëve, të moshuarve, familjeve me anëtarë me aftësi të kufizuara, si dhe familjeve me kryefamiljare grua. Megjithatë, ngushtësia e hendekut të varfërisë sugjeron se varfëria nuk është e thellë. Me një normë zyrtare papunësie prej 45.4 përqind dhe një normë shumë të ulët të punësimit (26.4%), Kosova e ka historinë më të dobët të punësimit në Evropë, dhe përqindja e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore (48.1%) në mesin e popullsisë në moshë pune në Kosovë është dukshëm nën mesataren për të gjitha ekonomitë në tranzicion (65%).

7. **Rritja ekonomike e Kosovës ka qenë e qëndrueshme që nga fundi i konfliktit në qershor të vitit 1999, që i atribuohet pjesërisht investimeve të mëdha publike në rindërtimin pas konfliktit, si dhe një rritjeje në konsumin privat dhe investimet (megjithëse nga një bazë shumë e ulët).** Rritja është ngadalësuar nga 6.9 për qind në vitin 2008 në rreth 2.9 për qind në vitin 2009, dhe është rikthyer në 4 për qind në vitin 2010 në prag të krizës ekonomike globale – ky është një rezultat shumë më i mirë se në pjesën tjetër

⁵ <http://www.icj-cij.org/docket/files/141/15987.pdf>

⁶ http://en.wikipedia.org/wiki/International_recognition_of_Kosovo

⁷ <http://www.state.gov/r/pa/prs/ps/2009/06a/125489.htm>

⁸ Censusi i prillit 2011 zbuloi që popullsia e Kosovës është më e vogël sesa është vlerësuar më herët. Kjo sjell një BPV më të lartë për kokë banori sesa që është vlerësuar para censurit.

⁹ Banka Botërore – Programi për Partneritetin e Kosovës; Gjendja në Shtator 2011

të Evropës Juglindore, që më së shumti pësoi rënie në prodhim . Ndikimi relativisht i vogël i krizës globale financiare dhe ekonomike në rritjen reale deri në këtë pikë reflekton integrimin e kufizuar të Kosovës me ekonominë globale.

8. Përdorimi i euros si valutë lokale de facto ka eliminuar luhatshmërinë e kursit të këmbimit dhe ka mbajtur inflacionin në nivel të ulët. Megjithatë, ekonomia e Kosovës është shumë e varur nga dërgesat. Sektori i jashtëm ka përjetuar një përkeqësim të bilancit tregtar në vitin 2011. Importet e mallrave pritej të rriteshin për 13.2%, ndërsa eksportet e mallrave pritej të rriteshin për 10.5%. Këto zhvillime kanë kontribuar në rritjen e deficitit tregtar në raport me BPV-në për 1%, nga 40.8% në vitin 2010 në 41.8% në vitin 2011¹⁰. Në vlerësimet zyrtare dërgesat përbëjnë 15% të BPV-së. Megjithatë, sipas disa vlerësimeve, fluksi total i dërgesave shkon deri në 30% të BPV-së. Ndikimi i mundshëm i borxhit të tanishëm evropian sovran dhe krizat bankare në Kosovë janë dhënë në Kutinë 1. Me pak fjalë, ajo që pritet është se ndihma zyrtare, huadhënia bankare e jashtme, investimet e huaja direkte dhe dërgesat nga jashtë do të ulen gjatë viteve të ardhshme, si pasojë e ngadalësimit të gjerë të rritjes ekonomike në Evropë.

9. **Një pjesë e madhe e 90,000 bizneseve të Kosovës janë mikro-ndërmarrje me qasje të kufizuar në financim të jashtëm.** Ku financimi i jashtëm i jepet një biznesi, vendimi nuk bazohet zakonisht në vlerësimin e pasqyrave financiare dhe kapacitetin e ripagimit, por, përkundrazi, në cilësinë dhe vlerën e kolateralit të ofruar nga huamarrësi.

10. **Informacioni financiar i arsyeshëm dhe i besueshëm është fundamental për t'u larguar nga modeli i kreditimit i bazuar në kolateral, drejt kreditimit sipas rrjedhës së parasë apo vlerësimit kreditor, të cilat të dyja varen nga aftësia e huadhënësit për të marrë të dhëna të sakta dhe transparente financiare.** Cilësia e praktikave të kontabilitetit dhe auditimit në një ekonomi si Kosova është e rëndësishme për sektorin privat dhe atë publik, sepse të dy luajnë një rol të rëndësishëm në shtytjen e rritjes së vendit.

11. **Që nga viti 2006 kur ka dalë RRSK, roli i sektorit bankar ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme në lidhje me financimin e ekonomisë së Kosovës.** Ende është e vërtetë se ndërmarrjet e vogla private financohen në mënyrë tipike nga fitimet e pashpërndara dhe fondet joformale të krijuara nga familja. Kreditë për sektorin privat kanë qenë 10% e BPV-së në vitin 2003 dhe 23% e BPV-së në vitin 2005. Kjo përqindje u rrit në 33% në vitin 2009, në qershor 2011, vlera e përgjithshme e kredive të lëshuara nga sistemi bankar në Kosovë ka qenë 1.6 miliardë euro (34.3% e BPV-së).¹¹ Bankat e Kosovës mbeten likuide; raporti depozitë- kredi i tyre ishte 181% në fund të vitit 2004 dhe 133% në nëntor 2011¹², duke siguruar një bazë të fortë të mjaftueshme të rifinancimit për zgjerimin e mëtejshëm të portofolit të kredive të tyre. Në fund të vitit 2011 ka pasur tetë banka duke vepruar në Kosovë. Siç ishte rasti në vitin 2006, dy prej tyre, shumica e aksioneve të të cilave janë në pronësi të bankave të huaja, kishin në pronësi shumicën e aseteve bankare. Vetëm dy banka janë në pronësi të aksionarëve lokalë, një bankë e huaj mban vetëm një degë në Kosovë. Bankat nuk përfshihen në transaksione komplekse financiare, dhe kjo u mundësoi atyre të shmangin shumë nga vështirësitë e kohëve të fundit në sektorin bankar global. Banka Qendrore kërkon që bankat të ndjekin, pak a shumë, kërkesat e kapitalit Bazel I. Në Kosovë nuk ka banka investimesh apo fonde investimesh.

¹⁰ Buletini makroekonomik nr. 6 (korrik– shtator 2011) , Ministria e financave

¹¹ <http://bqk-kos.org/repository/docs/2011/Finacial%20Stability%20Report%20No.%202.pdf>

¹² Buletini mujor statistikor i Bankës Qendrore të Kosovës, nëntor 2011

Kutia 1: Ndikimi i krizës aktuale evropiane në Kosovë

Kriza në Eurozonë rriti vështirësitë ekonomike me të cilat ballafaqohet Kosova, edhe pse nuk është anëtare e zonës së valutës së përbashkët. Kosova pritet të preket në këto mënyra:

- **Shumë anëtarë të Eurozonës është dashur të miratojnë programe shtrënguese duke rritur tatimet dhe duke zvogëluar nivelin e shpenzimeve të qeverisë.** Kjo ka kontribuar në një dobësim të aktivitetit ekonomik në BE, që ka çuar në uljen e kërkesës për eksporte nga Kosova dhe një zvogëlim të rrjedhës së dërgesave në vend. Masat shtrënguese gjithashtu do të kenë ndikim negativ në rrjedhat e ndihmës së donatorëve të cilat ende përbëjnë një segment të rëndësishëm të pranimeve për buxhetin e qeverisë në Kosovë.
- **Përveç kësaj, për shkak të humbjeve në shumë prej pasurive të tyre, duke përfshirë në bonot shtetërore, shumë banka të eurozonës po synojnë të forcojnë pozitat e tyre të kapitalit.** Kjo ndikon jo vetëm në bankat në vendet të cilat kanë bërë kërkesë për ndihmë nga BE-ja dhe FMN, por edhe në bankat e mëdha në Gjermani, Francë, Holandë dhe qendrat e tjera të financave në BE. Si rezultat, shumë banka të eurozonës janë duke rishqyrtuar nivelet e tyre të ekspozimit ndaj tregjeve jashtë vendit të tyre. Duke pasur parasysh se bankat e eurozonës janë blloku më i madh i ofruesve të kapitalit për bankat e Kosovës, çdo ulje në aktivitetin e këtyre bankave ka të ngjarë që të ketë efekt të uljes në rritjen ekonomike të Kosovës në të ardhmen e afërt dhe periudhën afatmesme.

12. **Në fund të vitit 2011, trembëdhjetë kompani të licencuara të sigurimit kishin aktivitete në Kosovë, nga këto, 10 nuk ofronin sigurimin jetësor dhe tri ishin kompani të sigurimit jetësor.** Ndarja e sigurimeve jetësore dhe jo-jetësore është kërkesë ligjore. Në përgjithësi, sektori i sigurimeve mbetet i pazhvilluar mjaft, me shumicën e të ardhurave nga premiumet (70%) me origjinë nga sigurimi i detyrimit të palës së tretë (normat e premiumit janë përcaktuar nga Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës -BQK). Në shtator 2011, rezervat e përgjithshme teknike¹³ të të gjitha kompanive të sigurimeve në Kosovë ishin 52.6 milion euro, si dhe fitimi total vjetor për këtë sektor ishte 2.7 milion euro¹⁴.

13. **Institucionet mikrofinanciare (IMF) kohët e fundit kanë dhënë kapital të konsiderueshëm për bizneset e vogla.** Në Kosovë ka 15 IMF, prej të cilave 11 janë OJQ dhe 4 janë shoqëri aksionare (statusi i OJQ-së është relikë e periudhës së pasluftës të vitit 1999 në Kosovë, kur të gjitha IMF-ve u është kërkuar që të regjistrohen së pari si OJQ). Dymbëdhjetë IMF janë anëtare të Asociacionit të Institucioneve Mikrofinanciare të Kosovës (AIMK). Sipas AIMK-ut, gjithë portofoli i kredive nga IMF-të është rreth 90 milion Euro, dhe klientela përbëhet nga 60,000 biznese. IMF-të përbëjnë rreth 5% të sektorit financiar në Kosovë sa i përket aseteve, dhe portofolio kreditore e kombinuar e tyre është rreth 15% e totalit të kredive në Kosovë. IMF më i madh është KEP Trust (KEP). KEP filloi aktivitetet e tij në vitin 1999, si një projekt i Komisionit Ndërkombëtar Katolik të Migracionit (ICMC) të bazuar në Zvicër. Qëllimi i tij ishte që të japë kredi për ndërmarrjet e vogla dhe mikro,

¹³ Rezervat teknike që i mbajnë ndërmarrjet e sigurimeve përbëhen nga rezervat statistikore kundër rrezikut të mbetur sa i përket polisave të sigurimit të jetës, duke përfshirë rezervat për polisat me profit që i shtojnë vlerën e maturitetit të rritjeve me profit ose polisave të ngjashme, parapagesat e premieeve dhe rezervat kundër kërkesave të mbetura (definicioni i OECD-së).

¹⁴ Raporti mujor statistikor i Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës Nr. 123

fillimisht duke u fokusuar në bizneset e refugjatëve kosovarë që ktheheshin pas përfundimit të konfliktit¹⁵. Portofoli i KEP-it është rreth 30 milion euro, të ndara te më shumë se 18,000 klientë, kompania ka 34 degë dhe mbi 320 të punësuar. Përveç IMF-ve, sektori financiar përfshin katër agjenci të transferimit të parave, 30 zyra të këmbimit dhe 5 institucione financiare jo-bankare¹⁶.

14. **Duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për ekonominë, IMF-të janë të rregulluara edhe me Ligjin e ri për bankat.** Ligji bën dallim ndërmjet IMF-ve "të regjistruara" dhe IMF-ve "të licencuara", ndryshimi ka të bëjë me atë se sa mund të pranohen nga IMF depozitat e afatizuara dhe kursimet. Ligji i ri për bankat parasheh se asnjë IMF nuk mund të veprojë në Kosovë, nëse nuk është regjistruar apo licencuar nga BQK-ja. Ligji liston kushtet specifike që duhet të plotësohen që një IMF të regjistrohet, licencohet dhe, sipas rastit, ta anulojë licencën ose regjistrimin e tij. Ligji gjithashtu liston aktivitetet që janë të lejuara dhe përcakton se IMF-të mund të veprojnë si OJQ apo shoqëri aksionare. Kërkesat e kujdesit përfshijnë një nivel minimal të kapitalit (200,000 Euro), dhe ndalimin e dhënies së kredive për menaxhmentin dhe palët e lidhura (nëse jepen kredite e tilla, shumat zbriten nga kapitali për qëllime të raportimit të kujdesshëm). Totali i detyrimeve nuk bën të kalojë 500% të kapitalit. IMF-të duhet të mbajnë të dhënat e tyre në përputhje me SNRF-të.

15. Disa IMF janë mjaft të mëdha sa operacionet e tyre i janë afruar fushës së bankave komerciale, dhe problemet e qeverisjes kanë dalë në të paktën një rast (duke përfshirë abuzimin e fondeve të administruara nga ana e menaxhmentit). Për këtë arsye, disa nga IMF-të më të mëdha po shqyrtojnë mundësinë për të aplikuar në BQK për t'u bërë banka. Një ndryshim i tillë është i lejuar me Ligjin e ri mbi bankat, dhe kapitali i dhuruar dhe fitimet e pashpërndara i nënshtrohen tatimit të mundshëm retroaktiv nga Administrata Tatimore. Transformimi kërkon regjistrimin fillestar të një shoqërie aksionare me identifikimin e qartë të pronarëve të ardhshëm dhe adresës së tyre (OJQ-të nuk kanë aksionarë as pronarë).

16. **Një fond i licencuar plotësues pensional ka qenë në veprim në fund të vitit 2011 – Fondi Slloveno-Kosovar Pensional (FSKP).** Që nga raporti paraprak i RRSK, licencat e shtatë fondeve të tjera të pensioneve plotësuese janë tërhequr dhe/ose anuluar, dhe fondet e tyre janë transferuar ose në FSKP ose në fondin publik pensional. FSKP është themeluar në shtator të vitit 2006 dhe licencuar në nëntor 2006 nga BQK-ja. Themeluesit janë Prva Group i Sllovenisë dhe Korporata Dukagjini e Kosovës. Prva Group pohon në faqet e saj të internetit që ajo u shërben 274,041 individëve, dhe se ka 317.296 milion euro të aseteve nën menaxhim dhe 32 milionë euro të kapitalit në datën 30 nëntor 2011¹⁷. Këto totale, megjithatë, kanë të bëjnë me operacionet e të gjithë grupit Prva Group (në Slloveni, Serbi, Rumani, Shqipëri, IRJ të Maqedonisë dhe Kosovë). Vetë FSKP ka rreth 4,000 anëtarë dhe 4 milionë Euro në asete (minimumi i kërkuar me ligj). FSKP-ja ka marrë përsipër dy fonde të tjera të dështuara në vitin 2008 dhe aktualisht administron dy fonde, një të përbërë nga anëtarët e pensionuar, tjetri i përbërë nga anëtarët para pensionimit. Deri tani, Kosova nuk ka treg të kapitalit.

17. **Sektori i ndërmarrjeve në Kosovë aktualisht përbëhet nga tri lloje të subjekteve: (i) ndërmarrjet në pronësi private, të cilat përbëjnë shumicën e sektorit (për nga numri dhe ndarja e produktit), (ii) ndërmarrjet në pronësi publike (NPP); dhe (iii) ndërmarrjet në pronësi shoqërore (NPSH).** Dallimi ndërmjet NPP-ve dhe NPSH-ve -

¹⁵ <http://keptrust.org/?cid=2,27>

¹⁶ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - <http://bqk-kos.org/?cid=2,7>

¹⁷ <http://www.prvagroup.eu/en/members.asp?FolderId=343>

të cilat së bashku formojnë sektorin e ndërmarrjeve publike – ka rrënjët në regjimin tregtar juridik të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ)¹⁸, që u rikthye në Kosovë nga UNMIK-u në dhjetor të vitit 1999¹⁹. Sipas atij regjimi, NPP-të i përgjigjeshin afërsisht ndërmarrjeve shtetërore të vendeve të tjera socialiste, megjithatë, pronësia shoqërore ishte një koncept unik për RSFJ-së, në të cilën ndërmarrjet ishin në pronësi jo të shtetit, por të punëtorëve. UNMIK-u ushtroi pushtetin për të rregulluar dhe për të menaxhuar të gjitha NPP-të dhe NPSH-të deri kur u formua Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) në vitin 2002 si një agjenci autonome. AKM-ja pastaj mori përsipër përgjegjësinë për NPP-të dhe NPSH-të²⁰. AKM-ja gjithashtu është bërë përgjegjëse për procesin e privatizimit të NPSH-ve, që ka filluar në vitin 2003. NPP-të nuk janë përfshirë në këtë proces të privatizimit.

18. **Në vitin 2008, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) u themelua (me Ligjin e Kosovës Nr. 04/L-034, mbi AKP-në), si pasardhëse e AKM-së.** AKP-ja është një organ i pavarur publik dhe mandati i saj kryesor është që të privatizojë ose likuidojë të gjitha NPSH-të e mbetura. Të gjitha asetet dhe detyrimet e AKM-së janë transferuar në AKP. Ato NPSH të destinuara për privatizim janë shitur me anë të tenderit publik të ndara në "valë." Në fund të vitit 2011, 53 valë të tilla ishin përfunduar dhe shumica e NPSH-ve ishte shitur. Në përgjithësi, AKP-ja krijon Ndërmarrje të Reja (NewCo) nga NPSH-të dhe pastaj i ofron për shitje asetet dhe detyrimet aktuale. Investitorët dorëzojnë ofertë vetëm për asetet - dhe vetëm disa prej detyrimeve aktuale – të ndërmarrjes së re, jo atë të vetë NPSH-së fillestare. AKP nganjëherë ndan NPSH-të në disa Ndërmarrje të Reja të vogla. Ato NPSH që konsiderohen të papërshtatshme për privatizim likuidohen me mënyrën e shitjes së aseteve. Në fund të vitit 2011, janë kryer 10 shitje të tilla të likuidimit të aseteve. Të ardhurat totale nga shitja për likuidim dhe privatizimi ishin 31,399,356 euro dhe 517,231,073 Euro më 31 mars 2011.²¹

19. **Më 13 qershor 2008, Kuvendi aprovoi Ligjin 03/L-087, Mbi Ndërmarrjet Publike. Ligji liston 30 NPP në total dhe i klasifikon ato në katër kategori: NPP Qendrore (6), NPP Rajonale të Ujësllësit (6 ndërmarrje), NPP Rajonale të Ujitjes (2) dhe NPP Lokale (16).** Ndërsa NPP lokale dhe rajonale përfshijnë kompanitë e ujësllësit, mbeturinave dhe të ngrohjes, që kanë pak rëndësi ekonomike, NPP-të qendrore përfshijnë subjekte shumë më të mëdha, të tilla si Korporata Energjetike e Kosovës, Sistemi i Transmisionit dhe Operatori i Tregut, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Hekurudhat e Kosovës dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (në përputhje me marrëveshjen ndërmjet UNMIK-ut dhe Qeverisë së Islandës (QI), Qeveria e Islandës është përgjegjëse për të siguruar që kontrolli i trafikut ajror vepron në përputhje me rregullat e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil).

20. **Të hyrat e investimeve të huaja direkte në Kosovë për tre tremujorët e parë të vitit 2010 arritën në 203 milion euro, një shumë e krahasueshme me vitin 2009. Kjo është mjaft nën nivelin më të lartë vjetor të vitit 2007 prej 414 milion Euro.** Investitorët kryesorë vinin nga Gjermania, Sllovenia dhe Zvicra, pati edhe të hyra më të vogla të investimeve nga Austria, Britania e Madhe, Turqia, Holanda, Shqipëria, SHBA-ja dhe Franca. Sektorët kryesorë që tërhoqin investimet e huaja direkte ishin shërbimet financiare,

¹⁸ D.m.th regjimi i vendosur para vitit 1989.

¹⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 – definicioni ligjor i NPP-ve dhe NPSH-ve është dhënë në Ligjin për Ndërmarrjet të RSFJ 77/88.

²⁰ <http://www.kta-kosovo.org/ktareg/UNMIK%20Regulation%20No.%202002-12%20Establishing%20the%20KTA.pdf>

²¹ Raporti tremujor për aktivitetet e AKP-së, 18 prill, 2011

prodhimi, ndërtimtaria, industrinë përpunuese dhe pasuritë e patundshme²². Megjithë një farë suksesi në tërheqjen e investorëve të rinj, niveli i të hyrave të investimeve të huaja direkte ka stagnuar në vitet e fundit. Si rezultat i kësaj, bilanci tregtar është përkeqësuar në fakt në vitet e fundit, dhe shkalla zyrtare e papunësisë ka mbetur në rreth 45%²³.

21. Ky raport vlerëson cilësinë e raportimit financiar vetëm të NPPve të përzgjedhura dhe subjekteve private, dhe krahason rezultatet me ato të raportit RRSK të vitit 2006. Ky krahasim mandej mundëson rekomandimet për përmirësim.

²² www.balkaninsight.com.

²³ Banka Botërore- http://siteresources.worldbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/Kosovo_Snapshot.pdf.

II. Korniza e kontabilitetit dhe auditimit: Ndryshimet kryesore nga viti 2006 24

II.A Korniza ligjore

22. Ky raport trajton ndryshimet në raportimin financiar të korporatave (d.m.th. kompanitë në të cilat aksionarët kanë përgjegjësi të kufizuar), si dhe të NPP-ve dhe NPSH-ve (para. 17) që nga RRSK i K&A i vitit 2006. Formimi dhe rregullimi i subjekteve afariste në Kosovë udhëhiqet nga Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (Ligji për Shoqëritë Tregtare), i cili është miratuar nga Kuvendi në vitin 2007 dhe ka zëvendësuar Rregulloren e UNMIK-ut 2001/6 (2001) për Organizatat e Biznesit. Përderisa Rregullorja e UNMIK-ut jepte një grup parimesh që duhet ndjekur nga shoqëritë tregtare, Ligji për Shoqëritë Tregtare është shumë më afër që të jetë një kod i plotë komercial. Ligji për Shoqëritë Tregtare (ngjashëm me Rregulloren e UNMIK-ut), përcakton se një shoqëri tregtare mund të krijohet si një ndërmarrje personale afariste, një ortakëri e përgjithshme apo e kufizuar, ose një korporatë. Një korporatë mund të inkorporohet si një shoqëri aksionare apo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar:

- Shoqëria aksionare është një korporatë, e cila mund të ketë një numër të aksionarëve, si dhe klasa të ndryshme të aksionarëve. Ajo mund të bëjë ofertë publike për aksionet e saj, dhe pronari(ët) mund të transferojnë aksionet e tij/saj (tyre), pa miratimin e aksionarëve të tjerë apo të kompanisë. Kapitali fillestar minimal i një shoqërie aksionare duhet të jetë së paku 25,000 Euro (kërkesë e pandryshuar nga Rregullorja e UNMIK-ut). Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve është organi përfundimtar drejtues i një shoqërie aksionare. Bordi i drejtorëve është përgjegjës për të siguruar përputhjen me ligjet në fuqi dhe standardet e kontabilitetit. Ligji kërkon më tej që Bordi të sigurojë që raporti vjetor të përmbajë "një pasqyrë të audituar nga auditori i pavarur të gjendjes financiare të kompanisë", e cila duket se kërkon që raportet vjetore të shoqërive aksionare të përfshijnë vetëm bilancin e gjendjes të audituar.²⁵
- Kompania me përgjegjësi të kufizuar është një korporatë, aksionet e së cilës shpërndahen vetëm te themeluesit e saj ose te persona tjerë të paracaktuar. Numri i aksionarëve ka qenë i kufizuar në 50 sipas Rregullores së UNMIK-ut, ky kufizim tash është hequr. Një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të kryejë ofertë publike për aksionet e saj. Kufizimet në transferimin e pronësisë janë liruar; ndërsa Rregullorja e UNMIK-ut u ka dhënë aksionarëve ekzistues të drejtën e refuzimit të parë, por i ka lejuar që marrëveshja e shoqërisë të thotë ndryshe, Ligji për Shoqëritë Tregtare lejon transferimin e pronësisë për këdo, por e lejon marrëveshjen e kompanisë të përfshijë të drejtën e refuzimit të parë. Organi drejtues i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar është gjithashtu Mbledhja e përgjithshme e aksionarëve të saj. Ligji për Shoqëritë Tregtare ka shfuqizuar dispozitën e Rregullores së UNMIK-ut që kërkonte që kompanitë me përgjegjësi të kufizuar me më shumë se 20 aksionarë të emërojnë një bord të drejtorëve.

²⁴ Ky raport paraqet parimet ligjore në fuqi sa i përket kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar dhe nuk përpikët të japë më shumë sesa një hyrje në këto çështje. Ky raport nuk ka për qëllim të jetë një shpjegim gjithëpërfshirës i ligjit dhe as nuk është këshillë ligjore për ata që e lexojnë.

²⁵ Ligji nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, Para 169.2b

- Ligjet bankare dhe të sigurimit kërkojnë që bankat dhe kompanitë e sigurimeve të bëhen korporata si shoqëri aksionare. Për shkak të natyrës së aktiviteteve të tyre, ky raport i konsideron këto institucione financiare si *subjekte me interes publik*

23. **Këshilli i Kosovës për Raportimin Financiar (KKRF) është pasardhës i Bordit për Standardet e Raportimit Financiar (BKSFR), u themelua në vitin 2011 sipas ligjit nr. 04/L-014 Për kontabilitetin, raportimin financiar dhe kontrollin (Ligji për Raportimin Financiar).** Si një super-rregullator, KKRF është krijuar i standardeve për kontabilitetin, auditimin, etikën dhe edukimin profesional të auditimit, rregullator, dhe zbatues. Mandati i KKRF është identik me atë të BKSFR. Megjithatë, BKSFR-së gjithmonë i ka munguar kapaciteti për të ushtruar autoritetin e tij rregullativ, që rezultoi në probleme të rëndësishme të implementimit të vërejtura në RRSK të vitit 2006. Ka nevojë për një vlerësim të hapur të KKRF-së pasi nuk është e qartë që ai do të ketë kapacitet për të trajtuar sfidat rregullative me të cilat përballlet. Ky raport përfshin propozime për të trajtuar vështirësitë e përjetuara nga BKSFR që mund të ndikojnë edhe te KKRF. Ligji për raportimin financiar përcakton kornizën për kontabilitet dhe auditim në Kosovë dhe e bën KKRF përgjegjës për sa vijon:

- vendosjen e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit për shoqëritë afariste, megjithatë, ky autoritet NUK përfshin sektorin financiar;
- përcaktimin e kërkesave të kontabilitetit dhe auditimit për pasqyrat financiare të shoqërive afariste, duke përfshirë korporatat e themeluara sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, NPSH-të dhe NPP-të, edhe pse jo për sektorin financiar;
- krijimin dhe lëshimin e standardeve për trajnimin profesional të kontabilistëve dhe auditorëve, duke çuar në certifikimin e kontabilistëve dhe licencimin e auditorëve, megjithatë, ligji e delegon rregullimin e kontabilistëve te shoqatat profesionale të licencuara dhe,
- shqyrtimin e kërkesave për dhënien e licencave të auditimit për individët dhe firmat, si dhe licencimin e shoqatave profesionale (aktualisht, Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës është e vetmja shoqatë profesionale e licencuar).

Që të kryejë të gjitha këto përgjegjësi, KKRF duhet të ketë një ekspertizë të gjerë teknike në dispozicion. Aktualisht KKRF nuk e ka këtë ekspertizë.

24. **Gjatë viteve, BKSFR ka marrë pak ndihmë teknike, si pjesë e projekteve të donatorëve që trajtojnë çështje më të gjera sesa raportimi financiar. Kjo ka mundësuar progres modest, por BKSFR ende nuk ka kryer plotësisht të gjitha përgjegjësitë e veta.** Pa funksionimin e një organi që vendos standardet dhe është rregullator, regjimi i raportimit financiar në Kosovë nuk ka qenë në gjendje të luajë rol në tërheqjen e rrjedhave të IHD-ve. KKRF mbajti takimin e tij të parë në fund të vitit 2011, dhe nuk është e qartë nëse mund të zhvillojë aftësinë për të trajtuar mangësitë e paraardhësit të tij. Ligji mbi Raportimin Financiar ka shtuar një përgjegjësi tjetër të madhe te KKRF, domethënë, mbledhjen dhe publikimin e pasqyrave financiare të subjekteve që i nënshtrohen kërkesës për dorëzim të raporteve financiare. Ligji megjithatë, ende e lë KKRF brenda MEF-it (kjo do të thotë se punëtorët e KKRF-së marrin paga të sektorit publik) dhe mban dispozitën të ligjit të mëparshëm se tarifat dhe gjobat e mbledhura nga KKRF janë të ardhura të buxhetit.

25. **Ky konfigurim nuk ka funksionuar mirë për BKSFR gjatë gati dhjetë viteve të**

ekzistencës së tij dhe nuk ka gjasa të funksionojë për KKRF. Prandaj, ne rekomandojmë që KKRF do të përfitonte nga ndryshimi i këtij aspekti të strukturës së tij organizative. Kjo do të rriste kapacitetin e tij për të krijuar infrastrukturën e raportimit financiar të nevojshme për të përkrahur investimet e huaja direkte. Një ndryshim i tillë mund të arrihet përmes njërës nga opsionet e mëposhtme: (i) KKRF bëhet një agjenci e vetë-financuar, përgjegjëse për mbledhjen dhe administrimin e taksave dhe gjobave, që mund të punësojë kontabilistë profesionalë me përvojë dhe/ose auditorë në zyrën e tij me normat e tregut, (ii) mbahet status quo, por rritet ndjeshëm ndarja buxhetore e KKRF aq sa të sigurojë burimet e nevojshme për të funksionuar efektivisht; ose, (iii) një kombinim i (i) dhe (ii). Opsionet (i) dhe (iii) do të kërkojnë ndryshimin e ligjit.

26. **Ligji për Raportimin Financiar u miratua në vitin 2011, hartimi dhe miratimi i tij mori gati shtatë vjet (sipas raportit të mëparshëm RRSK ligji, "ishte në proces të ndryshimit" në vitin 2006).** Siç ishte rasti me Rregulloren e UNMIK-ut, institucionet financiare janë përjashtuar në mënyrë specifike nga zbatimi i Ligjit për Raportim Financiar dhe i nënshtrohen rregullores së BQK-së. Ligji i ri pritej të kontribuojë në harmonizimin e kornizës së raportimit financiar të korporatave me *acquis*. Megjithatë, nuk e arriti këtë qëllim, ligji i ri nuk përfaqëson përmirësim të Rregullores së UNMIK-ut, dhe pikat e spikatura janë përshkruar më poshtë.

27. **Organizatat afariste aktualisht klasifikohen si të mëdha, të mesme, të vogla dhe mikro në bazë të kriterëve të mëposhtme:**

Lloji i organizatës	Qarkullimi	Asetet bruto	Numri mesatar i punëtorëve
Organizata të mëdha afariste (dy nga tri)	Më shumë se 4 milion Euro	Më shumë se 2 milion Euro	Tejkalon 50
Organizata të mesme afariste (dy nga tri)	Më shumë se 2 milion Euro	Më shumë se 1 milion Euro	Më shumë se 10
Organizata të vogla afariste (dy nga tri)	Më shumë se 50,000 Euro	Më shumë se 25,000 Euro	Deri në 10
Mikro ndërmarrje	Më pak se 50,000 Euro	Më pak se 25,000 Euro	Më pak se 10

28. Organizatat e mëdha afariste do të duhet të zbatojnë, nga viti 2013, SNRF-të si dhe interpretimet, rekomandimet dhe të gjitha udhëzimet e nevojshme që janë të aprovuara nga KKRF. Të gjitha organizatat afariste të mesme dhe të vogla të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare gjithashtu do të kërkohej të zbatojnë SNRF-të të aprovuara nga KKRF-ja. Formulimi i ligjit shtron pyetjen nëse SNRF për NVM-të mund të imponohen nga KKRF për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, duke lehtësuar një pjesë të barrës rregullative në këto kompani, apo nëse duhet të zbatohen SNRF të plota nga kompanitë e vogla. KKRF ka treguar se aktualisht është duke punuar me MEF-in për ta ndryshuar ligjin ashtu që SNRF për NVM-të të jenë të zbatueshme në Kosovë në një datë në vitin 2013.

29. **Ligji mbi Raportimin Financiar hesht në lidhje me përdorimin e Standardeve të Kontabilitetit të Kosovës (SKK), edhe pse e mban KKRF përgjegjës për mbajtjen e SKK. Kjo ka krijuar konfuzion.** Ligji përcakton që pasqyrat financiare të konsoliduara të të gjitha ndërmarrjeve afariste duhet të jenë në përputhje me 78/660/EEC (kjo është një referencë për "Direktivën e Katërt", ndërsa "Direktiva e Shtatë" për llogaritë e konsoliduara nuk është përmendur) dhe SNRF.

30. Pasqyrat financiare të ndërmarrjeve afariste të mëdha dhe të mesme duhet të auditohen, me standardet e zbatueshme të auditimit që janë ISA. Vit kalendarik është edhe viti fiskal për të gjitha ndërmarrjet afariste. Raporti i mëparshëm RRSK vuri në dukje se fushëveprimi i kërkesave ligjore të auditimit ishte "shumë i gjerë në Kosovë duke marrë parasysh fazën e zhvillimit të profesionit të auditimit." Në këtë drejtim, ligji i ri mbi Raportimin Financiar paraqet një përmirësim të dukshëm. Sipas Rregullores së UNMIK-ut, pasqyrat financiare të të gjitha korporatave me qarkullim vjetor ose asete totale më shumë se 250,000 euro, si dhe të gjitha NPP-të dhe NPSH-të i nënshtrohen auditimit ligjor, megjithatë, ligji i ri kufizon këtë kërkesë të ndërmarrjet afariste të mëdha dhe të mesme.

31. **Aksionarët e ndërmarrjeve jo-financiare që i nënshtrohen kërkesës së auditimit e caktojnë auditorin e tyre nga radhët e auditorëve të licencuar nga KKRF. Emërimi i auditorit të bankës ose të shoqatës së sigurimit i nënshtrohet miratimit nga BQK-ja.** Ky miratim bazohet në kushtet e mëposhtme:

- Praktikuesi apo firma e auditimit duhet të jenë të licencuar në mënyrë të rregullt nga KKRF. Firma e huaj e auditimit ka të drejtë të licencohet nga KKRF, nëse të paktën dy nga partnerët e saj lokalë janë auditorë të licencuar në Kosovë.
- Miratimi jepet për auditimin një institucioni të caktuar financiar në një vit të caktuar, d.m.th. një firmë auditimi/profesionist mund të miratohet si auditor i disa institucioneve financiare, por është e domosdoshme të jepen miratimet e veçanta për atë firmë për auditimin e çdo institucioni financiar për atë vit financiar.
- Firma/profesionisti duhet t'i japin BQK-së (i) një program për auditimin e institucionit financiar, dhe (ii) një përshkrim të burimeve që të përdoren për misionin e auditimit.
- Në praktikë, pasqyrat financiare të të gjitha bankave dhe shoqërive të sigurimit auditohen nga firmat lokale anëtare të rrjeteve të mëdha ndërkombëtare të auditimit (Big Four (katër firmat e mëdha) plus Grant Thornton).
- Ka kërkesë të rotacionit pesë-vjeçar të firmave për auditorët e institucioneve financiare. Kjo kërkesë zbatohet për profesionistët dhe firmat, pasi rregullorja nuk bën dallim ndërmjet këtyre të dyjave.

32. **Dorëzimi i pasqyrave financiare vjetore të shoqërive tregtare kërkohet me ligj, në përputhje me *acquis* të BE.** Neni 11 i Ligjit për Raportim Financiar kërkon që, "Pasqyrat financiare të ndërmarrjeve afariste të mëdha duhet të dorëzohen dhe publikohen nga KKRF dhe një kopje dorëzohet në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), e cila e mban Regjistrin e Bizneseve, jo më vonë se më 30 prill të vitit të ardhshëm". Më tutje, pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të dorëzohen në KKRF dhe një kopje të dërgohet në MTI, dhe jo më vonë se më 30 qershor të vitit të ardhshëm. Kjo kërkesë është e ngjashme me kërkesat e Rregullores së UNMIK-ut, që imponon detyrimin për të gjitha ndërmarrjet afariste që të dorëzojnë pasqyrat financiare në regjistrin e bizneseve dhe në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa (MEF). Siç është vërejtur në Raportin RRSK të vitit 2006, kjo kërkesë

është ende duke u injoruar gjerësisht dhe nuk është zbatuar në mënyrë efektive. Mospajtueshmëria e vazhdueshme me kërkesën e dorëzimit kontribuon në mungesën e përgjithshme të transparencës dhe të besimit në mjedisin e biznesit.

33. **Kërkesa për dorëzim të raporteve në Ligjin për Raportimin Financiar nuk specifikon agjenci në MTI, në të cilën duhet të dorëzohen pasqyrat financiare, as ligji nuk ofron udhëzime se si KKRF duhet të organizojë mbledhjen e këtyre pasqyrave, duke pasur parasysh mungesën aktuale të kapacitetit të tij.** Personeli në KKRF kanë punuar për ta përmirësuar situatën dhe kanë arritur disa suksese. Prapë, me përjashtim të institucioneve financiare të qeverisura nga BQK-ja, pasqyrat financiare të shumë kompanive të Kosovës, duke përfshirë NPP-të dhe NPSH-të (Aeroporti i Prishtinës dhe Posta dhe Telekomit i Kosovës janë përjashtime) nuk janë në dispozicion të publikut. Kjo situatë nuk është konsistente me *acquis*, dhe mungesa rezultuese e transparencës nuk është e favorshme për tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

34. **Ligji Nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Ligji për BQK) ka zëvendësuar Rregulloren përkatëse të UNMIK-ut në vitin 2008. Ligji për BQK-në përmbante një referencë të veçantë për vendosjen e standardeve: "... për të vendosur standardet e kontabilitetit për institucionet financiare në Kosovë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar". Në vitin 2010, megjithatë, Ligji për BQK-në u zëvendësua me ligjin Nr. 03/L-209 Për Bankën Qendrore të Kosovës (Ligji i ri për BQK-në).** Ligji i ri për BQK-në nuk përfshin referencë për zbatimin e detyrueshëm të SNRF nga bankat, por në nenin 23 thuhet se, "Institucionet financiare duhet t'i japin Bankës Qendrore informacion të tillë dhe të dhënat në lidhje me operacionet e tyre dhe gjendjen financiare ashtu siç e kërkon Banka Qendrore." Megjithatë, kërkesa për SNK / SNRF është specifikuar edhe në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/21 për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave dhe Ligji i ri për bankat i referohet, në nenin 53, standardeve të kontabilitetit "ndërkombëtarisht të pranuara" si ato që zbatohen për bankat e Kosovës.

35. **Pasqyrat financiare të të gjitha bankave janë në dispozicion në faqet e tyre të internetit.** Kërkesa që bankat të publikojnë pasqyrat e tyre financiare nuk është e specifikuar në mënyrë të qartë me ligj dhe ky është një shembull i mirë i transparencës në Kosovë që ata e bëjnë këtë.

36. **Bankat kërkohet të përgatisin këto raporte për të përmbushur parimin e kujdesit:**

- Raportet javore të mbajtjes së rezervës së likuiditetit në BQK;
- Raportet mujore, duke përfshirë një llogaritje të rezervave të likuiditetit, bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, përmbledhjen e aseteve të klasifikuara dhe provizioneve; raport mbi depozitat, kreditë, dhe transferet bankare; raportin mbi importet dhe eksportet e parasë; raportin statistikor mbi artikujt e bilancit të gjendjes; raportin statistikor mbi normat e interesit dhe një raport mbi transaksionet ndërkombëtare;
- Raportet tremujore, duke përfshirë asetet dhe detyrimet e tjera; ndryshimet në kapital dhe rezerva, të ardhurat dhe shpenzimet tjera; të arkëtueshmet e vonuara më shumë se 90 ditë (asetet me probleme) dhe asetet e tjera të vonuara; përqendrimin e kredive, kreditë për palët e brendshme; maturiteti i bilancit të gjendjes; përqendrimi i fondeve; artikujt jashtë bilancit të gjendjes; asetet e bazës së kapitalit të ponderuara

sipas rrezikut, rreziku i normës së interesit; pozicionet e këmbimit valutor, dhe instrumentet e pagesës, dhe

- Raporti vjetor - çdo bankë ose degë e bankës së huaj, duhet të dorëzojë një kopje të Raportit Vjetor të vet në BQK brenda 120 ditëve pas përfundimit të vitit financiar. Raporti vjetor përfshin bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, shënimet shpjeguese dhe tabelat, dhe opinionin e auditorit dhe letrën e menaxhmentit për vitin paraprak financiar.

BQK mundet, në baza *ad hoc*, të rrisë shpeshtësinë e raportimit dhe/ose të zgjerojë kërkesat e raportimit, nëse ajo e konsideron të nevojshme për të kryer përgjegjësitë e veta mbikëqyrëse.

37. **Kompanitë e sigurimeve qeverisen, ashtu si janë qeverisur gjatë analizës së mëparshme RRSK, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/25 (Ligji mbi Sigurimin) dhe rregulloret e rrepta të BQK-së. Ligji për Sigurimet kërkon që kompanitë e sigurimeve të mbajnë librat e tyre dhe të përgatisin pasqyrat financiare "në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit".** Megjithatë, Rregulla 7, e datës 18 tetor 2001, që ndryshon Ligjin për Sigurimet kërkon që kompanitë e sigurimeve të vendosin provizione teknike dhe se, "provizionet teknike qartas përfshijnë një provizion për premiumet e pafituara dhe një provizion për dëmet e papaguara dhe dëmet e ndodhura por të paraportuara BQK-ja do të krijojë një proporcion të përhershëm të humbjeve të shkaktuara si dhe një përqindje të përhershme për humbjet që kanë ndodhur, por nuk janë raportuar. Pasqyrat financiare do të regjistrojnë këto shuma të vendosura ose shumat aktuale, cilado që është më e madhe"²⁶. Rregulla 7 prandaj i udhëzon kompanitë e sigurimeve që të largohen nga SNRF.

38. **Emërimi i auditorit i nënshtrohet miratimit nga BQK-ja, dhe Ligji për Sigurimet i imponon auditorit detyrën e lajmërimit nëse zbulon raste të mashtrimit dhe shkeljes sistematike të rregullave të BQK-së.** Gjithashtu, çdo kompani e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit janë të obliguar të përgatisin raporte tremujore për BQK-në në lidhje me administrimin dhe operacionet e sigurimit, likuiditetin, aftësinë paguese dhe profitabilitetin. Këto raporte mbulojnë kompaninë mëmë dhe filialet e saj, në bazë individuale dhe të konsoliduar. Kompanitë e sigurimeve gjithashtu dorëzojnë çdo muaj një bilanc të gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, raportin e investimeve, regjistrin e premieeve dhe regjistrin e dëmeve duke përdorur një format të përcaktuar nga BQK-ja.

39. **Ka plane për të liberalizuar sektorin e sigurimeve në të ardhmen e afërt. Aktualisht, asnjë nga kompanitë e sigurimit nuk publikon një seri të plotë të pasqyrave financiare në faqet e tyre të internetit. Vetëm fragmentet, p.sh., bilanci i gjendjes dhe raporti i auditorit janë në dispozicion për publikun.** BQK-ja nuk kërkon që organizata e sigurimit të publikojë pasqyrat e audituara financiare të tyre, prandaj, kërkesa e Ligjit për botimin e pasqyrave për Shoqëritë Tregtare mbizotëron në këtë sektor.

40. **Ligji i ri për bankat u miratua në prill 2012.** Ligji jep udhëzime për transformimin e IMF-ve në banka komerciale. Dy çështjet kryesore të përfshira në transformimin e tillë përfshijnë kapitalizimin dhe tatimin retroaktiv. Në mënyrë tipike, një OJQ është themeluar me një grant të financuar nga donatorë, pra, nuk ka kapital, dhe

²⁶ Rregulla 7 që e ndryshon Rregullën për Standardet e Kontabilitetit dhe Kërkesat e Mbajtjes së Regjistrave për kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit e datës 18 tetor 2001

themeluesi është zakonisht një tjetër, kryesisht OJQ e huaj. Çdo IMF që dëshiron të transformohet në një bankë duhet së pari të shndërrohet në një shoqëri aksionare sipas ligjit për shoqëritë tregtare. BQK-ja thekson se është e nevojshme të vendoset adresa e bankës së ardhme dhe, gjithashtu, të depozitohet kapitali në subjektin që është duke u transformuar. Shumë IMF kanë pasur sukses në aktivitetet e tyre dhe kanë akumuluar tepricat e tyre që kanë qenë të lira deri më tash nga tatimi në bazë të statusit të tyre si një "institut me përfitim publik." Tash ka një dispozitë në ligjin e ri për bankat që, pas transformimit, kur statusi i "përfitimit publik" skadon, si kapitali i dhuruar ashtu edhe teprica e akumuluar mund të jenë objekt i tatimit retroaktiv nga Administrata Tatimore.

II.B Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit

41. **Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë është zhvilluar shpejt si rezultat i asistencës teknike të konsiderueshme të kombinuar me udhëheqje efektive dhe aranzhimet e qeverisjes.** Rregullorja e UNMIK-ut 2001/30 (Ligji i UNMIK-ut) u zëvendësua me Ligjin Nr.04/L-014 të Kontabilitetit, Raportimit Financiar dhe Kontrollit (Ligji mbi Raportimin Financiar) në vitin 2010. Megjithatë, korniza e krijuar me Ligjin e UNMIK-ut ka mbetur kryesisht e paprekur. Korniza e re ripohon ekzistencën e një "super-rregullatori", edhe pse titulli i tij u ndryshua nga Bordi Kosovar për Standardet e Raportimit Financiar (BKSFR) në Këshillin Kosovar për Raportim Financiar (KKRF).

42. **Ligji nuk e njeh formalisht SHKÇAK si shoqatë e vetme profesionale për kontabilistët dhe auditorët.** Megjithatë, kushtet që ligji i përcakton për certifikim (nga KKRF) të ndonjë shoqate të ardhshme janë aq strikte sa që do të jetë e vështirë për ndonjë konkurrencë të SHKÇAK që të shfaqet ndonjëherë në të ardhmen e afërt. Çdo shoqatë e re duhet të demonstrojë për KKRF se ka plotësuar të gjitha kërkesat e ligjit dhe në përputhje me të gjitha standardet, udhëzimet dhe rekomandimet e nxjerra nga FNK.

43. **Ligji i Raportimit Financiar kërkon auditorët e licencuar të jenë anëtarë të një shoqate të njohur të kontabilitetit.** Në teori, kjo mund të rezultojë në skenarin ku disa shoqata profesionale të përfshijnë auditorë. Megjithatë, duke pasur parasysh vogëlsinë dhe kontekstin e Kosovës, duhet të zhvillohet një organ i fortë profesional. **Në të vërtetë, duke pasur parasysh kompetencat e dëshmuara të disa anëtarëve të SHKÇAK, duhet të shqyrtohet një formë e një ndihme të përkohshme nga SHKÇAK për të përmirësuar kapacitetin e KKRF-së.**

44. **BKSFR kishte njohur SHKÇAK-un si organi profesional i kontabilitetit në Kosovë (duke përfshirë auditimin), dhe supozohet se njohja e SHKÇAK-ut vazhdon në bazë të Ligjit për Raportim Financiar.** Duke qenë përfitues i ndihmës së konsiderueshme të donatorëve, SHKÇAK ka zhvilluar një program të mirë certifikimi për kontabilistë dhe auditorë. Programi aktual është krahasuar me standardet e Bordit të Standardeve ndërkombëtare të arsimit në kontabilitet (BSNAK) me kërkesat e Direktivës së BE për Auditimin Ligjor, ka një strukturë tre-fazore që është e ngjashme me atë të programit të kualifikimeve të Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar (ACCA).

45. **Me një numër të anëtarëve prej rreth 700, SHKÇAK është në gjendje të krijojë të ardhura të mjaftueshme dhe tani e financon veten.** Të ardhurat nxirren kryesisht nga aktivitetet e arsimit profesional (para dhe pas kualifikimit), të cilat përbejnë rreth 80% të të ardhurave të saj totale. SHKÇAK nuk ka pasur sukses për të bindur anëtarët e

saj për të paguar taksat vjetore për anëtarësim. Këto paguhen vetëm nga auditorët, të cilët duhet të jenë anëtarë në gjendje të mirë të një shoqate profesionale, si dhe nga studentët, të cilët nuk lejohet të hyjnë në provime në qoftë se kanë borxh të papaguar. Anëtarët e tjerë paguajnë taksat e tyre vetëm në mënyrë sporadike, por, për arsye taktike, SHKÇAK ka zgjedhur të mos marrë masa disiplinore kundër anëtarëve që nuk paguajnë. Siç është përmendur në Raportin RRSK 2006, "mungesa e një tradite të auditimit të jashtëm në Kosovë dhe trashëgimia e kulturës së kontrollit kanë kontribuar në një mungesë të përgjithshme të vetëdijesimit në biznes dhe komunitetin më të gjerë për përfitimet e mundshme të auditimit, dhe rëndësinë potenciale të rolit të një kontabilisti të kualifikuar mirë në zhvillimin ekonomik të Kosovës". Kjo deklaratë mbetet valide, edhe pse ka pasur disa përmirësime. Kontabiliteti ende shihet nga shumë persona si një barrë rregullative, jo si burim i informatave për vendim-marrje dhe qëllime planifikimi. **Edhe KKRF edhe SHKÇAK duhet të vazhdojnë të punojnë për të ngritur vetëdijen për të mirat e kontabilitetit dhe auditimit, për të zhvilluar më tutje vargun e konsultimeve me bizneset për ndryshimet në legjislacion dhe për rëndësinë e pajtueshmërisë dhe transparencës që janë organizuar në gjysmën e parë të vitit 2012.**

46. **SHKÇAK me sukses ka plotësuar kushtet e anëtarësimit dhe është pranuar si anëtare e plotë e FNK në vitin 2009.** Ka pasur tri rekomandime kryesore në lidhje me SHKÇAK-un në raportin e RRSK për vitin 2006. Ato përfshijnë të mëposhtmet:

- Të ofrojnë zhvillim të vazhdueshëm profesional (ZHVP) dhe aftësim;
- Të rregullojnë dhe monitorojnë anëtarët e vet që janë të angazhuar në praktikë publike; dhe
- Të vendosë procedura për disiplinimin e anëtarëve të saj.

SHKÇAK aktualisht operon një program të ZHVP, dhe është duke zhvilluar (me shoqatën profesionale holandeze, NIVRA) procedurat për rregullimin dhe monitorimin e performancës së anëtarëve të vet të angazhuar në praktikën publike. **Megjithatë, ekziston nevoja për të vepruar në koordinim me KKRF mbi procedurat disiplinore, dhe ende nuk ka ndodhur asnjë veprim i tillë i koordinuar.**

II.C Arsimi dhe aftësimi për kontabilitet

47. **Planprogrami mësimor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (UP) është modernizuar, megjithatë, nuk ka integrim të arsimit profesional, sepse universitetet dhe SHKÇAK nuk kanë rënë dakord për kushtet.** Në vitin 2008, pesë studentë nga UP u dërguan në një program të financuar nga USAID-i për të studiuar për dymbëdhjetë muaj në një program Master të Kontabilitetit në Universitetin Shtetëror të Arizonës. Kushtet e financimit përfshinin dedikimin nga UP për të mbajtur ata individë pas kthimit të tyre në Kosovë si anëtarë të Departamentit të Kontabilitetit. Pas kthimit të tyre në Kosovë në vitin 2009, këta individë zhvilluan një program tre-vjeçar të kontabilitetit. Megjithatë, katër nga pesë individët tashmë janë larguar nga UP. Programi u zbatua, por diskutimet për integrimin e programit të UP-së dhe programit të certifikimit të SHKÇAK nuk kanë pasur ende rezultate të prekshme.

48. **Nuk është e qartë deri në çfarë mase programi i kontabilitetit në UP është sipas programit të krijuar në vitin 2009, dhe të diplomuarit e kontabilitetit nga UP nuk kanë marrë përjashtim nga programi i certifikimit të SHKÇAK.** Burimet e kufizuara dhe përpjekjet e studentëve do të shfrytëzohen në mënyrë më efektive nëse këto programe janë të

integruara, por integrimi nuk duhet të kërkojë që SHKÇAK të komprometojë rregullat dhe procedurat e rrepta të saj. **Të gjitha palët e interesuara duhet të pranojnë se dështimi për të kapërcyer dallimet ndërmjet profesionit (përfaqësuar nga SHKÇAK) dhe UP dëmton perspektivat për ngritjen e standardit të arsimit të kontabilitetit në Kosovë.**

49. **KKRF është përgjegjës për cilësinë e arsimit profesional.** Ligji mbi Raportimin Financiar përcakton se, në mënyrë që të bëhet auditor, individit duhet të jetë një anëtar i një shoqate të njohur profesionale. Më tej, ligji kërkon që shoqatat profesionale mund të certifikojnë vetëm ata individë të cilët kanë përfunduar një program certifikimi që përputhet me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të Kontabilitetit (SNE)²⁷. KKRF është përgjegjës për certifikimin e shoqatave të kontabilitetit, një prej kriterëve është cilësia e programit të certifikimit të shoqatës kandidate, pra KKRF ka një kontribut vendimtar në lidhje me cilësinë e arsimit profesional. Ka pasur më herët përpjekje nga individë apo grupe të individëve për të përmbushur kërkesën për të zhvilluar një program të certifikimit cilësor duke parashtruar te BKSFR kopje të paautorizuara të materialeve të SHKÇAK; BKSFR ka refuzuar të gjitha këto aplikime.

50. **SHKÇAK ka krijuar një program për të certifikuar profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit që përputhet me Ligjin mbi Raportimin Financiar. Programi u përmirësua ndjeshëm pas vitit 2006 për të trajtuar kufizimet e vendosura për hyrje në profesion nga ky ligj. Programi aktual i certifikimit në SHKÇAK plotëson kërkesat e Direktivës së Auditimit Ligjor dhe Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit (SNEs).** Planprogrami mësimor i SHKÇAK për teknikë të kontabilitetit, kontabilistë të certifikuar dhe auditorë fillimisht ishte themeluar në vitin 2001, dhe ka tërhequr rreth 4000 aplikantë që nga atëherë. Kjo është dëshmi *prima facie* e kërkesës së madhe për trajnim profesional. Ky program, i cili bazohet në materialet e trajnimit të përkthyer dhe të përditësuara rregullisht nga ACCA, përbëhet prej tri fazave të mëposhtme:

Kualifikimi dhe numri	Kërkesa për regjistrim	Kërkesa e provimit	Kërkesa e përvojës
Teknik i kontabilitetit Në dhjetor 2011 - 368 (135 aktivë)	Njësoj si për pranim në program universitar	• Kontabiliteti financiar 1 • Kontabiliteti i kostos • Sistemet informative të menaxhimit • Ligji tregtar dhe tatimet	Një vit përvojë në kontabilitet
Kontabilist i certifikuar Në dhjetor 2011, 221 (119 aktivë)	Diplomë universiteti në ekonomi ose biznes dhe provimet e teknikut të kontabilitetit të përfunduara	• Raportimi financiar • Auditimi • Menaxhimi financiar • Kontabiliteti i avancuar menaxherial	Dëshmi për të paktën tri vite përvojë në kontabilitet

²⁷ IES lëshohen nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit në Kontabilitet i FNK-së (BSNAK).

Kualifikimi dhe numri	Kërkesa për regjistrim	Kërkesa e provimit	Kërkesa e përvojës
Auditor Në dhjetor 2011, 139 (96 aktivë, duke përfshirë 11 për të cilët është bërë përjashtim nga kërkesat)	Përfunduar faza e kontabilistit të certifikuar	- Raportimi financiar i avancuar - Auditimi dhe siguria e avancuar - Menaxhimi strategjik - Praktika profesionale	Dëshmi të së paku tri vite përvojë të punës me auditor

51. **Kufizimi në ligjin e ri mbi Raportimin Financiar kufizon hyrjen në profesion (si Kontabilist i Certifikuar) për të diplomuarit e kontabilitetit, biznesit, ose ekonomisë. Nëse nuk përshtatet, ky kufizim do të ketë pasoja shkatërruese për studentët aktualisht të regjistruar në programin e certifikimit të cilët nuk e përmbushin këtë kriter.** Në tetor 2012, KKRF ka prezantuar një marrëveshje kalimtare, për t'u mundësuar profesionistëve që aspirojnë të cilët kanë diplomë universitare në fusha të tjera, dhe të cilët janë regjistruar në Programin certifikues të SHKÇAK para miratimit të Ligjit të ri, të përfundojnë programin dhe të hyjnë në profesion.

52. **Kërkesat e hyrjes në SHKÇAK për programin e saj të arsimit profesional për kontabilistë dhe auditorë janë në përputhje me SNE 1, *Kërkesat e Hyrjes në një Program të Arsimit Profesional*, si dhe përmbajtja e programit të arsimit profesional të kontabilitetit është në përputhje me SNE 2, *Përmbajtja e Programeve të Arsimit Profesional*.** Programi, i cili është i bazuar në tekstet shkollore të një edukatori të njohur ndërkombëtarisht, është tash në përputhje me SNRF dhe SNA, mungesa e harmonizimit të tillë është përmendur në raportin RRSK të vitit 2006 dhe është vlerësuar si "një dobësi e madhe".

53. **SHKÇAK ka implementuar një sistem të para-aprovimit, monitorimit dhe kontrollit efektiv të cilësisë së përvojës së marrë nga kontabilistët dhe auditorët, siç kërkohet nga SNE 5, *Kërkesat e përvojës praktike*.** Megjithatë, sistemi është fokusuar në vlerësimin e pajtueshmërisë formale me kriteret e vendosura (p.sh., numri i kërkuar i orëve të kaluara në auditim, tatime dhe kontabilitet); aspekti cilësor ende mungon nga vlerësimi i përvojës praktike.

54. **Politikat e provimeve në SHKÇAK janë modeluar në dokumentin këshillues të Administrimit të Provimit të dhënë nga FNK, dhe plotësojnë kërkesat e SNE 6, *Vlerësimi i Aftësive dhe Kompetencës Profesionale*.** Në fillim kur është themeluar, SHKÇAK ka zbatuar masa për të siguruar anonimitet për kandidatët dhe për të mbrojtur integritetin e procesit të provimit. Ishte më e vështirë të sigurohet që personat e angazhuar në ofrimin e kurseve të mos kenë qenë të përfshirë në formulimin ose administrimin e provimeve dhe kjo rezultoi nga kapaciteti shumë i kufizuar i SHKÇAK në fillim të saj. Ndërsa grupi i tutorëve dhe ekzaminuesve është rritur, procedurat e SHKÇAK për ruajtjen e anonimitetit të kandidatëve dhe pavarësisë së ekzaminuesve janë bërë më rigorozë.

55. **Kontabilistët dhe auditorët kërkohet të marrin pjesë në programet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional (ZHVP).** SNE 7, *Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional* rregullon kërkesën për ZHVP për të gjithë kontabilistët dhe auditorët. Që nga viti 2008,

SHKÇAK ka kërkuar që të gjithë kontabilistët e certifikuar (dhe, kështu, edhe auditorët) të marrin pjesë në 40 orët e ZHVP çdo vit; kontabilistët e certifikuar duhet të kenë së paku 18 orë ZHVP formale, të verifikueshme në vit, dhe auditorët e licencuar kanë nevojë për 24 orë formale, të verifikueshme të ZHVP. Anëtarët kërkohet të vlerësojnë cila përmbajtje e ZHVP është e rëndësishme për ta, bazuar në punën e tyre dhe/ose specializimin.

56. **SHKÇAK ka bërë progres në punën drejt pajtueshmërisë me deklaratat e obligimeve të anëtarësisë (DOA) të lëshuara nga FNK.** Duke pasur parasysh se SHKÇAK nuk ka asnjë rol në vendosjen e standardeve, DOA 3, 5 dhe 7 (zbatimi i ISA, SNKSP dhe SNRF) nuk janë me të vërtetë në fuqi, edhe pse ekspertiza e SHKÇAK në bazë joformale kërkohet rregullisht nga KKRF (dhe më herët nga BKSFR). SHKÇAK ka respektuar DOA 2 dhe 4 (SNE dhe Kodi i Etikës i vitit 2010). SHKÇAK ka nevojë të përmirësojë përputhshmërinë me DOA 1 dhe 6 ("Sigurimi i cilësisë" dhe "Hetimi dhe Disiplina"). Një sistem i sigurimit të cilësisë është zhvilluar me ndihmën e shoqatës profesionale holandeze, NIVRA, megjithatë, nuk ka pasur rezultate të prekshme në dispozicion në kohën e përfundimit të këtij raporti. Siç u përmend më lart, çështja e hetimit dhe disiplinës duhet të trajtohet në koordinim me KKRF, që mban autoritetin legjislativ të kërkuar. Deri tani, SHKÇAK nuk ka kryer një procedurë hetimi dhe disiplinore, dhe përmirësimi në këtë fushë është i nevojshëm urgjentisht.

II.D Vendosja e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit

57. **Ligji mbi Raportimin Financiar kërkon që KKRF të lëshojë standardet e kontabilitetit që përputhen me SNRF.** Siç ishte rasti në vitin 2006 me BKSFR, struktura aktuale dhe burimet e KKRF janë të pamjaftueshme për të mundësuar që ta përmbushë plotësisht këtë mandat. KKRF është hartues i standardeve dhe rregullator për sektorët jo-financiarë. Formulimi i Ligjit mbi Raportimin Financiar nuk përmend Standardet Kosovare të Kontabilitetit (SKK) në nenin 5 (standardet e zbatueshme të kontabilitetit), edhe pse neni 14 e bën KKRF përgjegjës për zhvillimin e SKK-ve. Në mars të vitit 2012, KKRF ka nxjerrë një udhëzim administrativ duke sqaruar se SKK janë në fuqi për vitin 2012 për të gjitha kompanitë, SNRF duhet të zbatohen në periudhat e ardhshme, duke filluar nga 1 janari 2013. Duke pasur parasysh kompleksitetin e SNRF, një pasiguri e konsiderueshme ekziston në komunitetin e kontabilitetit nëse kjo kërkesë është realiste. KKRF ka punuar me MEF-in për ta zgjidhur këtë çështje.

58. **Profesioni i kontabilitetit është i rregulluar, si dhe Raporti RRSK për K&A 2006 arriti në përfundimin se, "... BKSFR nuk ka zhvilluar ende kapacitetin për të kryer mandatin e tij". RRSK aktual ka arritur në përfundimin se, pavarësisht nga asistenca teknike dhënë BKSFR pas vitit 2006, nuk ka ndryshuar shumë, në këtë fushë në të vërtetë, në disa mënyra, KKRF po fillon nga fillimi.** Si ligji i UNMIK-ut, Ligji mbi Raportimin Financiar parasheh financimin e KKRF përmes buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe, siç ka vënë në dukje raporti i mëparshëm RRSK, niveli i financimit është i pamjaftueshëm që KKRF të kryejë përgjegjësitë e veta. Përgjegjësitë e KKRF përfshijnë: (i) hartimin dhe miratimin e Standardeve Kosovare të Kontabilitetit (SKK), në përputhje me SNK/SNRF dhe direktivat përkatëse të BE-së (megjithatë, **SKK nuk janë përmendur në nenin mbi standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë**), (ii) mbikëqyrjen dhe zbatimin e standardeve të auditimit, në pajtim me SNA dhe direktivat përkatëse të BE-së, (iii) licencimin dhe mbajtjen e regjistrit të auditorëve, dhe të firmave të auditimit, si dhe shoqatave profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve, (iv)

përcaktimin e standardeve të etikës profesionale dhe cilësisë së brendshme që do të respektohen nga firmat e auditimit; (v) mbikëqyrjen e arsimimit të vazhdueshëm profesional, sigurimin e cilësisë dhe sistemin disiplinor për këtë profesion.

59. **KKRF përbëhet nga shtatë anëtarë. Kryetari dhe anëtarët tjerë të KKRF emërohen nga Qeveria për afate trevjeçare (lejohet një riemërim i njëpasnjëshëm), në bazë të propozimeve të bëra nga institucionet e mëposhtme: BQK (1), akademia (1), MEF (1), profesioni (1), si dhe komuniteti i biznesit (3).** Përveç përgjegjësive të listuara më sipër, Ligji për Raportimin Financiar kërkon që KKRF të mbledhë dhe të publikojë pasqyrat financiare të atyre ndërmarrjeve afariste që kërkohet të publikojnë pasqyrat e tyre financiare. Aktualisht, KKRF nuk ka kapacitet as me personel dhe as teknik për të përmbushur këtë përgjegjësi shtesë, prandaj, nuk është e qartë se si do të realizohet ky funksion. Duke qenë se tarifat dhe sanksionet e mbledhura nga KKRF janë të ardhura të buxhetit, ka nevojë të **rishikohet " modeli i biznesit" për KKRF-në**, nuk është e mundshme që KKRF mund të përmbushë të gjitha përgjegjësitë e veta në kuadër të strukturës së tij ekzistuese. **Duke pasur parasysh madhësinë e ekonomisë së Kosovës, vlerësohet se pesë profesionistë të kualifikuar mirë dhe me përvojë janë të nevojshëm për ta bërë KKRF plotësisht funksional.**

60. **Siç u përmend më lart, KKRF urgjentisht duhet të shqyrtojë nëse " modeli i biznesit" për të është i përshtatshëm për kryerjen e përgjegjësive të tij.** Edhe pse katër komisione profesionale janë emëruar në vitin 2011, nuk është e mundshme që komisionet do të jenë në gjendje për të kryer të gjitha detyrat për vendosjen e standardeve dhe detyrat rregullative, pa përkrahje të konsiderueshme, dhe përkrahjen e të paktën katër ose pesë ekspertëve me përvojë dhe të kualifikuar që do të punojnë aty, d.m.th., ekspertë të punësuar nga KKRF. Në të njëjtën kohë, KKRF duhet të përfitojë shumë nga progresi i Shqipërisë, ku SNRF janë përkthyer dhe azhurnohen çdo vit²⁸. Shqipëria ka rregulluar edhe përkthimet e SNA (Botimi i përkthyer 2010) dhe Kodin e Etikës së FNK (botimi i vitit 2006, i cili tashmë është ndërruar, është versioni i vetëm që është përkthyer). Ndërsa ka disa dallime në terminologji, përdorimi i këtyre përkthimeve shqiptare është zgjidhja optimale për Kosovën.

61. **Raporti i RRSK i vitit 2006 erdhi në përfundimin se "stafi i tanishëm i sekretariatit të BKSFR-së është joadekuat për të mundësuar që BKSFR të rregullojë kontabilitetin dhe auditimin në mënyrë efektive".** Ky raport vjen në të njëjtin përfundim. Punëtorët e zyrës së KKRF-së (Sekretariatit) nuk kanë përvojën në kontabilitet ose auditim që është e nevojshme për të dhënë përkrahje teknike për komisionet dhe KKRF. Përveç kësaj, nëse nuk ka ndryshime themelore në mënyrën se si punon KKRF, ky problem nuk ka gjasa të trajtohet në planin afatshkurtër dhe afatmesëm; pamundësia e KKRF për të punësuar (dhe mbajtur) personel të kualifikuar, si pasojë e nivelit të pagave të qeverisë, që është shumë nën normat e tregut, rëndë e kufizon aftësinë e saj për të zhvilluar kapacitetet e nevojshme. Që KKRF të kryejë plotësisht përgjegjësitë e saj, janë të nevojshme burime alternative të financimit – diapazoni i plotë i detyrave të transferuara te KKRF nuk mund të financohen vetëm nga buxheti. **Ngjashëm me përvojën e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, KKRF do të përfitojë shumë nga një program binjakëzimi apo një marrëveshje ekuivalente për të "importuar" kapacitetet institucionale dhe për të zbutur rrezikun e kapjes rregullative.**

²⁸ <http://www.kkk.gov.al/faqe.php?id=1&l2=101>

62. **BQK-ja vendos kërkesat e kontabilitetit për bankat dhe ndërmarrjet e sigurimit. Sistemet që kanë rezultuar përmbushin objektivat e BQK-së, por ato nuk janë në përputhje të plotë me "SNRF të plotë".** Edhe pse ekzistojnë diferenca (Provizionet e kredive dhe rezervat teknike) ndërmjet rregullave të BQK-së për raportimin financiar dhe SNRF-ve, dallimet nuk përfaqësojnë vështirësi të madhe edhe në rastet kur shumat janë materiale. BQK-ja ka diskutuar me ekipin e RRSK mundësinë e një shpalosjeje të barazimit në fusnotë, e cila do të eliminonte praktikën e tanishme kur duhet të përgatiten dy grupe pothuajse identike të pasqyrave financiare dhe dy raporte të auditorit; rregullorja përkatëse është hartuar më vonë dhe janë kërkuar pikëpamjet e ekipit të RRSK.

II.E Zbatimi i standardeve të kontabilitetit dhe auditimit

63. **Ndryshe nga Rregullorja e UNMIK-ut, Ligji mbi Raportimin Financiar përmban sanksione për mos-zbatim të tij. Megjithatë, KKRF-së aktualisht i mungon kapaciteti për të zbatuar ligjin dhe, nëse nuk zhvillohet kapaciteti i nevojshëm, kjo situatë nuk ka gjasa të ndryshojë në të ardhmen e parashikueshme.** Ky problem i kapacitetit është përkeqësuar nga dispozitat në Ligj që kërkojnë transferimin e të gjitha fondeve të mbledhura nga KKRF në buxhetin e konsoliduar të shtetit. Siç është përmendur në raportin e RRSK të 2006 dhe gjithashtu më herët në këtë raport, një rritje thelbësore në kapacitetin institucional të KKRF është e nevojshme që KKRF të përmbushë të gjitha kërkesat e ligjit. Për të ardhmen e afërt, një përfshirje më e madhe të profesionit mund të shërbejë si zgjidhje e përkohshme, duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë të SHKÇAK.

64. **BQK-ja monitoron dhe zbaton pajtueshmërinë me SNRF, të zbatuara në Kosovë, në pasqyrat financiare të lëshuara nga bankat, kompanitë e sigurimit, IMF-të dhe ato institucione financiare jobankare (IFJB) që i zbatojnë SNRF-të.** Edhe pse rregulloret dhe mbikëqyrja e kujdesshme marrin më shumë vëmendje sesa zbatimi i standardeve të kontabilitetit në përgatitjen e pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme, BQK-ja angazhon inspektorë për shqyrtimin e përputhshmërisë me kërkesat e raportimit financiar.

65. **Edhe pse mbështetet në auditorët për të ngritur problemet e mos-përputhshmërisë me SNRF në pasqyrat financiare të përgjithshme, BQK-ja ka zhvilluar një kapacitet të vetin për të zbatuar SNRF-të.** Që nga RRSK 2006, kapaciteti i BQK-së për të shqyrtuar pasqyrat financiare të paraqitura nga ana e bankave dhe kompanive të sigurimit është rritur, përveç kësaj, rreziku lidhur me mos-përputhshmërinë është kompensuar nga mungesa e përfshirjes së bankave në transaksionet komplekse financiare. Megjithatë, si në të kaluarën, BQK-ja mbështetet në firmat e auditimit që janë pjesë e firmave ndërkombëtare për të verifikuar se bankat dhe kompanitë e sigurimeve janë në përputhje me SNRF-të. Një koment nga RRSK 2006 në lidhje me varësinë e BQK-së nga auditorët vlen ende: *"Nuk përkrahet nga një sistem adekuat i sigurimit të jashtëm të cilësisë që i nënshtrohet mbikëqyrjes publike. Rrjedhimisht, firmat e auditimit nuk monitorohen në thelb dhe ka pak siguri në lidhje me cilësinë e auditimeve të tyre përveç se të mbështetemi në reputacionin e tyre"*.

III. Praktikët e vëzhguara të raportimit dhe auditimit

III.A Statusi i aprovimit të SNRF-ve në Kosovë

66. Dy grupe të standardeve të kontabilitetit kanë qenë në fuqi në Kosovë, nga viti 2001: (i) Standardet Kosovare të Kontabilitetit (një përzgjedhje e modifikuar e "SNK të vitit 2001"), ose "SKK", dhe (ii) SNRF. SKK kurrë nuk janë azhurnuar. Rishikimi i SKK-ve është bërë në vitin 2006, si pjesë e RRSK të K&A të parë. Siç është pritur, ai ka identifikuar dallime të rëndësishme ndërmjet SKK dhe SNRF tashmë në atë kohë. Disa nga dallimet, që ende ekzistojnë ndërmjet SKK dhe SNRF përfshijnë:

- *Dëmtimi i pasurive mund të njihet ose të mos njihet sipas SKK.*
- *Detyrimet për përfitimet nga punësimi mund të jenë nën-vlerësuar.*
- *Nuk ka ekuivalent në SKK për SNK 41, Bujqësia.*
- *SKK nuk merren me pasqyrat financiare të konsoliduara.*
- *SKK nuk janë azhurnuar për të përfshirë SNRF të reja dhe të rishikuara, duke përfshirë rishikimet e SNK që janë lëshuar nga BSNK që nga viti 2001.*

KKRF vendosi që të kërkojë SKK-të në vitin 2012 dhe synon të paraqesë SNRF-të për NVM-të në vitin 2013.

67. **Ligji mbi Raportimin Financiar kërkon nga KKRF të nxjerrë standarde të auditimit që përputhen me SNA.** Siç u përmend më lart (paragrafi 60), KKRF duhet të përfitojë nga përkthimi i Shqipërisë i SNA-ve, duke pasur parasysh se aktualisht nuk ka kapacitete për të futur standardet e veta të auditimit. Më tej, përdorimi i përkthimit nga Shqipëria është gjithashtu i rekomanduar për shkak të politikës së FNK për të përkrahur, ku është e mundur, vetëm një përkthim të standardeve të saj në një gjuhë të caktuar. Në shtator 2012, është nënshkruar një memorandum për shfrytëzimin e përkthimit të Shqipërisë së SNA-ve në Kosovë, me organin për përkthime në Shqipëri, IEKA.²⁹

68. Në vitin 2006, aktualisht nuk ekziston asnjë mekanizëm për monitorimin dhe zbatimin e standardeve të auditimit dhe kërkesat e tjera që lidhen me auditimin e bankave. Kjo është përkeqësuar më tej nga mungesa e qartësisë së kush e ka autoritetin e zbatimit. BQK-ja nuk ka fuqi të zbatimit në lidhje me sigurimin e cilësisë (përveç për aprovimin e auditorëve të bankave) dhe, asnjë agjenci tjetër nuk ka kompetenca të tilla, duke qenë se Ligji mbi Raportimin Financiar e përjashton BQK-në nga zbatimi i standardeve të auditimit dhe KKRF nga aktivitetet rregullative në sektorin bankar. SHKÇAK ka krijuar një skemë të shqyrtimit të cilësisë për auditorët, megjithatë, zhvillimi i sistemit është një përpjekje në afat të mesëm dhe të gjatë.

69. **Cilësia e auditimit në mesin e subjekteve sipas një forme të rregullimit, p.sh., nga BQK-ja apo nga një kompani prind e huaj, është përmirësuar ndjeshëm.** Megjithatë, problemet që rezultojnë nga mungesa e të kuptuarit dhe përdorimit të duhur të ISA-ve vazhdojnë, edhe pse në një masë më të vogël se në vitin 2006. Raporti i 2006 vuri në dukje se, "... problemet me objektivin e auditimit, vlerësimin e rrezikut të auditimit,

²⁹ <http://www.ifac.org/about-ifac/translations-permissions/translations-database>

procedurat themelore të auditimit, si dhe probleme të tjera të tilla të përbashkëta" kanë ekzistuar. Ndërsa SHKÇAK ka bërë progres të rëndësishëm në futjen dhe zbatimin e kërkesave të ZHVP-së, moskuptimi i duhur i parimeve të auditimit, dhe objektivit, performancës dhe dokumentacionit të auditimit ende mbizotëron në mesin e shumë praktikuesve individë dhe në shumë firma të vogla.

III.B Rishikimi i pasqyrave financiare

70. **Kjo RRSK ka shqyrtuar një mostër prej 22 grupesh të pasqyrave financiare të audituara:**

- Pesëmbëdhjetë grupe janë përgatitur në përputhje me SNRF, dhe shtatë grupe janë përgatitur në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit (SKK);
- Shtatë grupe të pasqyrave financiare të audituara ishin nga sektori financiar, duke përfshirë tri banka (dy vendase dhe një të huaj), tri kompani të sigurimeve (dy të huaja, një vendase) dhe një institucion mikrofinanciar. Të gjitha këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me SNRF;
- Dy grupe të pasqyrave financiare të audituara ishin të ndërmarrjeve publike, të përgatitura në përputhje me SNRF;
- 13 grupe të pasqyrave financiare ishin të korporatave të tjera; gjashtë prej të cilave janë përgatitur në përputhje me SNRF, dhe shtatë në përputhje me SKK.
- Pasqyrat Financiare që janë rishikuar janë audituar edhe nga firmat anëtare të rrjeteve të mëdha ndërkombëtare (Big Four – katër firmat e mëdha) edhe nga firmat anëtare të rrjeteve ndërkombëtare të nivelit të dytë. Nga 22 opinione të auditimit, dhjetë ishin të pastra, dy të pastra me theksim të çështjes, gjashtë ishin të kualifikuara, një e kualifikuar me theksim të çështjes, një e kualifikuar me një tjetër çështje, dhe dy ishin me mohim të opinionit.

71. **Në përgjithësi, në krahasim me RRSK 2006, cilësia e raportimit financiar, si dhe auditimeve, veçanërisht në sektorin financiar, është përmirësuar.** Rishikuesit nuk kanë identifikuar dallime materiale nga standardet e zbatueshme në pasqyrat financiare që janë rishikuar, por prapë janë vërejtur shumë mangësi. Duhet të kemi kujdes, megjithatë, para se të nxjerrim ndonjë përfundim të gjerë nga rezultatet e këtij shqyrtimi. Pothuajse të gjitha pasqyrat financiare të rishikuara i nënshtrohen ndonjë forme të rregullimit ose zbatimit, qoftë nga BQK-ja ose nga një kompani e huaj prind, si rezultat, këto kompani ka gjasa të jenë financiarisht më të forta dhe me kontabilitet më të mirë sesa kompanitë e zakonshme. Lista e komenteve të bëra nga rishikuesit është bashkangjitur në Aneksin 1.

III.C Perceptimet e cilësisë së raportimit financiar

72. Raporti i RRSK 2006 arriti në përfundimin se, **"Raportimi financiar i korporatave në Kosovë perceptohet të jetë i cilësisë shumë të ulët, me përjashtim të pasqyrave financiare të audituara të institucioneve financiare, të cilat perceptohet të jenë të cilësisë relativisht të lartë".** Për të marrë informacion, ekipi i RRSK organizoi një seminar në Prishtinë më 16 prill 2012. Seminari u ndoq nga pothuajse 40 kontabilistë dhe auditorë profesionistë, anëtarë të SHKÇAK. Pjesëmarrësit përfaqësuan në radhë të parë kontabilistët profesionistë në biznes, rreth një e treta e tyre janë auditorë të licencuar. Më poshtë është një përmbledhje e pikëpamjeve të tyre.

73. **Cilësia e ulët e raportimit financiar vazhdon në segmentin më të madh të bizneseve të Kosovës – mikro-subjektet - dhe, në një shkallë më të vogël, në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.** Raportimi financiar në mesin e institucioneve financiare dhe subjekteve të audituara nga firmat anëtare lokale të rrjeteve ndërkombëtare perceptohet se është përmirësuar dukshëm.

74. **Ka një perceptim, veçanërisht në mesin e kontabilistëve profesionistë, se kapaciteti rregullativ në lidhje me kontabilitetin dhe auditimin nuk është çfarë duhet të jetë, megjithë një përmirësim gjatë dy viteve të fundit.** Disa besojnë se kontabiliteti duhet të rregullohet në mënyrë të ngjashme me auditimin për të siguruar përmirësimin e cilësisë. Duket të ketë një perceptim se raportimi financiar është përmirësuar në përgjithësi gjatë pesë viteve të fundit. Shumë kontabilistë besojnë se prania e kërkesave ligjore për auditim, si dhe angazhimi në rritje i SHKÇAK, kanë shtyrë përmirësimet.

75. **Çështja se kërkojnë grupe të ndryshme të pasqyrave financiare për përdoruesit e ndryshëm, në një farë mase, është zvogëluar dhe nuk konsiderohet më një problem i përhapur.** Edhe pse ka pasur një rritje në përdorimin e pasqyrave financiare nga institucionet financiare, bankat prapë japin kredi për bizneset kryesisht në bazë të fuqisë së kolateralit të ofruar. Pasi që shumica e kompanive menaxhohen nga pronarët, pronarët nuk janë zakonisht përdorues të pasqyrave financiare. Në të njëjtën kohë, ekziston një perceptim se perceptimi i menaxhmentit sa i përket dobisë së pasqyrave financiare dhe auditimit është rritur që nga viti 2006. Megjithatë, ka ende nevojë për trajnim të konsiderueshëm në zbatimin e SNRF-ve si dhe SNA-ve.

76. **Shpalosjet në përgjithësi shihen si joadekuate në atë se ato zakonisht përfshijnë vetëm një nën-ndarje të shumave në pasqyrat financiare, pa një diskutim të politikave ose informacion shtesë që është relevant për përdoruesit dhe që kërkojnë nga standardet e raportimit.** Ekziston gjithashtu një perceptim se udhëzimi administrativ i lëshuar së fundmi nga KKFR për të gjitha kompanitë që të përdorin SKK në vitin 2012 dhe më pas SNRF nuk është realist, zbatimi i SNRF-ve do të rezultojë në kosto të konsiderueshme shtesë për subjektet e vogla. Për ta zgjidhur këtë, KKRF ka treguar se është duke punuar me Ministrinë e ekonomisë dhe financave për ta ndryshuar ligjin dhe për të futur SNRF-të për NVM-të në vitin 2013.

77. **Në lidhje me arsimimin për kontabilitet, ka një ndjenjë të përmirësimit në nivel universitar që nga RRSK 2006, por nuk është i mjaftueshëm.** Shumë kontabilistë mendojnë se arsimi i lartë është, në përgjithësi, ende i lidhur me "mënyrën e vjetër" të punës dhe se koordinimi i përpjekjeve ndërmjet palëve të ndryshme (p.sh., shkolla e mesme, SHKÇAK, universitetet) është i pamjaftueshëm.

78. **Kërkesa për një vazhdim vjetor të licencave të auditimit nga KKRF dhe BQK (për auditorët e institucioneve financiare) imponon një barrë të panevojshme rregullative dhe duhet të rishqyrtohet.** Procedura e vazhdimit nuk është automatike madje edhe në rastet kur licenca duhet të vazhdohet nëse plotësohen disa kriteret (p.sh., disa orë të ZHVP, tarifat profesionale, ndonjë veprim disiplinor, etj.). Në vend të kësaj, edhe firmat audituese edhe auditorët duhet të paraqesin një numër të dokumenteve në vit të KKRF dhe BQK, në rastin e auditorëve të institucioneve financiare, procesi është dyfishues si rezultat i kërkesave shtesë të vendosura nga BQK. Ky proces nuk ka gjasa të rrisë cilësinë e auditimit.

IV. Rekomandimet

79. **Rekomandimet e këtij azhurnimi të RRSK përfshijnë rekomandimet e RRSK 2006 që nuk janë trajtuar ende në mënyrë adekuate, shumica prej të cilave janë diskutuar tashmë në këtë raport. Ky raport përmban edhe rekomandime shtesë që kanë ardhur nga analiza e kryer në lidhje me këtë RRSK.** Në përgjithësi, rekomandimet bien nën gjashtë shtyllat kryesore të infrastrukturës së kontabilitetit dhe auditimit. Në shumë raste, reformat në çdo shtyllë duhet të zhvillohen në mënyrë paralele, sepse gjashtë shtyllat përforcojnë njëra-tjetrën. Për shembull, forcimi i procesit të përcaktimit të standardeve pa forcuar njësoj edhe mekanizmin e monitorimit dhe zbatimit do të dështojë dhe nuk do të arrijë të trajtojë mospërputhjen me standardet e kontabilitetit. Faktorët kritikë të suksesit për zbatim përfshijnë udhëheqjen nga nivelet më të larta të qeverisë, kapitalizimin për dëshirën për ndryshim dhe balancimin e stimulimeve dhe dënimeve për përputhshmëri me kërkesat e raportimit financiar.

80. **Ekipi i RRSK ka përgatitur "tabela të përputhshmërisë"³⁰ të detajuara që japin informacion lidhur me gjendjen aktuale të përafrimit të legjislacionit të Kosovës me Direktivat e BE për Kontabilitet dhe Auditim Ligjor.** Tabelat tregojnë se kërkohen shumë përmirësime. Shembuj të fushave ku nuk ka arritur të bëhet përafrimi janë në vijim:

- Zbatimi i kërkesave për publikimin e pasqyrave financiare;
- Përkufizimi, monitorimi dhe zbatimi i përvojës së parakualifikimit profesional për auditorë për auditime ligjore;
- Përcaktimi i rolit të shoqatave profesionale në sistemin e raportimit financiar - Ligji për Raportimin Financiar parasheh mundësinë e më shumë se një shoqate të kontabilitetit, megjithatë, nëse ndonjë shoqatë e tillë përfshin edhe kontabilistë edhe auditorë (si SHKÇAK), kjo ka gjasa të çojë në mosëfikasitet rregullativ dhe gabime në mjedisin rregullator të pazgjidhur të Kosovës.
- Krijimi i një regjistri publik të auditorëve dhe firmave audituese ligjore, që përmban të gjithë informacionin e kërkuar me Direktivën e Auditimit Ligjor të BE-së (të kërkuar me ligj);
- Krijimi i një sistemi funksional të mbikëqyrjes publike për profesionin e auditimit. Në këtë kontekst, duhet të synohet dhe të arrihet një ekuilibër ndërmjet rolit të SHKÇAK dhe KKRF. Një opsion i zbatueshëm mbetet, në një bazë të përkohshme, duke i dhënë SHKÇAK-ut një rol në rishikimin e sigurimit të cilësisë, që i nënshtrohet mbikëqyrjes publike nga KKRF;
- Zbatimi i programit të sigurimit të cilësisë që është duke u zhvilluar me ndihmën e NIVRA dhe
- Rishikimi i kritereve aktuale në lidhje me obligimin për auditim ligjor.

81. **Kërkesa ligjore për publikimin e pasqyrave financiare duhet të zbatohet.** Kjo kërkesë ka ekzistuar që nga viti 2001, por asnjëherë nuk është zbatuar. Pasqyrat financiare të asnjë subjekti me përjashtim të institucioneve financiare dhe disa NPP-ve nuk janë në dispozicion për publik. Kjo duhet të trajtohet. Në veçanti, kërkesa ligjore që nuk zbatohet

³⁰ Tabelat e përputhshmërisë janë në Aneksin 3.

nuk përbën harmonizim me legjislacionin evropian dhe kjo me siguri do të shënohet në ndonjë proces shqyrtimi të Komisionit Evropian në të ardhmen.

82. **Për sa i përket standardeve të kontabilitetit, duke u bazuar në progresin e arritur që nga viti 2006, KKRF duhet:**

- ***Të krijojë ose të miratojë standardet e kontabilitetit të zbatueshme për NVM-të dhe mikro-ndërmarrjet;*** nën interpretimin ekzistues të ligjit, këto subjekte pritet të zbatojnë SNRF të plota nga viti 2013 - kjo nuk është e arsyeshme dhe nuk do të ketë sukses. SKK ose SNRF për NVM-të duhet të shqyrtohen për NVM-të, me raportimin e tatimit në të ardhurat (p.sh., përmbledhja e faturave dhe pagesave) për mikro-subjektet;
- ***Monitorimi i zbatimit të SNRF;*** në sektorin financiar dhe jo-financiar, për institucionet financiare kjo duhet të realizohet në bashkëpunim të afërt me BQK-në;
- ***Konsideroni të hyni në një marrëveshje bashkëpunimi me Këshillin Shqiptar të Kontabilitetit,*** duke përfshirë konsultime për zbatimin;

83. **KKRF duhet të thellojë bashkëpunimin me Institutin e Auditorëve të Certifikuar dhe të Autorizuar të Shqipërisë (IEKA),** për përkthimin dhe miratimin e SNA-ve, përfshirë konsultimet mbi zbatimin;

84. **Në lidhje me monitorimin dhe zbatimin e Standardeve të Kontabilitetit dhe Auditimit, rekomandohet që:**

- KKRF dhe BQK-ja të rrisin kapacitetin e tyre duke punësuar më shumë anëtarë të personelit të cilët kanë njohuri për SNRF. Në mënyrë që të kryejnë rolin e tyre si agjenci që rregullojnë standardet e kontabilitetit, KKRF dhe BQK-ja duhet të punësojnë personel shtesë me njohuri të gjerë dhe përvojë në SNRF. Fakti që KKRF është i përfshirë brenda sektorit publik duhet të rishqyrtohet, pasi kjo mund të kufizojë aftësinë e KKRF-së që të rrisë kapacitetin e tij profesional. Duhet të merret në konsiderim që të bëhet KKRF një agjenci rregullative me vetë-financim;
- Në vitin 2006, është rekomanduar që të gjithë auditorët dhe firmat e auditimit duhet të i nënshtrohen një sistemi të sigurimit të cilësisë, që i nënshtrohet mbikëqyrjes publike. KKRF është zyrtarisht përgjegjës për sigurimin e cilësisë, por nuk ka as kapacitetin njerëzor dhe as profesional për ta kryer këtë detyrë. Aktualisht, kapaciteti i vetëm në dispozicion ekziston brenda profesionit, d.m.th. në SHKÇAK. Modeli i mbikëqyrjes duhet të marrë parasysh cili mekanizëm do të funksionojë më së miri në rrethanat aktuale të Kosovës. Për shembull, mund të merret në konsiderim modeli i vetë-rregullimit të mbikëqyrur, ku funksioni i hetimit kryhet nga SHKÇAK, por vlerësimi i gjetjeve dhe sanksioneve mund të bëhet nga KKRF. Sistemi i tillë mund të mos jetë menjëherë i harmonizuar plotësisht me *acquis*, në veçanti me Rekomandimin e Komisionit të datës 6 maj 2008, (2008/362/EC) mbi sigurimin e jashtëm të cilësisë për auditorët dhe firmat e auditimit të përzgjedhura të auditojnë subjektet me interes publik. Megjithatë, përfshirja e profesionistëve do t'i ndihmojë KKRF-së për të filluar një program të inspektimeve, dhe përfshirja e KKRF pastaj mund të rritet me kalimin e kohës, ndërsa zhvillohet kapaciteti i tij profesional. Një mundësi tjetër është që të përdoren inspektorët e Shqipërisë në Kosovë, megjithëse edhe ky opsion do të përballej me çështjen e financimit. Në çdo rast, siç ka demonstruar historia 10-vjeçare e BKSFR, status quo-ja nuk funksionon dhe ka nevojë për një ndryshim konfigurimi në mënyrë që kjo të ketë sukses. KKRF ka

marrë hapat e parë në këtë kontekst, duke përfshirë themelimin e Komitetit të Sigurimit të Cilësisë dhe inicimin e bashkëpunimit me palën homologe kroate. Pritet që cikli i parë i Sigurimit të Cilësisë të fillojë në vitin 2015.

- BQK dhe KKRF duhet të rishikojnë politikat e tyre të vazhdimin të licencës së auditimit me qëllim të lehtësimit të barrës ekzistuese rregullative ndërsa të përdorin kriteret si përputhja me ZHVP, rezultatet e shqyrtimit të cilësisë.

85. Në lidhje me zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, rekomandohet që:

- KKRF të përmirësojë regjistrin e auditorëve dhe firmave të auditimit (aktualisht, regjistri është një tabelë në Excel pa asnjë tregues për shpeshësinë e ndryshimeve) për ta përshtatur atë me kërkesat e Direktivës së Auditimit Ligjor;
- SHKÇAK të rrisë kapacitetin e saj në lidhje me sigurimin e cilësisë; siç tregohet më lart, kjo duhet të bëhet në koordinim me KKRF;
- Kërkesa për përvojë praktike duhet të sillet në përputhje me kërkesat e FNK, kërkesat aktuale për përvojën praktike janë rishikuar dhe ndryshimet janë duke u zbatuar për t'i sjellë kërkesat e përvojës praktike në përputhje me SNE 5³¹.

86. Në lidhje me arsimin dhe trajnimin, rekomandohet që:

- SHKÇAK dhe sektori i Universitetit të angazhohen prapë për çështjen që arsimimi cilësor për kontabilitet në universitete të jetë më i arritshëm dhe me përmbajtje më të mirë. Është e kotë për të gjitha palët e interesuara, nëse të diplomuarit e kontabilitetit në universitet nuk bëjnë përjashtim për programin e certifikimit në SHKÇAK. Në të njëjtën kohë, SHKÇAK duhet të marrë garanci se programi në universitet ofron një bazë të përshtatshme për kontabilistët e ardhshëm profesionalë.
- SHKÇAK të rrisë më tej programin e saj të ZHVP. Ka ende shumë mangësi të vërejtura në punën e praktikuesve individualë dhe praktikave të vogla. Duhet të ketë më shumë fokus në ZHVP në ato fusha ku janë vërejtur mangësi, për shembull:
 - SNA dhe SNRF;
 - Dokumentacioni i auditimit dhe dosja e auditimit;
 - Marrja e dëshmive të mjaftueshme të duhura të auditimit;
 - Vlerësimi i rrezikut të auditimit dhe ndikimi i tij në strategjinë dhe planifikimin e auditimit;
 - Formimi i një opinionit të auditimit dhe komunikimi me klientin, etj.

³¹ <http://www.ifac.org/sites/default/files/publications/files/ies-5-practical-experienc.pdf>

Aneks 1. Përmbledhja e rishikimit të pasqyrave financiare

SNA

Opinion i kualifikuar

- Në përgjithësi, raportet e auditimit janë kualifikuar për shkak se auditorët nuk ishin në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të duhura të auditimit. Në disa raste, megjithatë, baza për kualifikim nuk duket se është zbuluar dhe argumentuar në mënyrën e duhur.

Theksimi i çështjes

- Paragrafët e theksimit të çështjes kanë qenë rezultat i pasigurisë lidhur me vlerësimin pronësinë, përgjegjësinë në të ardhmen dhe detyrimet kontingjente tatimore.

SNRF

Pasuritë e paprekshme

- Dy raste të identifikuara të largimit nga standardi që përfshin klasifikimin dhe trajtimin e shpenzimeve të hulumtimit dhe zhvillimit.

Valuta funksionale dhe e prezantimit

- Valuta funksionale dhe e prezantimit nuk është shpalosur (SNA 21.8., "Efektet e ndryshimeve në normat e shkëmbimit valutor")

Rreziku kreditor

- Shpalosja jo e plotë në dy grupet e pasqyrave financiare (të pranueshmet tregtare dhe kreditë e zhvlerësuar)

Parimi i vazhdueshmërisë

- Në disa raste, shpalosja e menaxhmentit që kërkohet për vazhdueshmëri ka munguar.

Huamarrjet

- Një rast i metodës së paqartë të matjes për normën përkatëse të interesit.

Raportimi i segmenteve

- Shpalosjet jo të plota janë identifikuar në lidhje me rrjedhat e të hyrave dhe pasuritë dhe detyrimet e segmenteve.

Interesi

- Shpalosjet jo adekuate, në dy raste, të normës efektive të interesit dhe njohjes së të hyrave nga interesi.

Zhvlerësimi

- Shpalosje joadekuate, në dy raste, të politikës së zhvlerësimit të pasurive dhe politikës së zbritjes së kredive të zhvlerësuar.

Qiratë

- Shpalosje jo e plotë e qirasë operative, të ardhurave nga qiraja operative, informacione tjera të lidhura me qiratë.

Miratimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

- Shpalosja jo e duhur e efekteve të mundshme të SNFR 9 'Instrumentet Financiare' për klasifikimin dhe matjen.

Prezantimi

- Shpalosja jo e plotë e instrumenteve financiare, në mënyrë specifike SNK 32.42., SNK 2.36.

Palët e ndërlidhura

- Janë identifikuar tri raste të shpalosjeve jo të plota të palëve të ndërlidhura

Menaxhimi i rrezikut

- Shpalosje jo e plotë në Raportin Vjetor është identifikuar në një rast

Mbulimi

- Është identifikuar një rast i instrumenteve derivative të përdorura për të mbuluar rreziqet mirëpo pa kontabilitet të mbulimit.

Pasqyra e ndryshimeve të ekuitetit

- E përshkruar në një rast si "Pasqyra e konsoliduar e rrjedhave të parasë për periudhën."

Huamarrjet

- Një rast i shpalosjes jo të plotë në lidhje me marrëveshjet e shkelura nga huamarrësi (SNRF 7.18) – nuk janë shpalosur shumat e përfshira

Tatimet e shtyra

- Një rast kur nuk është prezantuar tatimi i shtyrë

Testet e mjaftueshmërisë së detyrimeve (TMD) (SNRF 4.15.)

- Shpalosja e kërkuar nuk është dhënë në një rast

Përqendrimi i rrezikut të sigurimit

- Shpalosja e kërkuar nuk është dhënë në një rast

STANDARDET KOMBËTARE (SKK)

Të hyrat

- Një rast i shpalosjes jo të plotë, nuk ka politikë të njohjes dhe matjes.

Zhvlerësimi

- Një rast kur nuk është shpalosur zhvlerësimi i pasurive, dhe nuk ka dëshmi nëse subjekti e ka vlerësuar se a mos është zhvlerësuar ndonjë pasuri.

Qiratë

- Nuk janë shpalosur qiratë në një rast. Subjekti e mban me qira zyrën dhe depon.

Instrumentet financiare

- Kompania ka shpalosur paratë, llogaritë e pranueshme dhe të pagueshme por NUK ka shpalosur politikën e prezantimit, njohjes apo matjes.

Aneksi 2: Statusi i rekomandimeve të RRSK K&A të vitit 2006

Rekomandimi	Statusi
Rekomandohet që të themelohet një grup shumë-disiplinor i palëve të interesuara të sektorit privat dhe publik.	Nuk është themeluar.
Të përgatitet një "tabelë e transpozimit" që tregon për çdo dispozitë përkatëse të <i>acquis communautaire</i> se si e zbatojnë atë dispozitë instrumentet juridike të Kosovës.	Tabela e transpozimit (përputhshmërisë) nuk është kryer (Para 80).
Duke u bazuar në këtë analizë, grupi duhet të kontribuojë në propozimin e amendamenteve në Ligjin për Raportimin Financiar për ta harmonizuar atë më mirë me Direktivën [e Auditimit].	Ligji i ri është përgatitur pa tabelën e përputhshmërisë; raste të numërta të mosharmonizimit me <i>acquis</i> mbeten (Para 80).
Të ristrukturohet korniza institucionale dhe të arrihet një baraspeshë e punës ndërmjet roleve të SHKÇAK dhe BKSRRF.	Pjesërisht e përfunduar (SHKÇAK është duke zhvilluar një program të rishikimit të sigurimit të cilësisë, Para 49-56).
Një kërkesë për subjekt me interes publik që të paraqesin pasqyrat e tyre financiare në përputhje me SNRF-të.	<u>E përfunduar</u> . SNRF do të kërkohen nga viti 2013 (Para 57).
Një kërkesë për ndërmarrjet që nuk janë subjekte me interes publik, përveç ndërmarrjeve mikro që të paraqesin pasqyrat e tyre financiare në përputhje me SKK.	<u>E përfunduar pjesërisht</u> . Sipas ligjit të tanishëm, kompanitë që nuk janë SIP do të kërkohet të zbatojnë SNRF-të, SNRF-të për NVM janë duke u shqyrtuar (Para 57).
Një kërkesë për personin juridik dhe/ose pasqyrat financiare të konsoliduara që të auditohen vetëm kur ekziston një interes publik për një auditim të tillë, pavarësisht nga forma juridike e subjektit.	Pjesërisht e përfunduar ; ligji i ri ka ngushtuar kërkesat për auditim të detyruar (Para 27, 30).
Një kërkesë që të gjitha auditimet ligjore të kryhen në përputhje me SNA.	<u>E përfunduar</u> (Para 58).
Një kërkesë për subjektet me interes publik (afatshkurtër) dhe korporatat tjera (afatgjatë) për të bërë pasqyrat financiare të audituara të subjektit juridik (dhe të konsoliduara), përfshirë shënimet në pasqyrat financiare, të gatshme në dispozicion të publikut brenda një periudhe të arsyeshme pas datës së bilancit të gjendjes.	Nuk është përfunduar (Para 81).

Rekomandimi	Statusi
Të arrijnë një marrëveshje me Fondacionin e Komitetit të Standardeve të Kontabilitetit (IASCF) dhe institucionet përgjegjëse për përkthimin e versioneve të standardeve në gjuhën shqipe dhe serbe .	Nuk zbatohet më (përkthimet në gjuhën shqipe dhe serbe ekzistojnë në Shqipëri dhe Serbi, para 84).
BKSFR të mbajë SKK, si një sistem të thjeshtuar të raportimit financiar për zbatim për subjektet që nuk plotësojnë përkufizimin e subjektit me interes publik. Përndryshe, Kosova mund të rishikojë projektin në vazhdim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) mbi "Standardet e Kontabilitetit për NVM-të".	Nuk është përfunduar; ligji nuk e konsideron SKK si standardet e kontabilitetit të zbatueshme në Kosovë, edhe pse ende kërkohet që KKRF t'i mbajë ato. SNRF për NVM-të momentalisht nuk zbatohen në Kosovë (Para 84).
BQK-ja [duhet] të rishqyrtojë marrëdhëniet ndërmjet raportimit të kujdesshëm dhe raportimit financiar me qëllim të përgjithshëm në sektorin financiar. BPK-ja duhet të zhvillojë filtra të kujdesit për kapitalin e kërkuar me rregullore.	<u>E përfunduar</u> (Para 62).
Të arrihet marrëveshje me FNK dhe institucionet përgjegjëse për përkthimin e versioneve të standardeve në gjuhën shqipe dhe serbe (...).	Nuk zbatohet më sepse përkthimet në gjuhën shqipe dhe serbe ekzistojnë në Shqipëri dhe Serbi (Para 82, 83).
Veprim më i drejtpërdrejtë [duhet] të merret në lidhje me monitorimin dhe zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit nga subjektet me interes publik.	Nuk është përfunduar (Para 24, 25)
BKSFR dhe BQK-ja duhet të rrisin resurset e tyre njerëzore duke punësuar më shumë punëtorë të cilët kanë njohuri për SNRF.	Pjesërisht e përfunduar nga BQK (Para 64).
BQK-ja duhet të përpiqet të forcojë marrëdhëniet e saj me auditorët për përfitim të ndërsjellë. Ndërsa objektivat e mbikëqyrësve dhe auditorëve janë të ndryshme, ka shumë fusha ku puna e mbikëqyrësve dhe e auditorit të jashtëm mund të jetë e dobishme për njëri-tjetrin.	<u>Pjesërisht e përfunduar</u> (Para 65).
(...) BQK-ja mund të analizojë mundësinë që të kërkohet nga auditori ligjor të kryejë detyra të veçanta apo të nxjerrë raporte të veçanta për të ndihmuar mbikëqyrësit në kryerjen e funksioneve të tyre mbikëqyrëse (...).	Nuk është përfunduar; nuk konsiderohet si prioritet.
Të gjithë auditorët dhe firmat e auditimit duhet të i nënshtrohen një sistemi të sigurimit të cilësisë që i	Pjesërisht e përfunduar – ligji parasheh mbikëqyrjen e auditorëve;

Rekomandimi	Statusi
nënshtrohet mbikëqyrjes publike.	megjithatë, nuk është implementuar (Para 41, 46).
Kosova duhet të krijojë një sistem efektiv të hetimeve dhe sanksioneve për të zbuluar, korrigjuar dhe për të parandaluar kryerjen joadekuate të auditimit ligjor.	Pjesërisht e përfunduar – ligji parasheh mbikëqyrjen e auditorëve; megjithatë, nuk është implementuar (Para 41, 46).
Gjithashtu, çdo masë e marrë apo sanksion i imponuar për auditorët ligjorë dhe firmat e auditimit duhet të shpaloset në mënyrën e duhur për publikun. Sa i përket sistemit të sigurimit të cilësisë, sistemi mund të bazohet në praktikat ekzistuese në Shtetet Anëtare të BE-së dhe FNK DOA 6, Hetimi dhe Disiplina (...).	Nuk është e përfunduar (Para 41, 46).
Të gjithë auditorët dhe firmat e auditimit duhet të jenë anëtarë të SHKÇAK.	Pjesërisht e përfunduar (Para 43; nuk kërkohet anëtarësimi i plotë, vetëm licenca nga KKRF).
SHKÇAK (ose BKSFR) duhet të krijojë një regjistër elektronik publik të auditorëve ligjorë dhe firmave të auditimit në mënyrë që palët e interesuara të mund të kuptojnë shpejt nëse është aprovuar auditori ligjor apo firma e auditimit, etj. Kjo do të lehtësohet nëpërmjet regjistrimit në një regjistër publik elektronik.	Pjesërisht e përfunduar ; regjistri ekziston dhe është publik por nuk azhurnohet rregullisht dhe nuk përmban informatat e kërkuara nga Direktiva e Auditimit (Para 80).
Kapaciteti i SHKÇAK duhet të rritet në mënyrë që të mundësojë që të japë kontribut më efektiv në profesionin e auditimit në Kosovë.	Pjesërisht e përfunduar; SHKÇAK ofron këshilla për anëtarët; disa udhëzime për firmat e vogla të auditimit janë hartuar.
Përvoja praktike duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e FNK. Mentorimi dhe mbikëqyrja duhet të nxiten. Është e nevojshme të rishikohen kërkesat aktuale për përvojën praktike dhe që ato të bëhen në përputhje me SNE 5.	Pjesërisht e përfunduar ; mentorimi dhe mbikëqyrja nuk janë implementuar (Para 53, 86).
Duhet të theksohet që të zhvillohet një vazhdimësi arsimore nga universiteti deri në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve të K&A (...).	Pjesërisht e përfunduar ; programi i SHKÇAK është në përputhje me SNE por nuk është bërë integrimi me arsimin universitar (Para 47, 48, 86).
Programi mësimor universitar dhe materialet edukative duhet të azhurnohen.	Pjesërisht e përfunduar , edhe pse nuk është e qartë se deri në çfarë mase janë përdorur materialet e reja (Para 47, 48).

Rekomandimi	Statusi
Universitetet do të duhet të punojnë bashkë me BKSFR, SHKÇAK, dhe komunitetin e biznesit për të zhvilluar programe studimore të përshtatshme për nevojat në zhvillim të ekonomisë.	Nuk është përfunduar (Para, 47, 48, 86).
SHKÇAK duhet gjithashtu të sigurojë që kandidatët për kualifikimin e auditimit të marrin përvojë të mjaftueshme dhe relevante praktike para marrjes së kualifikimit.	Pjesërisht e përfunduar ; përmbajtja e kërkesës për përvojë praktike nuk është vendosur (Para 53, 86).
Duke krijuar një bazë të fortë për kualifikim është thelbësore që anëtarësimi i vazhdueshëm në SHKÇAK dhe ruajtja e të drejtës për të kryer auditime (p.sh., licenca e lëshuar nga BKSFR) varet nga kryerja e një niveli minimal të ZHVP. Ky ZHVP duhet të monitorohet nga SHKÇAK (...)	<u>E përfunduar</u> (Para 55).

Aneksi 3: Tabela e Përputhshmërisë (DRAFT)

Draft Tabela e Përputhshmërisë – Direktiva e Katërt

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
Preambula	Llogaritë vjetore duhet të paraqesin pasqyrën e vërtetë dhe të drejtë të aseteve dhe përgjegjësisë, pozitës financiare dhe humbjet ose fitimet e kompanisë	Nuk ka referencë për këtë në Ligjin KRFA por neni 5 i ligjit parasheh përputhshmërinë e detyrueshme me standardet ndërkombëtare. Nenet 14 dhe 15 i referohen përputhshmërisë me Acquis të BE-së si pjesë e KKRF dhe mandateve të komisioneve të saj.	Nuk ka referencë në ligj rreth nevojës për pasqyra financiare për të treguar vlerën e vërtetë dhe të drejtë.
Preambula	Megjithatë, mund të bëhen përjashtime për kompani të caktuara që kanë rëndësi të vogël ekonomike ose sociale; përjashtimet mund të bëhen në këtë fushë për kompani të vogla dhe të mesme.	Neni 5 i Ligjit parasheh që llojet e shoqërive tregtare të rregulluara në bazë të ligjit, d.m.th shoqëritë tregtare të vogla dhe të mesme të regjistruara me përgjegjësi të kufizuara dhe kompanitë aksionare duhet të veprojnë në përputhje me SNRF, gjë që nuk kërkohet për kompanitë e regjistruara nën llojet tjera, d.m.th Ndërmarrjet Personale dhe Ortakëritë e Përgjithshme. Për Mikro-Ndërmarrje, ligji parasheh që “Kriteret për kontabilitet dhe raportim të	

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
		aplikueshme për mikro-ndërmarrje të rregullohen nga KKRF me qëllim të minimizimit të ngarkesës administrative për mikro-ndërmarrjet. Nuk kërkohet auditimi i shoqërive tregtare mikro dhe të vogla siç është paraparë me nenin 4 të këtij ligji.	
Neni 1	Masat koordinuese të përshkruara me këtë Direktivë duhet të vlejné për ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të Shteteve Anëtare për këto lloje të kompanive: kompanitë publike të kufizuara nga aksionet ose garancitë, kompanitë private të kufizuara nga aksionet ose garancitë, ortakëritë, ortakëritë me përgjegjësi të kufizuar, kompanitë me përgjegjësi të pakufizuar.	Ligji për shoqëritë tregtare Nr. 02/L-123. Në këtë ligj nuk ka referencë për kompanitë publike me përgjegjësi të kufizuar ose të pakufizuar. Llojet e shoqërive tregtare, sipas nenit 4 të ligjit, janë ndërmarrja individuale, shoqëria kolektive, shoqëria komandite, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare.	Ligji nuk përmend në mënyrë specifike llojet e kompanive sipas LKRFA. Neni 5 i ligji i referohet vetëm shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqërive aksionare.
Neni 1	Në pritje të koordinimit pasues, Shtetet Anëtare nuk duhet të aplikojné dispozitat e kësaj Direktiva mbi bankat dhe institucionet tjera financiare ose mbi	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	kompanitë e sigurimit.		
Neni 2	1. Llogaritë vjetore duhet të përfshijnë bilancin e gjendjes, llogarinë e profitit dhe humbjeve dhe shënimet rreth llogarive. Dokumentet duhet të përbëjnë një tërësi të plotë. Shtetet Anëtare mund të lejojnë ose të kërkojnë përfshirjen e deklaratave tjera në llogaritë vjetore si shtesë ndaj dokumenteve të referuara në nën-paragrafin e parë. 2. Ato duhet të hartohen në mënyrë të qartë dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Direktive. 3. Llogaritë vjetore duhet të paraqesin pasqyrën e qartë të vlerës së vërtetë dhe të drejtë të aseteve, përgjegjësisë, pozitës financiare dhe profitit e humbjeve të kompanisë. 4. Në rastet kur aplikimi i dispozitës së kësaj Direktive nuk është i mjaftueshëm	Ligji i Kosovës për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim të Llogarive parasheh që llogaritë financiare vjetore duhet të përfshijnë: a) bilancin e gjendjes, b) pasqyrën e të ardhurave, c) pasqyrën e ndryshimit të kapitalit (ekuiteti), d) pasqyrën e rrjedhës së pasasë, dhe e) dokumentet përcjellëse të pasqyrave financiare. Po ashtu, ligji parasheh që struktura dhe përmbajtja të rregullohet me një akt nën-ligjor.	Ligji aktual i referohet “Deklaratës së të Hyrave” si pjesë e deklaratave financiare vjetore përballë “llogarisë së profitit dhe humbjeve” siç kërkohej nga direktiva e katërt. Ligji nuk specifikon qartë që pasqyrat financiare duhet të paraqesin vlerën e vërtetë dhe të drejtë të aseteve,

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	për të marrë pasqyrë të vërtetë e të drejtë brenda kuptimit të paragrafit 3, atëherë duhet të jepen informata shtesë. 5. Në rastet e jashtëzakonshme kur aplikimi i dispozitës së kësaj Direktive nuk është në përputhje me obligimin e paraparë në paragrafin 3, atëherë ajo dispozitë duhet të lihet anash për të dhënë pasqyrë të drejtë e të vërtetë brenda kuptimit të paragrafit 3. Çdo anashkalim i tillë duhet të përshkruhet në shënimet e llogarisë bashkë me shpjegimin e arsyeve për atë dhe deklaratën e ndikimit të saj në asete, përgjegjësi, gjendje financiare dhe profit ose humbje. Shtetet Anëtare mund të përcaktojnë rastet e jashtëzakonshme në fjalë dhe të miratojnë rregulla speciale përkatëse. 6. Shtetet Anëtare mund të autorizojnë ose të kërkojnë deklarimin e informatave tjera, brenda llogarisë vjetore, përveç atyre që duhet të deklarohen.		përgjegjësi, pozitës financiare dhe profitit e humbjeve të kompanisë siç kërkohej nga direktiva e katërt.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
Neni 3	Formati i bilancit të gjendjes dhe i llogarisë së profitit ose humbjeve, në veçanti rreth formularit të miratuar për prezantim të tyre, nuk mund të ndryshohet nga një vit financiar në tjetrin. Mos aplikimi i këtij parimi duhet të lejohet në raste të jashtëzakonshme. Çdo përjashtim i tillë duhet të përshkruhet në shënimet e llogarive bashkë me shpjegimin për arsyet.	Neni 9 i Ligjit parasheh që struktura dhe përmbajtja të rregullohen me një akt nënligjor, por nuk i referohet në mënyrë eksplicite, formatit të pasqyrave financiare.	Ligji i Kosovës për Kontabilitet dhe Raportim Financiar nuk i referohet formatit të pasqyrave financiare.
Neni 4	1. Në bilancin e gjendjes dhe në llogarinë e profitit dhe humbjeve, artikujt e përshkruar në nenet 9, 10 dhe 23 deri në 26 duhet të prezantohen ndaras në bazë të radhitjes së dhënë. Nën-ndarja më e detajizuar e artikujve duhet të autorizohet me kusht që të respektohet formati. Artikuj të ri mund të shtohen me kusht që përmbajtjet e tyre nuk mbulohen nga ndonjëri prej artikujve të përshkruar në format. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë nën-ndarje të tillë ose artikuj të ri.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	2. Format, nomenklatura dhe terminologjia e artikujve në bilancin e gjendjes dhe llogarinë e humbjeve që paraprihen me numra arab duhet të përshtaten në rastet kur natyra e veçantë e ndërmarrjes kërkon një gjë të tillë. Përshtatjet/adaptimet e tilla mund të kërkojnë nga Shtetet Anëtare për ndërmarrje që përbëjnë pjesë të veçanta të sektorit të ekonomisë. 3. Artikujt në bilancin e gjendjes dhe llogari të profitit dhe humbjeve që paraprihen me numra arab mund të kombinohen në rastet kur: (a) janë jo-materiale sa i përket shumës për qëllimet e nenit 2 (3); ose (b) kombinimi i tillë ofron qartësi më të madhe me kusht që artikujt e kombinuar në atë mënyrë trajtohen në mënyrë të ndarë në shënimet e llogarive. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë një kombinim të tillë.		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	4. Sa i përket secilit bilanc të gjendjes dhe artikujve në llogarinë e profitit dhe humbjeve, duhet të jepet shifra që ndërlidhet me artikullin përkatës nga viti financiar paraparak. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë përshtatjen e shifrës nga viti financiar, në rastet kur këto shifra nuk janë në përputhje. Në çdo rast, mospërputhshmëria dhe çdo përshtatje e shifrave duhet të përshkruhet në shënimet e llogarive bashkë me komentet relevante. 5. Përveç rasteve kur ekziston një artikull korrespondues me vitin financiar paraparak, brenda kuptimit të paragrafit 4, bilanci i gjendjes ose artikulli i llogarisë së profitit dhe humbjeve, për të cilat nuk ka shumë nuk duhet të përfshihet. 6. Shtetet Anëtare mund të lejojnë ose të kërkojnë prezantimin e shumave brenda artikujve në llogarinë e profitit dhe humbjeve dhe në bilancin e gjendjes që të marrin parasysh substancën e transaksionit ose aranzhimit të raportuar.		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	Një leje ose kërkesë e tillë mund të kufizohet për klasa të caktuara të kompanisë dhe/ose për llogaritë e konsoliduara siç është paraparë në Direktivën e Shtatë të Këshillit Nr. 83/349/EEC të 13 qershorit 1983 mbi llogaritë e konsoliduara (1)		
Neni 5	1. Si përjashtim nga neni 4 (1) dhe (2), Shtetet Anëtare mund të kërkojnë formate të veçanta për llogaritë vjetore të kompanive investuese dhe të kompanive financiare <i>holding</i> me kusht që këto formate japin një pasqyrë të këtyre kompanive në mënyrë ekuivalente me ato të parapara në nenin 2 (3). 2. Për qëllime të kësaj Direktive, ‘kompanitë investuese’ nënkupton vetëm: (a) ato kompani, qëllimi i vetëm i të cilave është investimi i fondeve të tyre në letra me vlerë të ndryshme, pronë të paluajtshme dhe asete tjera me qëllim të përhapjes së rreziqeve të investimit dhe	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	ofrimit aksionarëve të vet përfitimin nga rezultatet e menaxhimit të aseteve të tyre; (b) ato kompani të ndërlidhura me kompanitë investuese me kapital të paluajtshëm nëse qëllimi i vetëm i kompanive të tilla është marrja e aksioneve të plota të paguara të lëshuara nga kompanitë investuese pa paragjykuar dispozitat e nenit 20 (1) (h) të Direktivës Nr. 77/91/EEC (2). 3. Për qëllimet e kësaj Direktive, ‘kompanitë financiare holding’ nënkuptojnë vetëm ato kompani qëllimi i vetëm i të cilave është marrja holding në ndërmarrjet tjera dhe menaxhimi i holding-eve të tilla dhe kthimi i tyre në profit, pa u përfshirë në mënyrë direkte ose indirekte në menaxhimin e atyre ndërmarrjeve dhe pa paragjykim ndaj të drejtave të tyre si aksionar. Kufizimet e imponuara në aktivitetet e këtyre kompanive duhet të jenë të tilla, ashtu që përputhshmëria me ato mund të		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	mbikëqyret nga një autoritet administrativ ose gjyqësor.		
Neni 6	Shtetet Anëtare mund të autorizojnë ose të kërkojnë përshtatjen e formatit të fletës së bilancit dhe të llogarisë së profitit dhe humbjeve me qëllim të përfshirjes së përvetësimit të profiti ose trajtimit të humbjeve.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	
Neni 7	Çdo dallim ndërmjet artikujve të asetëve dhe përgjegjësisë ose ndërmjet artikujve të të hyrave dhe shpenzimeve janë të ndaluara.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk e bën të qartë referencën që dallimet janë të ndaluara.
Nenet 8-10	Në këto nene janë të dhëna formatet e sugjeruara për fletën e bilancit.	Sipas nenit 5 të Ligjit, deklaratat financiare duhet të përgatiten në përputhje me SNRF.	Nuk ka referencë rreth formateve të sugjeruara në Ligj.
Neni 11	Shtetet Anëtare mund të lejojnë kompanitë të cilat në datat e bilancit të gjendje nuk tejkalojnë kufijtë e dy prej këtyre kritereve: - totali i bilancit të	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje në mënyrë specifike.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	gjendjes prej 4 400 000 Euro, - qarkullim neto prej 8 800 000 Euro, — numër mesatar të punonjësve gjatë vitit financiar: 50 për të hartuar fleta të bilancit të ndërlidhura që prezantojnë vetëm ata artikuj të paraprirë me shkronja dhe numra romak në nenet 9 dhe 10, zbulimi, në mënyrë të ndarë, i informatave të kërkuara në kllapa nën D (II) të ‘Aseteve’ dhe C nën ‘Përgjegjësitë’ në nenin 9 dhe nën D (II) në nenin 10, për në total për secilën prej tyre.		
Neni 12	1. Në rastet kur data e bilancit të gjendjes së një kompanie tejkalon ose ndalon së tejkaluari kufijtë e dy prej tri kritereve të dhëna në nenin 11, ai fakt do të ndikojë në aplikimin e përjashtimit të paraparë në atë nen vetëm nëse ndodh në dy vite financiare të njëpasnjëshme. 2. Për qëllime të këmbimit në valuta kombëtare, shumat në njësitë evropiane të	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk parasheh që madhësia e kompanisë duhet të bazohet në indikatorët relevantë në dy periudha të njëpasnjëshme.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	llogarive të specifikuara në nenin 11 mund të rriten për jo më shumë se 10%. 3. Totali i bilancit të gjendjes të referuar në nenin 11 duhet të përbëhet nga asetet në A deri në E nën ‘Asetet’ në formatin e përshkruar në nenin 9 ose atyre nga A deri në E në formatin e dhënë në nenin 10.		
Neni 13	1. Në rastet kur një aset ose përgjegjësi ndërlidhet me më shumë se një artikull të formatit, marrëdhënia e tij me artikujt tjerë duhet të deklarohet ose nën artikullin e paraqitur ose në shkresat e llogarive, nëse përshkrimi i tillë është esencial për kuptimin e llogarive vjetore. 2. Aksionet vetanake ose aksionet në ndërmarrjet degë mund të jepen vetëm nën artikujt e përshkruar për atë qëllim.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet në mënyrë eksplicite kësaj çështjeje. Megjithatë, SNRF e miratuar me anë të ligjit i zgjedh çështjet e deklarimit.
Neni 14	Të gjitha zotimet e bëra përmes çfarëdo garancie, nëse nuk ka ndonjë obligim për t’i deklaruar ato si përgjegjësi, duhet të	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet në mënyrë eksplicite kësaj çështjeje. Megjithatë, SNRF e

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	paraqiten në mënyrë të qartë në fund të bilancit të gjendjes ose në shënimet e llogarive dhe të bëhet dallimi ndërmjet llojeve të ndryshme të garancive të njohura/pranuara nga ligji kombëtar; deklaratimet specifike duhet të bëhen për çdo letër me vlerë të dorëzuar. Zotimet e këtij lloji që ekzistojnë në lidhje me ndërmarrjet vartëse/të shoqëruara duhet të prezantohen në mënyrë të ndarë.		miratuar me anë të ligjit i zgjedh çështjet e deklaratimit.
Neni 15	1. Deklarimi i aseteve të veçanta si asete fikse ose aktuale do të varet nga qëllimi i tyre. 2. Asetet fikse duhet të përfshijnë ato asete të cilat janë të synuara për përdorim të vazhdueshëm për qëllime të aktiviteteve të ndërmarrjes. 3. (a) Lëvizjet në artikuj të ndryshëm të aseteve fikse duhet të paraqiten në bilancin e gjendjes ose në shënimet e llogarive. Në këtë drejtim, ato duhet të	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	prezantohen ndaras duke filluar me çmimin e blerjes ose koston e prodhimit për secilin artikull të asetit fiks në njërën anë dhe shtesat, shitjet dhe transferet gjatë vitit financiar në anën tjetër, përshtatjet në vlerën kumulative në datën e bilancit të gjendjes dhe korrigjimet e bëra gjatë vitit financiar në përshtatjet e vlerës së viteve të kaluara financiare. Përshtatjet/rregullimet e vlerës duhet të të prezantohen ose në fletën e bilancit si deduktime të qarta nga artikujt relevant ose në shënimet e llogarive.		
Neni 16	Të drejtat në patundshmëri dhe të drejtat tjera të ngjashme siç janë definuar me ligje kombëtare duhet të prezantohen nën 'Toka dhe ndërtesa'.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje.
Neni 17	Për qëllime të kësaj Direktive, interesi pjesëmarrës nënkupton të drejtat në kapitalin e ndërmarrjeve tjera, pavarësisht nëse janë apo nuk janë të përfaqësuara me	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje. Dispozitat e përfshira në këtë

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	certifikata, të cilat, përmes krijimit të një lidhjeje të qëndrueshme me ato ndërmarrje, kanë për qëllimin kontributin në aktivitete të kompanisë. Posedimi i një pjese të kapitalit të një kompanie tjetër supozohet se përbën interes pjesëmarrës nëse tejkalon një përqindje fikse nga Shtetet Anëtare, të cilat nuk tejkalojnë 20%.		nen adresohen në SNRF.
Neni 18	Shpenzimet e shkaktuara gjatë vitit financiar por të ndërlidhura me një vit financiar pasues, bashkë me çfarëdo të hyra të cilat, edhe pse të ndërlidhura me vitin financiar në fjalë, nuk duhet paguar deri pas skadimit duhet të paraqiten nën ‘Parapagesat dhe të hyra rrjedhëse’. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të vendosin që të hyrat e tilla të përfshihen nën ‘Debitorët’. Në rastet kur të hyrat e tilla janë materiale, duhet të deklarohen në shkresat e llogarive.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
Neni 19	Përshtatjet e vlerës duhet të përfshijnë të gjitha përshtatjet që kanë për synim marrjen parasysh të zbritjeve në vlerat e aseteve individuale të përcaktuara në datën e bilancit të gjendjes nëse ato zbritje janë finale apo jo.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje. Dispozitat e përfshira në këtë nen adresohen në SNRF.
Neni 20	1. Dispozitat synojnë të mbulojnë përgjegjësitë natyra e të cilave është e definuar qartë dhe të cilat në datën e bilancit të gjendjes ose ka gjasa të ndodhin ose sigurisht se do të ndodhin por të pasigurta rreth shumës ose kohës në të cilën do të ndodhin. 2. Po ashtu, Shtetet Anëtare mund të autorizojnë hartimin e dispozitave për të mbuluar detyrimet të cilat kanë origjinën në vitin financiar nën shqyrtim ose në një vit financiar paraprak, natyra e të cilave është e definuar qartë dhe të cilat në datën e bilancit të gjendjes ose ka gjasa të ndodhin ose sigurisht se do të ndodhin por të pasigurta rreth shumës ose kohës në të	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje. Dispozitat e përfshira në këtë nen adresohen në SNFR.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	cilën do të ndodhin. 3. Dispozitat nuk mund të përdoren për të përshtatur vlerën e aseteve.		
Neni 21	Të hyrat e pranuar para datës së bilancit të gjendjes por të ndërlidhura me vitin financiar pasues, bashkë me çfarëdo ndryshimi që, edhe pse të ndërlidhura me vitin financiar në fjalë, duhet të paguhet vetëm gjatë vitit financiar pasues, duhet të paraqiten nën ‘Të hyra rrjedhëse ose të shtyra’. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të vendosin që të hyrat e tilla të përfshihen nën ‘Kreditorët’. Në rastet kur të hyrat e tilla janë materiale, duhet të deklarohen në shkresat e llogarive.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje. Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje.
Nenet 23-26	Këta artikuj japin formatet e sugjeruara për pasqyrën e të hyrave.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet formateve të pasqyrave të të hyrave. Megjithatë, neni 9 i ligjit parasheh që struktura dhe

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
			përmbajtja e pasqyrave financiare duhet të rregullohet me akte nënligjore të lëshuara nga Ministria e Financave.
Neni 27	Shtetet Anëtare mund t'i lejojnë kompanitë, të cilat në datat e bilancit të gjendjes së tyre, nuk tejkalojnë kufijtë e dy nga tri kriteret e mëposhtme: — totali i bilancit të gjendjes është 17 500 000 Euro, — qarkullim vjetor neto: 35 000 000 Euro, — numër mesatar të punonjësve gjatë vitit financiar: 250 për të adaptuar formatet e ndryshme prej atyre të përshkruara në nenet 23 deri 26 brenda kufijve në vijim: (a) neni 23: nga 1 deri në 5 mund të	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	kombinohen nën një artikull të quajtur ‘fitimi ose humbja bruto’; (b) neni 24: A (1), A (2) dhe B (1) deri B (4) mund të kombinohen nën një artikull të quajtur ‘fitimi ose humbja bruto’; (c) neni 25: (1), (2), (3) dhe (6) mund të kombinohen nën një artikull të quajtur ‘fitimi ose humbja bruto’; (d) neni 26, A (1), B (1) dhe B (2) mund të kombinohen nën një artikull të quajtur ‘fitimi ose humbja bruto’. Neni 12 duhet të aplikohet.		
Neni 28	Qarkullimi neto duhet të përfshijë shumat e nxjerra nga shitja e produkteve dhe ofrimi i shërbimeve që i takojnë aktiviteteve të zakonshme të kompanisë, pas zbritjes së tatimit në import dhe tatimit në vlerë të shtuar si dhe tatimeve tjera të lidhura drejtpërsëdrejti me qarkullim.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
Neni 29	1. Të hyrat dhe detyrimet që dalin jashtë aktiviteteve të zakonshme të kompanisë duhet të prezantohen nën ‘Të hyrat dhe detyrime të jashtëzakonshme’. 2. Përveç nëse të hyrat dhe detyrimet e referuara në paragrafin 1 janë jo-materiale për vlerësimin e rezultateve, duhet të jepen shpjegime rreth shumës dhe natyrës së tyre në shënimet e llogarive. E njëjta vlen edhe për të hyrat dhe detyrimet e ndërlidhura me një vit tjetër financiar.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje.
Neni 30	Shtetet Anëtare mund të lejojnë tatimet në të hyra ose humbje për aktivitete të jashtëzakonshme dhe tatime për të hyra ose humbje të jashtëzakonshme, që të prezantohen në total si një artikull në llogarinë e profitit dhe humbjeve para ‘Tatimet tjera që nuk janë prezantuar në artikujt e mësipërm’. Në këtë rast, ‘profiti ose humbjet në aktivitete të jashtëzakonshme pas tatimit’ duhet të hiqen nga formatet e përshkruara në nenet	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje në ligj.	Ligji nuk i referohet kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	23 deri 26. Në rastet kur aplikohet ky përjashtim, kompanitë duhet të deklarojnë, në shënimet e llogarive, shtrirjen në të cilën tatimet në profit ose humbje ndikojnë në profitin ose humbjet nga aktivitetet e zakonshme dhe 'Profit ose humbje të jashtëzakonshme'.		
Neni 31	Rregullat e vlerësimit 1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që artikujt e paraqitur në llogaritë vjetore të vlerësohen në përputhje me parimet e përgjithshme në vijim: (a) kompania duhet të supozohet se kryen biznesin e vet si afatgjatë; (b) metodat e vlerësimit duhet të aplikohen në mënyrë konsistente nga një vit financiar në tjetrin; (c) vlerësimi duhet të bëhet mbi një bazë	Përveç asaj që është paraparë në nenin 7 të ligjit "Shoqëritë tregtare, subjekte të këtij ligji, duhet të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e asetëve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit." Ligji nuk i referohet rregullave të vlerësimit.	Nuk ka referencë në ligj rreth rregullave të vlerësimit.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	prudente dhe në veçanti: (aa) mund të përfshihen vetëm profitet e bëra në datën e bilancit të gjendjes, (bb) duhet të merren parasysh të gjitha përgjegjësitë që dalin gjatë vitit financiar në fjalë ose atij paraprak edhe nëse ato përgjegjësi shfaqen vetëm ndërmjet datës së bilancit të gjendjes dhe datës në të cilën është hartuar, (cc) duhet të merren parasysh të gjitha zhvlerësimet, pavarësisht nëse rezultati i vitit financiar është humbje ose profit; (d) duhet të merren parasysh të hyrat dhe detyrimet e ndërlidhura me vitin financiar, pavarësisht nga data e pranimi ose pagesës së të hyrave ose detyrimeve të tilla; (e) komponentët e artikujve të aseteve dhe përgjegjësi duhet të vlerësohen ndaras;		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	(f) bilancit fillestar i gjendjes për secilin vit financiar duhet të korrespondojë me bilancin përmbyllës të gjendjes për vitin financiar paraparak. 1a. Përveç shumave të regjistruara në bazë të paragrafit (1) (c)(bb), Shtetet Anëtare mund të lejojnë ose kërkojnë marrjen parasysh e të gjitha përgjegjësiave dhe humbjeve potenciale të parashikuara që krijohen gjatë vitit financiar në fjalë ose të vitit paraparak edhe nëse përgjegjësitë ose humbjet e tilla shfaqen ndërmjet datës së bilancit të gjendjes dhe datës së publikimit; 2. Përjashtimet nga këto parime të përgjithshme duhet të lejohen në raste të jashtëzakonshme. Çdo përjashtim i tillë duhet të deklarohet në shënimet e llogarive dhe arsyet për këtë veprim të prezantohen bashkë me një vlerësim të ndikimit të tyre në asetet, përgjegjësitë, gjendjen financiare dhe profitin ose		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	humbjen.		
Nenet 33- 39	Nenet e vlerësimit	NA	Nuk ka referencë në ligj rreth asaj se si duhet të bëhet vlerësimi i asetëve të tyre aktuale dhe jo aktuale nga ana e shteteve.
Neni 40	1. Shtetet Anëtare mund të lejojnë kalkulimin e çmimit të blerjes ose koston e prodhimit të asortimenteve të mallrave të së njëjtës kategori dhe të gjithë artikujve të zëvendësueshëm përfshirë investimet qoftë në bazë të çmimeve mesatare të peshuara ose përmes metodës ‘i pari brenda, i pari jashtë’ (<i>‘first in, first out’</i> (FIFO)), metodës ‘i fundit brenda, i pari jashtë’ (<i>‘last in, first out’</i> (LIFO)) ose ndonjë metode të ngjashme. 2. Në rastet kur vlera e dhënë në bilancin e gjendjes, pas aplikimit të metodave të kalkulimit të specifikuara në paragrafin 1, dallon materialisht, në datën e fletës së	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	bilancit, nga vlera e njohur në bazë të vlerës më të fundit të njohur në treg, atëherë dallimi në shumë duhet të deklarohet në total sipas kategorisë brenda shënimeve të llogarive.		
Neni 41	1. Në rastet kur shuma mund të paguhet për ndonjë borxh që është më i madh sesa shuma e pranuar, dallimi mund të prezantohet si një aset. Duhet të prezantohet ndaras në bilancin e gjendjes ose në shënimet e llogarive. 2. Shuma e këtij dallimi duhet të shlyhet (<i>write off</i>) çdo vit me një shumë të arsyeshme dhe të shlyhet në tërësi jo më vonë se afati për shlyerjen e borxhit.	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje.
Neni 42	Dispozitat nuk duhet të tejkalojnë shumat të cilat janë të domosdoshme. Dispozitat e parapara në bilancin e gjendjes nën ‘Dispozitat e tjera’ duhet të deklarohen në shënimet e llogarive nëse ato janë	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	materiale.		
Neni 43	Përmbajtja e shënimeve të llogarive 1. Përveç informatave të kërkuara në dispozitat tjera të kësaj Direktive, llogaritë duhet të japin informata në lidhje me së paku çështjet në vijim: (1) metodat e vlerësimit të aplikuara për artikuj të ndryshëm në llogaritë vjetore dhe metodat e aplikuara për kalkulimin e përshtatjeve të vlerës. Për artikujt e përfshirë në llogaritë vjetore, të cilat janë qenë ose janë burimisht të shprehura në valuta të huaja, duhet të deklarohet baza e këmbimit e përdorur për t'i përshkruar ato në valutën lokale; (2) emri dhe zyra e regjistruar e secilës ndërmarrje në të cilën kompani qoftë vet ose përmes një personi që vepron në emër të saj por në emër të kompanisë, ka së paku një përqindje të kapitalit të cilën Shtetet Anëtare nuk mund ta vendos në	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	më shumë se 20% që tregon proporcionin e kapitalit të mbajtur, shuma e kapitalit dhe rezervave dhe profiti ose humbjet për vitin financiar të fundit të ndërmarrjes në fjalë për të cilat janë miratuar llogaritë. Kjo informatë mund të hiqet në rastet kur për qëllime të nenit 2(3) është e parëndësishme. (3) numri dhe vlera nominale, ose në mungesë të vlerës nominale, vlera mesatare e llogaritjes së aksioneve të parapaguara gjatë vitit financiar brenda kufijve të kapitalit të autorizuar pa paragjykuar shumën e këtij kapitali në relacion me nenin 2 (1) (e) të Direktivës 68/151/EEC ose nenit 2 (c) të Direktivës 77/91/EEC; (4) në rastet kur ka më shumë se një klasë të aksioneve, numri dhe vlera nominale ose, në mungesë të vlerës nominale, vlera mesatare e llogaritur për secilën klasë;		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	(5) posedimi i çfarëdo certifikate të pjesëmarrjes, detyrimeve të konvertueshme ose të drejtave ose letrave të ngjashme me vlerë me indikacion të numrit të tyre dhe të drejtave që ato ngërthejnë; (6) shuma të cilat duhet paguar nga kompania dhe që duhet paguar jo më gjatë se pesë vite si dhe borxhet totale të kompanisë të mbuluara nga letrat me vlerë të kompanisë duke treguar natyrën dhe formën e letrës me vlerë. Kjo informatë duhet të deklarohet ndaras për çdo artikull të kreditorëve siç parashihet në formatet e dhëna në nenet 9, 10 dhe 10a		
Neni 43	(7) shuma totale e të gjitha zotimeve financiare të cilat nuk janë përfshirë në bilancin e gjendjes aq sa këto informata janë të dobishme për të vlerësuar gjendjen financiare. Çdo zotim në lidhje me pensionet dhe ndërmarrjet vartëse duhet të	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	deklarohet ndaras; (7a) natyra dhe qëllimi i punës së aranzhimeve të kompanisë të cilat nuk janë përfshirë në fletën e bilancit dhe ndikimi financiar i këtyre aranzhimeve mbi kompaninë me kusht që rreziqet dhe përfitimet që dalin nga aranzhimet e tilla janë materiale dhe aq sa deklarimi i rreziqeve ose përfitimeve të tilla janë të domosdoshme për vlerësimin e gjendjes financiare të kompanisë. Shtetet Anëtare mund të lejojnë kompanitë e referuara në nenin 27 që të kufizojnë informatat e kërkuara që duhet deklaruar nga kjo pikë për natyrën dhe qëllimin e punës së aranzhimeve të tilla; (7b) transaksionet e bëra me palët përkatëse nga kompania, përfshirë shumën e transaksioneve të tyre, natyrën e marrëdhënies me palët përkatëse dhe informatat tjera rreth transaksioneve që janë të domosdoshme për të kuptuar		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	gjendjen financiare të kompanisë nëse transaksionet e tilla janë materiale dhe nuk janë kryer nën kushte normale të tregut. Informatat rreth transaksioneve individuale mund të grumbullohen sipas natyrës së tyre përveç në rastet kur janë të domosdoshme informata të veçanta për të kuptuar efektet e transaksioneve me palët përkatëse për gjendjen financiare të kompanisë. Shtetet Anëtare mund të lejojnë kompanitë e referuara në nenin 27 të heqin deklaratimet e përshkruara në këtë pikë përveç nëse kompanitë i takojnë tipit të referuar në nenin 1(1) të Direktivës 77/91/EEC, në të cilin rast Shtetet Anëtare mund të kufizojnë deklaratimin, së paku, në transaksionet e bëra në mënyrë direkte dhe indirekte ndërmjet: (i) kompanisë dhe aksionarëve të saj të mëdhenj, dhe		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	(ii) kompanisë dhe anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse. Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë transaksionet e bëra ndërmjet dy ose më shumë anëtarëve të një grupi me kusht që njësitë vartëse të cilat janë pjesë e transaksionit të jenë në pronësi të plotë të një anëtari të tillë. ‘Palë përkatëse’ ka të njëjtin kuptim sikur në standardet ndërkombëtare të llogaritjes të miratuar në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 1606/2002		
Neni 44	1. Shtetet Anëtare mund të lejojnë kompanitë e referuara në nenin 11 që të hartojnë shënime të përmbledhura të llogarive të tyre pa informatat e kërkuara nën nenin 43(1)(5) deri në (12), (14)(a) dhe, (15). Megjithatë, shënimet duhet të deklarojnë informatat e specifikuar në nenin 43(1)(6) në total për të gjithë	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	artikujt në fjalë. 2. Shtetet Anëtare mund të lejojnë kompanitë e referuara në paragrafin 1 që të lirohen nga obligimi për të deklaruar, në shënimet e llogarive, informatat e përshkruara në nenin 15 (3) (a) dhe (4), nenet 18, 21 dhe 29 (2), nën-paragrafin e dytë të nenit 30, nenin 34 (2), nenin 40 (2) dhe nën-paragrafin e dytë të nenit 42. 3. Neni 12 duhet të aplikohet.		
Neni 45	1. Shtetet Anëtare mund të lejojnë deklaratimet e përshkuara në nenin 43 (1) (2): (a) për të marrë formularin e deklaratës të depozituar në përputhje me nenin 3 (1) dhe (2) të Direktivës 68/151/EEC; kjo duhet të deklarohet në shënimet e llogarive; (b) të hiqen në rastet kur natyra e tyre është e tillë që do të krijonte	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	paragjykime serioze për cilindo prej ndërmarrjeve të ndërlidhura me nenin 43 (1) (2). Shtetet Anëtare mund të bëjnë përjashtime të tilla duke iu nënshtruar autorizimit paraprak administrativ ose gjyqësor. Çdo përjashtim i tillë duhet të deklarohet në shënimet e llogarive. 2. Paragrafi 1(b) duhet të vlejë edhe për informatat e specifikuara në nenin 43(1)(8). Shtetet Anëtare mund të lejojnë kompanitë e referuara në nenin 27 që të përjashtojnë deklarin e informatave të specifikuara në nenin 43(1)(8). Shtetet Anëtare po ashtu mund të lejojnë kompanitë e referuara në nenin 27 që të përjashtojnë deklarinet e informatave të specifikuara në nenin 43(1)(15), me kusht që informatat e tilla dorëzohen në sistemin e mbikëqyrjes publike të referuar në nenin 32 të		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	Direktivës 2006/43/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 17 majit 2006 për auditimin statutor të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara (1) kur ato kërkohen nga një sistem i mbikëqyrjes publike.		
Neni 46	Përmbajtja e raportit vjetor 1. (a) Raporti vjetor duhet të përfshijë së paku një pasqyrë të drejtë të zhvillimit dhe performansës së biznesit të kompanisë dhe gjendjen e saj bashkë me një përshkrim të rreziqeve kryesore dhe paqartësive me të cilat ballafaqohet. Kjo pasqyrë duhet të jetë një analizë gjithëpërfshirëse dhe e balancuar e zhvillimit dhe performansës së biznesit të kompanisë dhe gjendjen e saj në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e biznesit; (b) Analiza duhet të përfshijë, deri në atë masë që është e domosdoshme për të	Neni 9 i Ligjit parasheh që “Struktura dhe përmbajtja e raporteve financiare vjetore rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave, në bazë të propozimit të KKRF-së.”	Nuk ka referencë rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	kuptuar zhvillimin, performansën ose pozitën e kompanisë, indikatorët financiar dhe aty ku është adekuate indikatorët kyç të performansës jofinanciar që janë relevant për biznesin e veçantë, përfshirë informatat rreth çështjeve mjedisore dhe të punonjësve; (c) Gjatë ofrimit të analizës së vet, raporti vjetor duhet të përfshirë, aty ku është adekuate, referencat dhe shpjegimet shitesë për shumat e raportuara në llogaritë vjetore. 2. Po ashtu, raporti duhet të tregojë: (a) çdo ngjarje të rëndësishme që nga fundi i vitit financiar; (b) zhvillimet e ardhshme të mundshme të kompanisë; (c) aktivitetet në fushën e hulumtimeve		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	dhe zhvillimit; (d) informatat rreth përvetësimeve të aksioneve vetanake të përshkruara nga neni 22 (2) i Direktivës 77/91/EEC. (e) ekzistencën e degëve të kompanisë; (f) në lidhje me përdorimin e instrumenteve financiare nga kompania dhe rastet kur materiali për vlerësim të aseteve, përgjegjësi, gjendjes financiare dhe profitin ose humbjet e saj — objektivat dhe politikat e menaxhimit të rrezikut të kompanisë, përfshirë politikën për mbrojtjen (<i>hedging</i>) e çdo lloji kryesor të transaksionit të parashikuar për të cilin përdoret llogaritja e masave mbrojtëse (<i>hedge</i>), dhe — ekspozimin e kompanisë ndaj rreziqeve të kreditit, likuiditetit dhe të rrjedhës së parasë.		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	3. Shtetet Anëtare mund të heqin obligimin mbi kompanitë të mbuluar nga neni 11 për të përgatitur raportet vjetore me kusht që informatat e referuara në nenin 22 (2) të Direktivës 77/91/EEC rreth përvetësimit të aksioneve vetanake nga një kompani përshkruhet në shënimet e llogarive të tyre. 4. Shtetet Anëtare mund të vendosin të lirojnë kompanitë e mbuluara nga neni 27 nga obligimi i paragrafit 1(b) më sipër aq ka të bëjë me informatat jofinanciare.		
Neni 46a	1. Kompania, letrat me vlerë të së cilës janë të pranuar për tregti në treg të rregulluar brenda kuptimit të nenit 4(1), pika (14) e Direktivës 2004/39/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 21 prill 2003 mbi tregjet në instrumente financiare (1) duhet të përfshijnë një deklaratë të qeverisjes së përbashkët në raportin e vet vjetor. Ajo deklaratë duhet të përfshihet si një seksion	Neni 9 i Ligjit parasheh që “Struktura dhe përmbajta e raporteve financiare vjetore rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e financave, në bazë të propozimit të KKRF-së.”	Ligji nuk përmban referenca për qeverisjen e përbashkët.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	specifik i raportit vjetor dhe duhet të përmbajë së paku këto informata: (a) referencë për: (i) kodin e qeverisjes së përbashkët të cilës i nënshtrohet kompani, dhe/ose (ii) kodin e qeverisjes së përbashkët të cilin kompania ka vendosur ta aplikojë në mënyrë vullnetare, dhe/ose (iii) të gjitha informatat relevante rreth praktikave të qeverisjes së përbashkët të aplikuara përtej kërkesave të ligjit kombëtar. Në rastet kur pikat (i) dhe (ii) vlejnë, kompania duhet të tregojë se ku janë në dispozicion për publikun tekstet relevante, ndërsa aty ku vlen pika (iii), kompania duhet t'i bëjë praktikat e qeverisjes së përbashkët publike; (b) shtrirja në të cilën një kompani, në përputhje me ligjin kombëtar, nuk aplikon		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	kodin e qeverisjes së përbashkët të referuar nën pikat (a) (i) ose (ii), duhet të jepet një shpjegim nga kompania për pjesët e kodit të qeverisjes së përbashkët të cilat nuk aplikohen dhe arsyet pse. Në rastet kur kompania ka vendosur të mos aplikojë cilëndo dispozitë të kodit për qeverisje të përbashkët të referuar në pikat (a) (i) ose (ii), duhet të shpjegohen arsyet për këtë. (c) një përshkrim të tipareve kryesore të sistemeve të brendshme të kompanisë për kontroll dhe menaxhim të rrezikut në lidhje me procesin e raportimit financiar. (d) informatat e kërkuara nga neni 10(1), pikat (c), (d), (f), (h) dhe (i) të Direktivës 2004/25/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 21 prill 2004 për ofertat e marrjes për sipër (1), në rastet kur kompania i nënshtrohet		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	asaj Direktive; (e) përveç nëse informatat tanimë janë paraparë në ligje ose rregullore kombëtare, funksionimi i takimit të aksionarëve dhe fuqitë e tij kryesore, dhe një përshkrim të të drejtave të aksionarëve se si mund të ushtrohen ato. (f) përbërja dhe funksionimi i organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse dhe komisioneve të tyre. 2. Shtetet Anëtare mund të lejojnë që informatat e kërkuara nga ky nen të deklarohen në një raport të veçantë të publikuar bashkë me raportin vjetor në mënyrën e përcaktuar nga neni 47 ose përmes referencës së raportit vjetor, në rastet kur dokumenti i tillë është në dispozicion për publikun në uebfaqen e kompanisë. Në rast të një raporti të veçantë, deklarata e qeverisjes së përbashkët mund të përfshijnë referencën e bërë paragrafit 1, pikës (d). Neni 51 (1),		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	nën-paragrafi i dytë duhet të vlejë për dispozitat e paragrafit 1, pikat (c) dhe (d) të këtij neni. Për informatat e mbetura, auditori statutor duhet të verifikojë që deklarata e qeverisjes së përbashkët të jetë e hartuar. 3. Shtetet Anëtare mund të lirojnë kompanitë të cilat, përveç aksioneve, kanë lëshuar letra me vlerë që pranohen për tregti në një treg të rregulluar brenda kuptimit të nenit 4(1), pika (14) e Direktivës 2004/39/EC, nga zbatimi i dispozitave të paragrafit 1, pikat (a), (b), (e) dhe (f), përveç nëse kompanitë e tilla kanë lëshuar aksione të cilat tregtohen në një instrument shumë palësh të tregtisë, brenda kuptimit të nenit 4(1), pika (15) e Direktivës 2004/39/EC.		
Neni 47	Publikimi 1. Llogaritë vjetore, të miratuara sipas	Neni 11 i Ligjit parasheh që: 1. Pasqyrat financiare të shoqërive tregtare auditohen në pajtim me standardet ndërkombëtare të	Nuk ka referencë në Ligj rreth këtyre pikave

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	rregullit, dhe raporti vjetor bashkë me opinionin e dorëzuar nga personi përgjegjës për auditimin e llogarive, duhet të publikohet siç parashihet me ligjet e secilit Shtet Anëtar në përputhje me nenin 3 të Direktivës 68/151/EEC. Ligjet e Shtetit Anëtar mund të lejojnë që raporti vjetor të mos publikohet siç është përcaktuar më sipër. Por duhet të jetë e mundur që të merret një kopje e plotë ose pjesëve të raportit të tillë nëse kërkohet. Çmimi i një kopje të tillë nuk duhet të tejkalojë kostot e saj administrative. 1a. Shteti Anëtar i një kompanie ose firme të referuar në nenin 1(1), nën-paragrafët dy dhe tre (subjekti në fjalë) mund të lirojë atë subjekt nga publikimi i llogarive të veta në përputhje me nenin 3 të Direktivës 3 68/151/EEC, me kusht që ato llogari të jenë në dispozicion për publikun në zyrat e saj kryesore, në rastet kur:	auditimit dhe në pajtim me nenin 5 paragrafi 1 të këtij ligji, dorëzohen dhe publikohen në KKRF dhe një kopje dorëzohet në MTI, jo më vonë se më 30 prill të vitit vijues për vitin e kaluar. 2. Pasqyrat financiare të konsoliduara që auditohen në pajtim me Standardet ndërkombëtare të auditimit dhe në pajtim me nenin 5 paragrafi 3 të këtij ligji, do të dorëzohen në KKRF dhe një kopje në MTI, jo më vonë se 30 qershor të vitit vijues.	

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	(a) të gjithë anëtarët që kanë përgjegjësi të pakufizuar të subjektit në fjalë janë kompanitë e referuara në nën-paragrafin e parë të nenit 1(1) të rregulluar me ligjet e Shteteve Anëtare përveç atyre Shteteve Anëtare ligji i të cilave rregullon atë subjekt dhe asnjë prej atyre kompanive nuk publikon llogaritë e subjektit në fjalë me llogaritë e veta; dhe (b) të gjithë anëtarët që kanë përgjegjësi të pakufizuar janë kompani të cilat nuk janë të rregulluara me ligjet e një Shteti Anëtar por të cilat kanë një formular ligjor të krahasueshëm me ato të referuara në Direktivën 68/151/EEC. Kopjet e llogarive duhet të jenë në dispozicion nëse kërkohen. çmimi i një kopjeje të tillë nuk duhet të tejkalojë koston e vet administrative. Sanksionet adekuate duhet të parashihen në rast të dështimit për t'u përputhur me obligimin për publikim të imponuar nga ky paragraf.		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	2. Si përjashtim nga paragrafi 1, Shtetet Anëtare mund t'i lejojnë kompanitë e referuara në nenin 11 që të publikojnë: (a) bilancet e gjendjes të përmbledhura që tregojnë vetëm artikujt e paraprirë nga shkronjat dhe numrat romak nga nenet 9 dhe 10, duke deklaruar ndaras informatat e kërkuara në kllapa nën D (II) nën 'Asetet' dhe C nën 'Përgjegjësitë' në nenin 9 dhe në D (11) në nenin 10, por në total për të gjithë artikujt në fjalë, dhe (b) shënimet e përmbledhura për llogaritë në përputhje me nenin 44. Neni 12 duhet të aplikohet. Veç kësaj, Shtetet Anëtare mund të lirojnë kompanitë e tilla nga obligimi për të publikuar llogaritë e tyre të profitit dhe humbjeve, dhe raportet vjetore dhe opinionet e personave përgjegjës për auditim të llogarive. 3. Shtetet Anëtare mund të lejojnë kompanitë e përmendura në nenin 27 që të publikojnë:		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	(a) bilancet e gjendjes të përmbledhura duke treguar vetëm artikujt e paraprirë nga shkronjat dhe numrat romak në nenet 9 dhe 10 duke deklaruar ndaras qoftë në bilanc të gjendjes qoftë në shënimet e llogarive: — C (I) (3), C (II) (1), (2), (3) dhe (4), C (III) (1), (2), (3), (4) dhe (7), D (II) (2), (3) dhe (6) dhe D (III) (1) dhe (2) nën ‘Asetet’ dhe C, (1), (2), (6), (7) dhe (9) nën ‘Përgjegjësitë në nenin 9, — C (I) (3), C (II) (1), (2), (3) dhe (4), C (III) (1), (2), (3), (4) dhe (7), D (II) (2), (3) dhe (6), D (III) (1) dhe (2), F (1), (2), (6), (7) dhe (9) dhe (I) (1), (2), (6), (7) dhe (9) në nenin 10, — informatat e kërkuara në kllapa nën D (II) nën ‘Asetet’ dhe C nën ‘Përgjegjësitë’ në nenin 9, në total për të gjithë artikujt në fjalë dhe ndaras për D (II) (2) dhe (3) nën ‘Asetet’ dhe C (1), (2), (6), (7) dhe (9) nën		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	‘Përgjegjësitë’, informatat e kërkuara në kllapa në D (11) në nenin 10, në total për të gjithë artikujt në fjalë dhe ndaras për D (II) (2) dhe (3)ë (b) shënimet e përmbledhura të llogarive të tyre pa informatat e kërkuara në nenin 43 (1) (5), (6), (8), (10) dhe (11). Megjithatë, shënimet e llogarive duhet të japin informatat e specifikuar në nenin 43 (1) (6) si total për të gjithë artikujt në fjalë. Ky paragraf nuk do të paragjykojë paragrafin 1 për atë që ka të bëjë me llogarinë e profitit dhe humbjes, raportin vjetor dhe opinionin e personit përgjegjës për auditimi të llogarive. Neni 12 duhet të aplikohet.		
Neni 48	Sa herë që llogaritë vjetore dhe raporti vjetor publikohen në tërësi, ato duhet të riprodhohen në formën dhe tekstin në bazë të të cilave personi përgjegjës për auditim të llogarive e ka krijuar opinionin e vet. Ato duhet të shoqërohen me tekstin	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë specifike në Ligj rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	e plotë të raportit të tij.		
Neni 49	Nëse llogaritë vjetore nuk publikohen në tërësi, atëherë duhet të tregohet që versioni i publikuar është i përmbledhur dhe duhet t'i referohet regjistrin në të cilin llogaritë janë ruajtur në përputhje me nenin 47 (1). Në rastet kur ruajtja e tillë ende nuk është bërë, atëherë ky fakt duhet të deklarohet. Raporti i personit ose personave përgjegjës për auditim të llogarive vjetore (tani e tutje: auditorët statutor) nuk duhet të shoqërojnë këtë publikim, por duhet të deklarohet nëse është dhënë një opinion i pakualifikuar, i kualifikuar ose i kundërt i auditimit, ose nëse auditorët statutor nuk ishin në gjendje të japin opinionin. Po ashtu duhet të deklarohet nëse raporti i auditorëve statutor ka përfshirë referencë ndaj ndonjë çështje për të cilën auditorët statutor kanë tërhequr vëmendjen përmes potencimit pa kualifikuar opinionin e auditimit.	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë specifike në Ligj rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
Neni 50	Informatat në vijim duhet të publikohen bashkë me llogaritë vjetore dhe në këtë mënyrë: — adresimi i profitit ose humbjeve, — përvetësimi i profitit ose adresimit të humbjeve aty ku këta artikuj nuk janë të dhënë në llogaritë vjetore.	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë specifike në Ligj rreth kësaj çështjeje.
Neni 50b	Detyra dhe përgjegjësia për publikim të llogarive vjetore dhe raportit vjetor. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse të kompanisë kanë detyrë kolektive të sigurojnë që llogaritë vjetore, raporti vjetor dhe, kur të ofrohet ndaras, deklarata e qeverisjes së përbashkët, të ofruara në bazë të nenit 46 të hartohen dhe publikohen në përputhje me kërkesat e kësaj Direktive dhe aty ku është e aplikueshme, në përputhje me standardet ndërkombëtare të llogaritjes të	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë specifike në Ligj rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	miratuara në përputhje me Rregulloren (EC) Nr. 1606/2002. Organet e tilla duhet të veprojnë brenda kompetencave të caktuara nga ligji kombëtar.		
Neni 50c	Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që dispozitat e ligjeve, rregulloreve dhe atyre administrative rreth përgjegjësisë të vlejné për anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse të referuara në nenin 50b, së paku drejt kompanisë, për shkelje të detyrës të referuar në nenin 50b.	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë specifike në Ligj rreth kësaj çështjeje.
Neni 51a	Përmbajtja e Raportit të Auditimit Statutor 1. Raporti i auditorëve statutor duhet të përfshijë: (a) një hyrje e cila së paku duhet të identifikojë llogaritë vjetore të cilat i nënshtrohen auditimit statutor, bashkë me kornizën e raportimit financiar që	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.	Nuk ka referencë në Ligj rreth kësaj çështjeje.

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	është aplikuar në përgatitjen e tij, (b) një përshkrim të spektrit të auditimit statutor i cili duhet të identifikojë së paku standardet e auditimit në përputhje me të cilat është bërë auditimi statutor, (c) një opinion i auditimit duhet të deklarojë qartë opinionin e auditorëve statutor nëse llogaritë vjetore japin një pasqyrë të drejtë dhe të vërtetë në përputhje me kornizën përkatëse të raportimit financiar dhe, aty ku është adekuate nëse llogaritë vjetore janë në përputhje me kërkesat statutorë. Opinioni i auditimit duhet të jetë opinion i pakualifikuar, i kualifikuar ose i kundërt ose nëse auditorët statutor nuk janë në gjendje të japin një opinion të auditimit atëherë një deklaratë të lirim nga përgjegjësia (<i>disclaimer</i>). (d) një referencë të të gjitha çështjeve për të cilat auditorët statutor kanë		

Ref.	Neni nga Direktiva e Katërt	Ligji përkatës në Kosovë	Komente
	tërhequr vëmendjen përmes potencimit pa kualifikim të opinionit të auditimit. (e) një opinion rreth konsistencës ose jo të raportit vjetor me llogaritë vjetore të vitit të njëjtë financiar. 2. Raporti duhet të nënshkruhet dhe të shënohet data nga auditorët statutor.		

Tabela e Përputhshmërisë – Direktiva e Tetë

BE	Direktiva 2006/43/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 maj 2006 për auditimet statutore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara Direktiva 2008/30/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 marsit 2008
KOSOVË	LIGJI PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM (Ligji Nr. 04/L-014)

Neni nga Direktiva e Tetë	Ligji përkatës në Kosovë	Koment
<i>Neni 1</i> Objekti Kjo Direktivë përcakton rregullat rreth auditimit statutor të llogarive vjetore dhe të konsoliduara.	Neni 1 Qëllimi Me këtë ligj rregullohet sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar i shoqërive tregtare, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilistë profesional, licencimi i auditorëve dhe firmave vendore e të huaja të auditimit.	Ligji mbulon kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin.

<i>Neni 2</i> Definicionet Për qëllime të kësaj Direktive, do të vlejnjë përkufizimet në vijim: 1) "auditimi statutor" nënkupton auditimin e llogarive vjetore ose të konsoliduar siç kërkohet me ligjet e Komunitetit; 2) "auditor statutor" nënkupton një person fizik i certifikuar, në përputhje me këtë Direktivë, nga autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar për të kryer auditime statutores; 3) "firma e auditimit" nënkupton një person juridik ose ndonjë subjekt tjetër, pavarësisht nga forma ligjore, i certifikuar në përputhje me këtë Direktivë nga autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar për të kryer auditime statutores; 4) "subjekti i auditimit nga një shtet i tretë" nënkupton një subjekt, pavarësisht nga forma e vet ligjore, që kryen auditime të llogarive vjetore ose të konsoliduara të një kompani të inkuorporuar në një vend të tretë; 5) "auditor nga një shtet i tretë" nënkupton një person fizik i cili kryen auditime të llogarive vjetore dhe të konsoliduara të një kompanie të inkuorporuar në një shtet të tretë; 6) "auditor grupor" nënkupton auditorin(ët) statutor ose firmën(at) e auditimit që kryejnë auditime statutores të llogarive të konsoliduara; 7) "rrjeti" nënkupton strukturën më të madhe: – që synon bashkëpunimin dhe të cilit i takon	Neni 2 Përkufizimet 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.4. Firmë auditimi - person juridik ose çfarëdo entiteti tjetër, pa marrë parasysh formën ligjore, që është e licencuar, në përputhshmëri me këtë ligj për të kryer punët e auditimit. 1.15. SNK - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet në lidhje me (interpretimet e SIC-IFRIC), amendamentet e mëvonshme për këto standarde dhe interpretimet lidhur me to, si dhe standardet për të ardhmen sikur edhe interpretimet me to, të lëshuara dhe të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). 1.16. SNA - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të lëshuara nga BSNA. 1.23. Auditor - personi fizik i cili është licencuar në përputhshmëri me këtë ligj. 1.24. Partnerët kyç të auditimit – nënkupton:	Nuk ka definicion të auditimit statutor, auditorit të grupit, rrjetit, degët e një firme të auditimit, raportit të auditimit, jo-praktikuesit, auditorit të vendit të tretë, subjektit auditues të vendit të tretë.
--	--	--

auditori statutor ose firma e auditimit, dhe – që ka synim të qartë të ndarjes së profitit ose kostos ose ka pronësi, kontroll ose menaxhim të përbashkët, politika dhe procedura të përbashkëta të kontrollit të cilësisë, një strategji të përbashkët të punës, përdorimin e një emri-brandi të përbashkët ose një pjesë të konsiderueshme të resurseve profesionale; 8) "degë" e një firme të auditimit nënkupton çdo ndërmarrje, pavarësisht formës së vet ligjore, që është e lidhur me një firmë të auditimit përmes pronësisë, kontrollit ose menaxhimit të përbashkët; 9) "raporti i auditimit" nënkupton raportin e referuar në nenin 51a të Direktivës 78/660/EEC dhe nenin 37 të Direktivës 83/349/EEC të lëshuar nga auditori statutor ose firma e auditimit; 10) "autoritetet kompetente" nënkupton autoritetet ose organet e dizajnuara me ligj që janë përgjegjëse për rregullim dhe/ose mbikëqyrje të auditorëve statutor dhe firmave të auditimit ose të aspekteve specifike të tyre; referenca për "autoritetin kompetent" në një nen specifik nënkupton referencë autoritetit ose organit (eve) përgjegjëse për funksionet e referuara në atë nen; 11) "standartet ndërkombëtare të auditimit" nënkupton Standardet Ndërkombëtare për Auditim (ISA) dhe Deklaratat dhe Standardet e ndërlidhura aq sa janë relevante për auditimin statutor; 12) "standartet ndërkombëtare të kontabilitetit" nënkuptojnë Standardet	1.24.1. auditorin e licencuar të emëruar nga një firmë e auditimit për një angazhim, i cili është përgjegjës kryesor për kryerjen e auditimit në emër të firmës së auditimit; 1.24.2. në rast të grupit të auditorëve, firmat e auditimit emërojnë auditorët përgjegjës për të kryer auditimin në nivel të grupit. 1.24.3. auditorëve të cilët e nënshkruajnë raportin e auditimit. 1.26. Shoqatë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit –organizata jofitimprurëse e cila është themeluar për të promovuar dhe avancuar pozitën, efikasitetin dhe dobishmërinë e profesionit të kontabilitetit si interes i përgjithshëm.	
--	---	--

Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) dhe Interpretimet e ndërlidhura (interpretimet SIC-IFRIC), amendamentet pasuese në ato standarde dhe interpretimet e ndërlidhura, dhe standardet e ardhshme dhe interpretimet e ndërlidhura të lëshuara ose të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB); 13) "subjektet me interes publik" nënkupton subjektet e rregulluara me ligjet e një Shteti Anëtar letrat me vlerë të transferueshme të të cilit janë të pranuar për tregti në një treg të rregulluar të cilido Shtet Anëtar brenda kuptimit të pikës 14 të nenit 4(1) të Direktivës 2004/39/EC, institucionet kreditore siç janë definuar në pikën 1 të nenit 1 të Direktivës 2000/12/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 20 mars 2000 në lidhje me fillimin dhe bërjen e punës së institucioneve kreditore dhe ndërmarrjeve të sigurimit brenda kuptimit të nenit 2(1) të Direktivës 91/674/EEC. Shtetet Anëtare mund të caktojnë edhe subjekte tjera si subjekte të interesit publik, për shembull subjektet që kanë relevancë të konsiderueshme publike për shkak të natyrës së punës së tyre, madhësisë së tyre ose numrit të punonjësve të tyre; 14) "kooperativë" nënkupton një Shoqëri Kooperative Evropiane siç është përcaktuar në nenin 1 të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 1435/2003 të datës 22 korrik 2003 mbi Statutin e Shoqërisë Kooperative Evropiane (SCE), ose ndonjë kooperative tjetër për të cilën kërkohet		
--	--	--

auditimi statutor në bazë të ligjeve të Komunitetit, siç janë institucionet kreditore të përcaktuara në pikën 1 të nenit 1 të Direktivës 2000/12/EC dhe ndërmarrjet e sigurimit brenda kuptimit të nenit 2(1) të Direktivës 91/674/EEC; 15) "jo-praktikues" nënkupton çdo person fizik, i cili për së paku tri vite para përfshirjes së tij/saj në qeverisjen e sistemit të mbikëqyrjes publike, nuk ka kryer auditime statutore, nuk ka pasur të drejta votimi në një firmë të auditimit, nuk ka qenë anëtar i një organi administrativ ose menaxhues të një firme të auditimit dhe nuk ka qenë i punësuar ose i lidhur me një firmë të auditimit; 16) "partner(ët) kyç të auditimit" nënkupton: (a) auditori(ët) statutor të emëruar nga një firmë e auditimit për një angazhim të caktuar të auditimit si përgjegjës kryesor për kryerjen e auditimit statutor në emër të firmës së auditimit; ose (b) në rast të një grupi të auditimit, së paku auditori(ët) statutor të emëruar nga një firmë e auditimit si përgjegjës kryesor për kryerjen e auditimit statutor në nivel të grupit dhe auditori(ët) statutor të emëruar si përgjegjës kryesor në nivel të subsidiariteve materiale; ose (c) auditori(ët) statutor të cilët nënshkruajnë raportin e auditimit.		
---	--	--

Neni 3 Miratimi i auditorëve statutor dhe firmave të auditimit 1. Auditimi statutor duhet të kryhet vetëm nga ana e auditorëve statutor ose firmave të auditimit të cilat janë të certifikuara nga secili Shtet Anëtar që kërkon auditim statutor. 2. Secili Shtet Anëtar duhet të emërojë autoritetet kompetente të cilat duhet të jenë përgjegjëse për miratimin/certifikimin e auditorëve statutor dhe firmave të auditimit. Autoritetet kompetente mund të jenë asociacione profesionale me kusht që ato i nënshtrohen sistemit të mbikëqyrjes publike siç parashihet në Kapitullin VIII. 3. Pa paragjykuar nenin 11, autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare mund të certifikojnë, si auditor statutor, vetëm personat fizik të cilët plotësojnë së paku kushtet e dhëna në nenet 4 dhe 6 deri në 10. 4. Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare mund të certifikojnë si firma të auditimit vetëm ato subjekte të cilat plotësojnë kushtet në vijim: (a) personat fizik që kryejnë auditime statutorë në emër të një firme të auditimit duhet të plotësojnë së paku kushtet e parapara nga nenet 4 dhe 6 deri në 12 dhe duhet të certifikohen si auditorë statutor në Shtetin Anëtar përkatës; (b) shumica e të drejtave të votimit në një subjekt duhet të mbahen nga firmat e auditimit të cilat janë të certifikuara në cilindo Shtet Anëtar ose nga personat fizik të cilët plotësojnë kushtet e parapara nga nenet 4 dhe 6 deri në 12. Shtetet	Neni 5 Zbatimi i SNRF, SNK, SKK dhe SNA dhe kërkesave tjera për përgatitjen dhe auditimin e pasqyrave financiare 6. Të gjitha auditimet në Kosovë që përfshijnë të gjitha auditimet e kërkuara nga ky ligj, dhe auditimet e jashtme të pavarura të bizneseve të tjera për organizatat joprotabile, organizatat tjera shoqërore apo publike dhe entitetet tjera të cilat janë të mandatuara me ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë, do të kryhen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe interpretimet relevante, udhëzimet dhe deklaratat e IAASB, dhe nga auditorët që janë të aprovuar për të kryer auditime nga autoritetet kompetente siç janë definuar nga ky ligj. Neni 14 Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së 1.3. licencimi dhe mbajtja e regjistrit të auditorëve dhe firmave audituese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit; Neni 15 Komisionet e KKRF-së 1. KKRF-ja do të caktojë komisione sipas nevojës për të siguruar zbatimin e	Ligji parasheh që auditimit statutor të kryhet vetëm nga auditorët e certifikuar për kryerjen e auditimeve statutorë nga autoriteti kompetent (neni nuk i referohet fare firmave të auditimit). Një prej përgjegjësive të Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) është certifikimi i auditorëve dhe firmave të auditimit. Ligji parasheh që, për t'u bërë auditor, personi duhet të jetë anëtar i një asociacioni profesional të pranuar. Për më tepër, Ligji kërkon që asociacionet profesionale mund të certifikojnë vetëm ata individ të cilët kanë kryer programin e certifikimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të Kontabilistëve (IES). KKRF është përgjegjëse për certifikimin e asociacioneve të kontabilitetit, me një prej kritereve për cilësinë e programit certifikues të asociacionit të kandidatit; Neni 4 b) dhe c) i Direktivës së Tetë për anëtarët e organit administrativ ose menaxhues nuk mbulohet nga Ligji.
--	--	--

Anëtare mund të parashohin që personat fizik të tillë duhet të certifikohen edhe në një Shtet Anëtar tjetër. Për qëllime të auditimit statutor të kooperativave dhe subjekteve të ngjashme të referuara në nenin 45 të Direktivës 86/635/EEC, Shtetet Anëtare mund të miratojnë dispozita tjera specifike në lidhje me të drejtat e votimit; (c) shumica – deri në maksimum prej 75 % — të anëtarëve të organit administrativ ose menaxhues të subjektit duhet të jenë firma të auditimit të certifikuara nga cilido Shtet Anëtar ose persona fizik të cilët plotësojnë së paku kushtet e parapara në nenet 4 dhe 6 deri në 12. Shtetet Anëtare mund të parashohin që personat fizik të tillë duhet të jenë të certifikuar edhe në një Shtet Anëtar tjetër. Një organ i tillë nuk ka më shumë se dy anëtar, një prej atyre anëtarëve duhet të plotësojë së paku kushtet në këtë pikë; (d) firma duhet të plotësojë kushtet e parapara nga neni 4. Shtetet Anëtare mund të vendosin kushte shtesë vetëm në lidhje me pikën (c). Kushtet e tilla duhet të jenë në përputhje me objektivat e ndjekura dhe nuk duhet të shkojnë përtej atyre që janë të domosdoshmërisht të nevojshme.	standardeve ndërkombëtare përkatëse të BE-së “<i>Acquis Communautaire</i>” duke përfshirë direktivat nr. 78/660/EEC, nr. 83/349/EEC dhe nr. 84/253/EEC të BE-së. 2. KKRF-ja duhet të ketë këto komisione, për: 2.3. licencim të auditorëve, firmave audituese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit;	
<i>Neni 4</i> Reputacioni i mirë Autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar mund të certifikojnë vetëm personat fizik ose firmat me reputacion të mirë.	Neni 21 Kushtet 1. KKRF-ja licencon auditorë personat që plotësojnë kriteret e mëposhtëm: 1.5. ata që plotësojnë standardet më të larta	Dispozita e reputacionit të mirë për auditorët është në Ligj por jo edhe për firma.

	të integritetit dhe kompetencës profesionale dhe që kanë reputacion të mirë.	
<i>Neni 5</i> Revokimi i licencës 1. Licencimi i një auditori statutor ose një firme të auditimit duhet të revokohet nëse reputacioni i mirë i atij personi ose firme është komprometuar seriozisht. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të parashohin një periudhë të arsyeshme kohore me qëllim të përmbushjes së kërkesave për reputacion të mirë. 2. Licencimi i një firme të auditimit duhet të revokohet nëse njëra prej kushteve të parapara në nenin 3(4), pikat (b) dhe (c) nuk janë më të plotësuara. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të parashohin një periudhë të arsyeshme kohore me qëllim të përmbushjes së atyre kushteve. 3. Në rastet kur licencimi i një auditori statutor ose një firme të auditimit revokohet për çfarëdo arsye, autoriteti i Shtetit Anëtar, ku është revokuar certifikimi, duhet të komunikojë këtë fakt dhe arsyet për revokim autoriteteve kompetente të Shteteve Anëtare në vendet ku auditori statutor ose firma e auditimit në fjalë është e miratuar, të cilat janë të futura në regjistrin e Shtetit Anëtarit anëtar të emëruar së pari në përputhje me nenin 16(1), pika (c).	Neni 21 Kushtet 8. KKRF-ja do të revokojë licencën e një firme të huaj ose vendore të auditimit, ose auditorit i cili është i licencuar në pajtueshmëri me këtë ligj në çdo kohë, nëse firma e auditimit ose auditori nuk do të jetë më anëtar i një shoqate të licencuar profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, ose e shkel pavarësinë e auditorit, etikën dhe kërkesat për sigurimin e cilësisë të përcaktuara nga KKRF-ja.	Nuk ka referencë specifike në Ligj për këto tri instanca që do të mund të çonin në revokimin e licencës së auditimit. Po ashtu, Ligji nuk parasheh një periudhë të arsyeshme kohore me qëllim të përmbushjes së kërkesave të domosdoshme për plotësimin e kushteve për licencim.

<i>Neni 6</i> Kualifikimet arsimore Pa paragjykuar nenin 11, një person fizik mund të certifikohet për kryerje të auditimit statutor vetëm pas marrjes së diplomës universitare ose nivelit ekuivalent, pastaj plotësimit të një kursi për udhëzime teorik, përfundimin e trajnimit praktik dhe kalimit të provimit të aftësisë profesionale nga një nivel final universitar ose provim ekuivalent, të organizuar ose të pranuar nga Shteti Anëtar në fjalë.	Neni 20 Kualifikimi 3. Kandidatët për kontabilist të certifikuar duhet të kenë diplomë universiteti në fushën e ekonomisë dhe biznesit, tri (3) vite përvojë pune në lëmin e kontabilitetit, të kenë marrë, dhe të kenë kaluar provimin e certifikimit për këtë qëllim. 4. Arsimimi profesional për kontabilist të certifikuar duhet të jetë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK-së si dhe me direktivat relevante të Komisionit Evropian për këtë qëllim.	Ligji parasheh kërkesat për shkallë universitare në ekonomi dhe biznes, trajnim profesional dhe përvojë si dhe një provim. Megjithatë, Ligji nuk parasheh që vet kualifikimi duhet të jetë nga një nivel final universitar ose provim ekuivalent dhe hyrja në profesion tani është vetëm i mundur për të diplomuarit nga ekonomia ose biznesi.
<i>Neni 7</i> Provimi i aftësisë profesionale Provimi i aftësisë profesionale i referuar në nenin 6 duhet të garantojë nivelin e domosdoshëm të njohurive teorike të fushave relevante për auditim statutor dhe aftësinë për të aplikuar njohuritë e tilla në praktikë. Së paku një pjesë e atij provimi duhet të jetë me shkrim.	Neni 20 Kualifikimi 4. Arsimimi profesional për kontabilist të certifikuar duhet të jetë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK-së si dhe me direktivat relevante të Komisionit Evropian për këtë qëllim.	Ligji parasheh që arsimi profesional duhet të jetë në përputhje me IES dhe Direktivat relevante.

<i>Neni 8</i> Testimi i njohurive teorike 1. Testimi i njohurive teorike të përfshira në provim duhet të mbulojë këto fusha në veçanti: (a) teoria dhe parimet e përgjithshme të kontabilitetit; (b) standardet dhe kërkesat ligjore të ndërlidhura me përgatitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduara; (c) standardet ndërkombëtare të kontabilitetit; (d) analizën financiare; (e) kosto dhe menaxhimi i kontabilitetit; (f) menaxhimi i rrezikut dhe kontrolli i brendshëm; (g) shkathësitë profesionale dhe të auditimit; (h) kërkesat ligjore dhe standardet profesionale të ndërlidhura me auditimin dhe auditorët statutor; (i) standardet ndërkombëtare të auditimit; (j) etika dhe pavarësia profesionale. 2. Po ashtu, duhet të mbulojë së paku fushat në vijim aq sa janë relevante me auditim: (a) e drejta e kompanive dhe qeverisja e përbashkët; (b) e drejta e falimentimit dhe procedurat e ngjashme; (c) ligjet tatimore; (d) e drejta civile dhe komerciale; (e) ligji për sigurim sociale dhe ligji i punës; (f) sistemet kompjuterike dhe të teknologjisë informative; (g) ekonomia e biznesit, e përgjithshme dhe financiare;		Ligji nuk specifikon spektrin e fushave të përfshira në testin e njohurive teorike për auditorë, megjithatë kërkon përputhshmëri me Direktivat relevante si dhe me IES. BKSRF ka njohur SCAAK si organin profesional të kontabilitetit në Kosovë (përfshirë auditimin) dhe supozohet që njohja vlen nën Ligjin aktual. SCAAK ka krijuar një program certifikues që përmbush kërkesat e Direktivës për Auditim Statutor dhe Standardet Ndërkombëtare të Edukimit. Programi certifikues i SCAAK, që përdor materiale të trajnimit të përkthyer dhe rregullisht të azhurnuara të ACCA, përbëhet nga tri faza, si vijon: Teknik i kontabilitetit: kontabiliteti financiar 1, kosto e kontabilitetit, sistemet informative të menaxhmentit, e drejta komerciale dhe tatimet. Kontabilist i certifikuar: raportim financiar, auditim, menaxhim financiar, kontabiliteti i avancuar i menaxhmentit.
---	--	--

(h) matematika dhe statistika; (i) parimet bazë të menaxhimit financiar të ndërmarrjeve. 3. Në përputhje me procedurën e referuar në nenin 48(2), Komisioni mund të miratojë listën e fushave/lëndëve që duhet përfshirë në testin e njohurive teorike të referuara në paragrafin 1. Gjatë miratimit të atyre masave zbatuese, Komisioni duhet të merr parasysh zhvillimet në auditim dhe në profesionin e auditimit.		Auditor: raporti financiar i avancuar, auditim i avancuar dhe sigurim i cilësisë, menaxhim strategjik, praktikë profesionale.
<i>Neni 9</i> Përfshirjet 1. Si përfshirim nga nenet 7 dhe 8, një Shtet Anëtar mund të parasheh që një person i cili ka kaluar provimin universitar ose ekuivalent ose ka shkallë universitare ose kualifikim ekuivalent në një ose më shumë tema të referuara në nenin 8, mund të lirohen nga testimi i njohurive teorike në fushat e mbuluara nga ai provim ose shkallë. 2. Si përfshirim nga neni 7, një Shtet Anëtar mund të parasheh që poseduesi i shkallës universitare ose kualifikimit ekuivalent në një ose më shumë fusha të referuara në nenin 8 mund të lirohet nga testi i aftësisë së aplikimit në praktikë të njohurive teorike të tij/saj të fushave të tilla nëse ai/ajo iu ka nënshtruar trajnimit praktik në ato fusha të dëshmuara nga provimi ose diploma e njohur nga Shteti.		Ligji nuk përmend mundësinë e përfshirimit nga fushat/lëndët e përkrahura.

<i>Neni 10</i> Trajnimi praktik 1. Me qëllim të sigurimit të aftësisë për të aplikuar njohuritë teorike në praktikë, një test i të cilit është i përfshirë në provim, i trajnuari duhet të kryejë së paku tri vite të trajnimit praktik në, ndërmjet tjerash, auditim të llogarive vjetore, llogarive të konsoliduara ose pasqyrave financiare të ngjashme. Së paku dy të tretat e trajnimit praktik të tillë duhet të kryhen me një auditor statutor ose firmë të auditimit të certifikuar në cilindo Shtet Anëtar. 2. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që i tërë trajnimi të bëhet me persona që ofrojnë garanci adekuate rreth aftësisë së tyre për të ofruar trajnim praktik.	Neni 21 Kushtet 1. KKRF-ja licencon auditorë personat që plotësojnë kriteret e mëposhtëm: 1.3. ata që kanë tri (3) vite përvojë pune nën mbikëqyrjen e një auditori;	Ligji nuk parasheh kontekstin (p.sh. firmat e certifikuara të auditimit) në të cilin duhet të fitohet përvoja praktike e as që trajnerët duhet të ofrojnë garanci adekuate të aftësive.
<i>Neni 11</i> Kualifikimi përmes përvojës praktike afatgjatë Një Shtet Anëtar mund të certifikojë një person i cili nuk përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 6 si auditor statutor, nëse ai/ajo mund të dëshmojë se: ai/ajo ka qenë i/e angazhuar në aktivitete profesionale për 15 vite, të cilat i kanë mundësuar atij/asaj fitimin e përvojës së mjaftueshme në fushat e financave, ligjeve dhe kontabilitetit dhe ka kaluar provimin e aftësisë profesionale të referuar në nenin 7, ose (b) ai/ajo ka qenë e angazhuar në aktivitete profesionale për 7 vite në ato fusha dhe, përveç kësaj, ka kryer trajnimin praktik të referuar në		Nuk ka përjashtime të tilla në Ligj.

nenin 10 dhe ka kaluar provimin e aftësisë profesionale të referuar në nenin 7.		
<i>Neni 12</i> Kombinimi i trajnimit praktik dhe udhëzimit teorik Shtetet Anëtare mund të parashohin që periudhat e udhëzimit teorik në fushat e referuara në nenin 8 duhet të llogariten si periudhë e aktivitetit profesional të referuar në nenin 11 me kusht që udhëzimi i tillë dëshmohej përmes ekzaminimit të pranuar nga Shteti. Udhëzimi i tillë nuk duhet të jetë më i shkurtër se një vit, e as nuk mund të shkurtojë periudhën e aktivitetit profesional për më pak se katër vite. 2. Periudha e aktivitetit profesional dhe trajnimit praktik nuk duhet të jetë më e shkurtër se kursi i udhëzimit teorik bashkë me trajnimin praktik të kërkuar në nenin 10.		Nuk ka opsion të tillë në Ligj.
<i>Neni 13</i> Arsimimi i vazhdueshëm Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që nga auditorët statutor të kërkohet të marrin pjesë në programet adekuate të arsimimit të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes së njohurive teorike, shkathtësive profesionale dhe vlerave të tyre në nivel të lartë të kënaqshëm, dhe se dështimi për të respektuar kërkesat e arsimimit të vazhdueshëm rezulton me ndëshkime adekuate të referuara në nenin 30.	Neni 14 Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së 1.5. mbikëqyrë edukimin e vazhdueshëm, sigurimin e kualitetit dhe sistemit disiplinor;	Ligji parasheh që një prej përgjegjësive të KKRF është mbikëqyrja e ZHVP-së. Megjithatë nuk ka referencë në Ligj që auditorët kërkohen të marrin pjesë në programet adekuate të ZHVP-së. Me qëllim të posedimit dhe ruajtjes së licencës, Ligji kërkon nga të gjithë kontabilistët dhe auditorët të jenë anëtarë të organit profesional të

		kontabilitetit, në këtë rast SCAAK, dhe nga SCAAK kërkohet që të marrin pjesë në programet e zhvillimit të vazhdueshëm profesional. SCAAK kërkon që të gjithë kontabilistët e certifikuar (pra edhe auditorët) të marrin pjesë në 40 orë të ZHVP-së çdo vit; kontabilistët e certifikuar duhet të kenë së paku 18 orë të ZHVP formale të verifikueshme në vit, ndërsa auditorët e licencuar 24 orë. Nga anëtarët kërkohet të vlerësohet se cila përmbajtje e ZHVP është relevante për ata në bazë të punës dhe/ose specializimit të tyre. Megjithatë, nuk ka referencë për procedurat disiplinore dhe ndëshkimet në rast të mosrespektimit të kërkesave për arsimim të vazhdueshëm.
<i>Neni 14</i> Miratimi i auditorëve statutor nga Shtetet tjera Anëtare Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare duhet të vendosin procedura për miratimin e auditorëve statutor të cilët janë licencuar në Shtetet tjera Anëtare. Ato procedura nuk duhet të tejkalojnë kërkesën për kalimin e testit të aftësisë në përputhje me nenin 4 të Direktivës së Këshillit 89/48/EEC të 21 dhjetorit 1988 mbi një sistem të përgjithshëm të njohjes së diplomave të arsimit të lartë të lëshuara	Neni 14 Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së 2. KKRF-ja bën nostrifikimin e certifikatave ndërkombëtare të auditorëve dhe kontabilistëve. 3. Kandidatët që kanë tituj dhe kualifikime tjera kanë të drejtë në njohjen e këtyre titujve dhe kualifikimeve në bazë të kërkesës për njohje pranë shoqatës së miratuar në Kosovë. Secila shoqatë e miratuar duhet që të ketë	Procedura për miratimin e certifikatave ndërkombëtare të auditorëve dhe kontabilistëve është e miratuar. Megjithatë, Ligji nuk parasheh që këto procedura të tejkalojnë kërkesën për kalimin e testit të njohurive.

pas kryerjes së arsimit dhe trajnimit profesional me kohëzgjatje prej së paku tri viteve (1). Testi i aftësive, i cili duhet të bëhet në një prej gjuhëve të lejuara me rregullat gjuhësore të aplikueshme në Shtetin Anëtar në fjalë, duhet të mbulojë vetëm njohuritë adekuate të auditorit statutor mbi ligjet dhe rregulloret e atij Shteti Anëtar aq sa janë relevante për auditimet statutore.	skemë të miratuar nga KKRF, për njohjen e kualifikimeve dhe titujve tjerë nga ato të ofruara nga vetë shoqata në mënyrë që kandidatët e interesuar të mund të ushtrojnë të drejtën e përshkruar në këtë paragraf.	
<i>Neni 15</i> Regjistri publik 1. Secili Shtet Anëtar duhet të sigurojë që auditorët statutor dhe firmat e auditimit të futen në një regjistër publik në përputhje me nenet 16 dhe 17. Në raste të jashtëzakonshme, Shtetet Anëtare mund të anashkalojnë kërkesat e parapara në këtë nen dhe nenin 16 rreth deklaramit deri në atë masë sa është e domosdoshme për të lehtësuar një kërcënim të menjëhershëm dhe të domethënës për sigurinë personale të çdo personi. 2. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që secili auditor statutor dhe çdo firmë e auditimit të identifikohet në regjistrin publik përmes një numri individual. Informatat e regjistrimit duhet të ruhen në regjistër në formë elektronike dhe duhet të jenë të qasshme për publikun. 3. Regjistri publik duhet të përfshijë edhe emrin dhe adresën e autoriteteve kompetente përgjegjës për miratimin e referuar në nenin 3, për sigurim të cilësisë siç është referuar në nenin 29, për hetimet dhe ndëshkimet e auditorëve statutor dhe firmave të	Neni 14 Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së 1. Funksionet e KKRF-së janë: 1.3. licencimi dhe mbajtja e regjistrit të auditorëve dhe firmave audituese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit; Neni 17 Raportimi i KKRF 7. KKRF-ja mbanë regjistrin publik të të gjithë auditorëve dhe firmave të auditimit.	1. Ligji parasheh një kërkesë që KKRF të mban një regjistër publik të të gjithë auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit statutor por nuk ka kërkesa rreth asaj se çfarë duhet të përmbajë regjistri publik. 2. Auditorët statutor dhe firmat e auditimit nuk identifikohen në regjistrin publik me një numër individual. Ekziston një regjistër në formë elektronike i cili mund të qaset publikisht përmes uebfaqes së MF-së, por aktualisht regjistri mbahet në Excel pa njohuri rreth shpeshtësisë së azhurnimit. 3. Paragrafi 3 i nenit 15 i Direktivës nuk mbulohet nga ligji.

auditimit siç është referuar në nenin 30, dhe për mbikëqyrjen publike siç është referuar në nenin 32. 4. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që regjistri publik të jetë plotësisht funksional deri me 29 qershor 2009.		
<i>Neni 16</i> Regjistrimi i auditorëve statutor 1. Sa i përket auditorëve statutor, regjistri publik duhet të përmbajë së paku këto informata: (a) emrin, adresën dhe numrin e regjistrimit; (b) emrin, adresën, uebfaqen dhe numrin e regjistrimit, nëse ka të tilla, të firmës së auditimit e cila punëson auditorin statutor ose me të cilin ai/ajo është i shoqëruar si partner ose ndryshe; (c) të gjitha regjistrimet tjera si auditor statutor me autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare tjera dhe si auditor në vend të tretë, përfshirë emrin(at) e autoriteteve regjistruese dhe nëse është e aplikueshme edhe numrin(at) e regjistrimit. 2. Auditorët e vendit të tretë të regjistruar në përputhje me nenin 45 duhet të shënohen qartë në regjistër si të tillë dhe jo si auditor statutor.		1. Ligji nuk përmban dispozita që specifikojnë se cilat informata duhet të përfshihen në regjistër. Excel-i në fjalë që është në dispozicion për publikun përfshin emrin e auditorit, datën e lëshimit të licencës, datën e ri-licencimit, datën e skadimit të licencës, numrin e telefonit dhe adresën e emailit. 2. Nuk ka dispozitë të tillë. Excel-i në fjalë që është në dispozicion për publikun përfshin auditorët e jashtëm si auditor statutor me këto detaje: emrin e auditorit, datën e lëshimit të licencës, datën e ri-licencimit, datën e skadimit të licencës, numrin e telefonit dhe adresën e emailit.
<i>Neni 17</i> Regjistrimi i firmave të auditimit 1. Sa i përket firmave të auditimit, regjistri publik		1. Ligji nuk përmban dispozita që specifikojnë se cilat informata duhet të përfshihen në regjistër. Excel-i në fjalë

duhet të përfshijë së paku këto informata: (a) emri, adresa dhe numri i regjistrimit; (b) formulari ligjor; (c) informatat kontaktuese, personi kontaktues primar dhe aty ku është e aplikueshme adresa e uebfaqes; (d) adresa e secilës zyrë në Shtetin Anëtar; (e) emri dhe numri i regjistrimit të të gjithë auditorëve statutor të punësuar ose të ndërlidhur si partnerë ose ndonjë formë tjetër me firmën e auditimit; (f) emrat dhe adresat e punës të të gjithë pronarëve dhe aksionarëve; (g) emrat dhe adresat e punës të të gjithë anëtarëve organit administrativ ose menaxhues; (h) nëse aplikohet, anëtarësimi në një rrjet dhe në listë të emrave dhe adresave të firmave anëtare dhe njësive degë ose indikacion rreth vendit ku informatat e tilla janë të dispozicion për publikun; (i) të gjitha regjistrimet tjera si firmë e auditimit me autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare tjera dhe si subjekt i auditimit në vendet e treta, përfshirë emrin(at) e autoriteteve regjistruese, dhe nëse aplikohet, numrat e regjistrimit. 2. Subjektet e auditimit të vendeve të treta të regjistruara në përputhje me nenin 45 duhet të shënohen qartë në regjistër si të tilla dhe jo si forma të auditimit.		që është në dispozicion për publikun përfshin emrin e auditorit, datën e lëshimit të licencës, datën e rilicencimit, datën e skadimit të licencës, numrin e telefonit dhe adresën e emailit. 2. Nuk ka dispozitë të tillë. Excel-i në fjalë që është në dispozicion për publikun përfshin kompanitë e huaja të auditimit si kompani të huaja me këto detaje: emrin e auditorit, datën e lëshimit të licencës, datën e rilicencimit, datën e skadimit të licencës, numrin e telefonit dhe adresën e emailit.
---	--	---

<i>Neni 18</i> Azhurnimi i informatave të regjistrimit Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që auditorët statutor dhe firmat e auditimit të njoftojnë autoritetet kompetente përgjegjëse për regjistrin publik pa vonesa të panevojshme rreth çdo ndryshimi të informatave të përfshira në regjistrin publik. Regjistri duhet të azhurnohet pa vonesa të panevojshme pas njoftimit.		Nuk ka dispozitë të tillë në Ligj.
<i>Neni 19</i> Përgjegjësia për informatat e regjistrimit Informatat e ofruara autoriteteve kompetente relevante në përputhje me nenet 16, 17 dhe 18 duhet të nënshkruhen nga auditori statutor ose firma e auditimit. Në rastet kur autoriteti kompetent parasheh që informatat duhet të jenë publike në mënyrë elektronike, kjo, për shembull, mund të bëhet përmes nënshkrimit elektronik siç është përcaktuar në pikën 1 të nenit 2 të Direktivës 1999/93/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 dhjetor 1999 mbi kornizën e Komunitetit për nënshkrim elektronik.		Nuk ka dispozitë të tillë në Ligj.
<i>Neni 20</i> Gjuha 1. Informatat e futura në regjistrin publik duhet të		Nuk ka dispozitë të tillë në Ligj.

hartohen në një prej gjuhëve të lejuara nga rregullat gjuhësore të aplikueshme në Shtetin Anëtar në fjalë. 2. Shtetet Anëtare mund të lejojnë edhe futjen e informatave në regjistrin publik në çdo gjuhë tjetër zyrtare të Komunitetit. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë certifikimin e informatave të përkthyer. Në të gjitha rastet, Shtetin Anëtar në fjalë duhet të sigurojë që regjistri të tregojë nëse përkthimi është i certifikuar apo jo.		
<i>Neni 21</i> Etika profesionale 1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të gjithë auditorët statutor dhe firmat e auditimit t'i nënshtrohen parimeve të etikës profesionale, që mbulojnë së paku funksionin e interesit publik të tyre, integritetin dhe objektivitetin e tyre si dhe aftësinë e tyre profesionale dhe kujdesin adekuat. 2. Për të siguruar besimin në funksionin e auditimit dhe për të siguruar aplikimin uniform të paragrafit 1 të këtij neni, Komisioni, në përputhje me procedurën e referuar në nenin 48(2), mund të miratojë masa zbatuese të bazuara në parime për të rregulluar etikën profesionale.	Neni 14 Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së 1. Funksionet e KKRF-së janë: 1.4. adoptimi i standardeve të etikës profesionale, kualitetit të brendshëm të firmave audituese; Neni 16 Raportimi i KKRF 1. KKRF-ja kërkon nga shoqatat e licencuara profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve që të prezantojnë këto dokumente: 1.1. një kopje të “Kodit të etikës”; Neni 22 Statusi i shoqatave	Përgjegjësitë e KFRC përfshijnë edhe përcaktimin e standardeve të etikës profesionale dhe cilësinë e brendshme që duhet ndjekur nga firmat e auditimit. Ligji kërkon auditorët e licencuar të jenë anëtarë të një asociacioni të pranuar të kontabilistëve. Kodi i Etikës i IFAC është i obligueshëm.

	1. Shoqata profesionale e kontabilitetit dhe auditimit, licençohet nga KKRF, me përmbushjen e këtyre kushteve: 1.1. KKRF-ja duhet të sigurohet se shoqata ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas këtij ligji si dhe ka plotësuar të gjitha standardet, udhëzimet dhe rekomandimet e lëshuara nga FNK-ja, për shoqatat anëtare të saj. 1.2. KKRF-ja duhet të sigurohet se anëtarët e çdo shoqate veprojnë në pajtueshmëri me kodin e sjelljes profesionale dhe me kodin e etikës së FNK-së.	
<i>Neni 22</i> Pavarësia dhe objektiviteti 1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që gjatë kryerjes së auditimit statutor, auditori statutor dhe/ose firmat e auditimit të jenë të pavarura nga subjekti që auditohet dhe nuk janë të përfshirë në vendimmarrje të subjektit që auditohet. 2. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që një auditor statutor ose një firmë e auditimit nuk duhet të kryejë në auditim statutor nëse ka çfarëdo marrëdhënie direkte ose indirekte financiare, e punës, e punësimit ose tjetër — përfshirë ofrimin shërbimeve shtesë të jo-auditimit – ndërmjet auditorit statutor, firmës ose rrjetit të auditimit dhe subjektit të audituar nga e	Neni 17 Raportimi i KKRF-së 3. KKRF-ja publikon deklarata me shkrim për politikën, aktet nënligjore që do të ndihmojnë në zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe të auditimit në Kosovë, standardeve profesionale dhe të edukimit, kërkesat për pavarësinë e auditorit, duke përfshirë këtu edhe rishikimet e jashtme për siguri të cilësisë dhe procedurat disiplinore.	Nuk ka referencë të drejtpërdrejtë për pavarësi dhe objektivitet në Ligj. Një prej përgjegjësive të KFRC është lëshimi i kërkesave me shkrim për pavarësinë e auditorëve. Kjo nuk është kompletuar deri më tani.

cila një palë e tretë objektive, e arsyeshme dhe e informuar do të konkludonte që pavarësia e auditorit statutor ose firmës së auditimit është e komprometuar. Nëse pavarësia e auditorit statutor ose firmës së auditimit është e ndikuar nga kërcënimet siç janë vetë-shqyrtimi, vetë-interesi, avokimi, njohja personale ose besimi ose frikësimi, auditori statutor ose firma e auditimit duhet të aplikojë masat mbrojtëse për të zbutur ato kërcënime. Nëse pesha e kërcënimeve në krahasim me masat e aplikuara është e tillë që pavarësia e tij/saj është e komprometuar, auditori statutor ose firma e auditimit nuk duhet të kryejë auditimin statutor. Veç kësaj, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që aty ku kemi të bëjmë me auditime statutore të subjekteve të interesit publik dhe ku aplikohen masat e ruajtjes së pavarësisë së auditorit statutor ose firmës së auditimit, atëherë auditori statutor ose firma e auditimit nuk duhet të kryejë auditimin statutor në rastet të vetë-shqyrtimit ose vetë-interesit. 3. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që dokumentet e auditorit statutor ose të firmës audituese në dokumentet e punës së auditimit të përfshijnë kërcënimet domethënëse ndaj pavarësisë së tij/saj dhe masat mbrojtëse që duhet aplikuar për të zbutur ato kërcënime. 4. Për të siguruar besimin në funksionin e auditimit dhe për të siguruar aplikimin uniform të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, Komisioni, në përputhje me procedurën e referuar në nenin 48(2)		
---	--	--

mund të miratojë masa zbatuese të bazuara në parime rreth: (a) kërcënimeve dhe masave mbrojtëse të referuara në paragrafin 2; (b) situatat në të cilat graviteti i kërcënimeve, të referuara në paragrafin 2, është i tillë që të komprometojë pavarësinë e auditorit statutor ose të firmës së auditimit; (c) rastet e vetë-shqyrtimit dhe vetë-interesit të referuara në nën-paragrafin e dytë të paragrafit 2 në të cilat auditimet statutorë mund të kryhen ose jo.		
<i>Neni 23</i> Konfidencialiteti dhe sekreti profesional 1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha informatat dhe dokumentet në të cilat ka qasje një auditor statutor ose një firmë e auditimit gjatë kryerjes auditimit statutor të jenë të mbrojtur me rregulla adekuate rreth konfidencialitetit dhe sekretit profesional. 2. Rregullat e konfidencialitetit dhe sekretit profesional që ndërlidhen me auditorët statutor ose firmat auditorë nuk duhet të pengojnë zbatimin e dispozitave të kësaj Direktive. 3. Në rastet kur një auditor statutor ose firmë e auditimit zëvendësohet nga një auditor statutor ose firmë e auditimit tjetër, ish auditori statutor ose firma e auditimit duhet t'i ofrojë auditorit statutor ose firmës së auditimit që merr përsipër qasje në të gjitha informatat relevante të	<i>Neni 18</i> Ruajtja e fshehtësisë së të dhënave 1. KKFR-ja dhe i gjithë personeli duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të mbrojnë nga përdorimet e paautorizuara dhe bërjen publike të të dhënave që atyre u janë dhënë me mirëbesim. 2. Në lidhje me paragrafin 1. të këtij neni bërja publike e të dhënave lejohet nëse: 2.1. është kërkuar me ligj në Kosovë; 2.2. bëhet me qëllim që t'i mundësojë një autoriteti apo një personi në një vend jashtë Kosovës, të kryej një funksion, detyrë që korrespondon me atë të KKRF-së; dhe	Nuk ka referenca të ngjashme për konfidencialitetin dhe sekretin profesional në Ligj. Nuk ka nen në Ligj që ndërlidhet me konfidencialitet por ndërlidhet vetëm me KFCR.

subjektit të audituar. 4. Një auditor statutor ose firmë e auditimit që përfundon angazhim në një detyrë të caktuar të auditimit dhe një ish auditor statutor ose një firmë e auditimit duhet t'i nënshtrohen dispozitave të paragrafët 1 dhe 2 në lidhje me atë detyrë të auditimit.	2.3. i bëhet një shoqate të licencuar profesionale të kontabilitetit dhe auditimit me qëllim të ushtrimit të funksioneve të saj.	
<i>Neni 24</i> Pavarësia dhe objektiviteti i auditorëve statutor që kryejnë auditim statutor në emër të firmave të auditimit Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që pronarët ose aksionarët e një firme të auditimit si dhe anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse të një firme të tillë ose të një firme degë, të mos intervenojnë në ekzekutimin e auditimit statutor në asnjë mënyrë që do të rrezikonte pavarësinë dhe objektivitetin e auditorit statutor që kryen auditimit statutor në emër të firmës së auditimit.		Nuk ka referencë në Ligj.
<i>Neni 25</i> Pagesat për auditim Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë vendosjen e rregullave adekuate të cilat parashohin që pagesat për auditime statutore 1. Të mos ndikohen ose përcaktohen nga ofrimi i shërbimeve shtesë për subjektin e audituar; 2. Nuk mund të bazohen në asnjë formë të		Nuk ka referencë në Ligj.

rastësisë (<i>contingency</i>)		
<i>Neni 26</i> Standardet e auditimit 1. Shtetet Anëtare duhet të kërkojnë nga auditorët statutor dhe firmat e auditimit të bëjnë auditimet statutore në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të miratuara nga Komisioni në përputhje me procedurën e referuar në nenin 48(2). Shtetet Anëtare mund të aplikojnë një standard kombëtar të auditimit nëse Komisioni nuk ka miratuar një standard ndërkombëtar të auditimit që mbulon po atë fushë/çështje. Standardet ndërkombëtare të auditimit të miratuara duhet të publikohen në tërësi në secilën prej gjuhëve zyrtare të Komunitetit në <i>Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian</i>. 2. Në përputhje me procedurën e referuar në nenin 48(2), Komisioni mund të vendos për zbatueshmërinë e standardeve ndërkombëtare të auditimit brenda Komunitetit. Komisioni duhet të miratojë standardet ndërkombëtare të auditimit për aplikim në Komunitet vetëm nëse ato: (a) janë zhvilluar përmes një procesi adekuat, transparencë dhe mbikëqyrje publike dhe janë të pranueshme ndërkombëtarisht në përgjithësi; (b) kontribuojnë në nivel të lartë të besueshmërisë dhe cilësisë për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara në përputhje me parimet e përcaktuara nga neni 2(3) i Direktivës 78/660/EEC dhe nga	Neni 5 Zbatimi i SNRF, SNK, SKK dhe SNA dhe kërkesave tjera për përgatitjen dhe auditimin e pasqyrave financiare 6. Të gjitha auditimet në Kosovë që përfshijnë të gjitha auditimet e kërkuara nga ky ligj, dhe auditimet e jashtme të pavarura të bizneseve të tjera për organizatat jo-fitimprurëse, organizatat tjera shoqërore apo publike dhe entitetet tjera të cilat janë të mandatuara me ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë, do të kryhen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe interpretimet relevante, udhëzimet dhe deklaratat e IAASB, dhe nga auditorët që janë të aprovuar për të kryer auditime nga autoritetet kompetente siç janë definuar nga ky ligj. 7. Autoriteti kompetent për miratimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të interpretimeve relevante, udhëzimeve dhe deklaratave të IAASB do të jetë KKRF. Neni 17 Raportimi i KKRF 6. Standardet e kontabilitetit dhe auditimit si dhe aktet nënligjore dhe dokumentet tjera të lëshuara nga KKRF-ja, do të publikohen në	Ligji kërkon që auditimi të bëhet në përputhje me ISA. Nuk ushtrohet opsioni i aplikimit të standardeve kombëtare të auditimit nëse nuk mbulohet nga ISA. <i>Ligji përshkruan publikimin e ISA në uebfaqe të KFRC.</i> Opsioni i lejuar në paragrafin 3 të nenit 26 të Direktivës nuk ushtrohet.

neni 16(3) i Direktivës 83/349/EEC; dhe (c) janë të favorshme për të mirë publike evropiane. 3. Shtetet Anëtare mund të imponojnë procedura ose kërkesa të auditimit si shtesë nga— ose në raste të jashtëzakonshme duke gdhendur pjesë të — standardet ndërkombëtare të auditimit vetëm nëse ato dalin nga kërkesat specifike të legjislacionit kombëtar të ndërlidhura me spektrin e auditimeve statutore. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që këto kërkesa dhe procedura të auditimit të jenë në përputhje me dispozitat e parapara në pikat (b) dhe (c) të paragrafit 2 dhe duhet t'i komunikojnë ato Komisionit dhe Shteteve Anëtare para miratimit të tyre. Në raste të jashtëzakonshme të gdhendjes së pjesëve të një standardi ndërkombëtar të auditimit, Shtetet Anëtare duhet të komunikojnë kërkesat e tyre specifike nga legjislacioni kombëtar si dhe arsyet për mbajtjen e tyre, te Komisioni dhe Shtetet Anëtare tjera së paku gjashtë muaj para miratimit të tyre kombëtar ose, në rast se kërkesat veç ekzistojnë në kohën e miratimit të një standardi ndërkombëtar i auditimit, më së voni brenda tre muajve nga miratimi i standardit relevant ndërkombëtar të auditimit. 4. Shtetet Anëtare mund të imponojnë kërkesa shtesë të ndërlidhura me auditimet statutore të llogarive vjetore dhe të konsoliduara për një periudhë që skadon me 29 qershor 2010.	faqen e internetit të KKRF-së, sipas Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve.	
--	--	--

<i>Neni 27</i> Auditimet statutore të llogarive të konsoliduara Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që në rast të auditimit statutor të llogarive të konsoliduara të një grupi të ndërmarrjeve: (a) auditori i grupit bart përgjegjësinë e plotë për raportin e auditimit në lidhje me llogaritë e konsoliduara; (b) auditori i grupit bën një shqyrtim dhe ruan dokumentet e shqyrtimit të tij/saj të punës së auditimit të kryer nga auditori(ët) e vendit të tretë, auditori(ët) statutor, subjektet e auditimit të vendit të tretë ose firma(t) e auditimit për qëllime të auditimit të grupit. Dokumentacioni i mbajtur nga auditori i grupit duhet të jetë i tillë që t'i mundësojë autoritetit kompetent relevant shqyrtimin e punës së auditorit të grupit në mënyrë adekuate; (c) në rastet kur një komponent e një grupi të ndërmarrjeve auditohet nga auditori(ët) ose subjekti(et) e auditimit nga një vend i tretë që nuk ka aranzhime punuese të referuara në nenin 47, auditori grupor është përgjegjës për të siguruar zbatimin adekuat, kur të kërkohet, para autoriteteve të mbikëqyrjes publike të dokumentacionit të punës së auditimit nga auditori(ët) ose subjekti(et) e auditimit të vendit të tretë, përshirë dokumentet e punës relevante për auditimin e grupit. Për të siguruar zbatimin e tillë, auditori i grupit duhet të ruajë një kopje të dokumentacionit të tillë ose si alternativë të merret vesh me auditorin(ët) ose subjektin(et) e auditimit nga vendi i tretë dhe	<i>Neni 11</i> Dorëzimi dhe publikimi i pasqyrave financiare 2. Pasqyrat financiare të konsoliduara që auditohen në pajtim me Standardet ndërkombëtare të auditimit dhe në pajtim me nenin 5 paragrafi 3 të këtij ligji, do të dorëzohen në KKRK dhe një kopje në MTI, jo më vonë se 30 qershor të vitit vijues.	Ligji nuk përmend të drejtat e auditorëve në lidhje me auditimin statutor të llogarive të konsoliduara por kërkon bërjen e tyre në përputhje me ISA.
---	---	---

qasjen adekuate dhe të pakufizuar, kur kjo të kërkohej, të ndërmerr çfarëdo veprimi tjetër adekuat. Nëse pengesat ligjore ose tjera e parandalojnë dorëzimin e dokumenteve të punës së auditimit nga një vend i tretë te auditori i grupit, dokumentacioni i ruajtur nga grupi duhet të përfshijë dëshmitë që ai/ajo ka ndjekur procedurat adekuate për të fituar qasje në dokumentacionin e auditimit dhe në rast të pengesave tjera, joligjore, që dalin nga legjislacioni i vendit, dëshmi që mbështesin pengesat e tilla.		
<i>Neni 28</i> Raportimi i auditimit 1. Kur në firmë e auditimit kryen një auditim statutor, raporti i auditimit duhet të nënshkruhet së paku nga auditori(ët) statutor që kryen auditimin statusor në emër të firmës së auditimit. Në raste të jashtëzakonshme, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë mos-zbulimin e nënshkrimit para publikut nëse zbulimi i tillë do të çonte në kërcënim të pashmangshëm dhe domethënës për sigurinë personale të cilido person. Sido që të jetë, emri(at) e personit(ave) të përfshirë duhet të bëhen të njohur te autoritetet kompetente relevante. 2. Pavarësisht nga neni 51a(1) i Direktivës 78/660/EEC, nëse Komisioni nuk ka miratuar një standard të përbashkët për raportet e auditimit në përputhje me nenin 26(1) të kësaj Direktive, mund, në përputhje me procedurën e referuar në nenin		Ligji nuk ka dispozitë në lidhje me raportimin e auditimit. Megjithatë, Ligji parasheh aplikimin e obligueshëm të ISA dhe ISA 700 që përmban formën dhe përmbajtjen e një raporti të auditimit. Ligji nuk përmban referencë për nënshkrimin e raportit të auditimit.

48(2) të kësaj Direktive, të miratojë një standard të përbashkët për raportet e auditimit për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara të cilat janë përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të miratuara me qëllime të zgjerimit të besimit publik në funksionin e auditimit.		
<i>Neni 29</i> Sistemet për sigurim të cilësisë 1. Secili Shtet Anëtar duhet të sigurojë që të gjithë auditorët statutor dhe firmat e auditimit t'i nënshtrohen një sistemi të sigurimit të cilësisë, që është në përputhje me, së paku, këto kritere, (a) sistemi i sigurimit të cilësisë duhet të organizohet në atë mënyrë që të jetë i pavarur nga auditorët statutor ose firmat e auditimit të shqyrtuara dhe t'i nënshtrohen mbikëqyrjes publike siç parashihet në Kapitullin VIII; (b) financimi për sistemin e sigurimit të cilësisë duhet të jetë i sigurt dhe të mos jetë në asnjë mënyrë i ndikuar nga auditorët statutor ose firmat e auditimit; (c) sistemi i sigurimit të cilësisë duhet të ketë resurset adekuate; (d) personat që bëjnë shqyrtimet e sigurimit të cilësisë duhet të kenë arsimim profesional adekuat dhe përvojë relevante për auditim statutor dhe raportim financiar të kombinuar me trajnim specifik për shqyrtim të sigurisë së cilësisë;	Neni 14 Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së 1. Funksionet e KKRF-së janë: 1.5. mbikëqyrë edukimin e vazhdueshëm, sigurimin e kualitetit dhe sistemit disiplinor; Neni 16 Mbikëqyrja e Shoqatave të kontabilistëve dhe auditorëve 1. KKRF-ja kërkon nga shoqatat e licencuara profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve që të prezantojnë këto dokumente: 1.2. raport të shoqatës që tregon programin për sigurimin e cilësisë; 1.3. raportin në lidhje me rezultatet e hetimeve të shoqatës duke përfshirë edhe procedurat disiplinore dhe 1.4. raport se si programi për kualitetin e	Ligji nuk parasheh drejtpërsëdrejti kërkesat që duhet përmbushur për sigurim të cilësisë. KFRC është formalisht përgjegjëse për sigurim të cilësisë dhe kërkon nga asociacioni profesional të përcaktojë dhe të raportojë rreth asaj se si një program i SC përmbush kërkesat e direktivës për auditim statutor të Bashkimit Evropian.

(e) përzgjedhja e shqyrtuesve për detyra specifike të shqyrtimit të sigurimit të cilësisë duhet të bëhet në përputhje me një procedurë objektive të dizajnuar për të siguruar që të mos ketë konflikt të interesit ndërmjet shqyrtuesve dhe auditorit statutor ose firmës së auditimit që i nënshtrohet shqyrtimit; (f) spektri i shqyrtimit të sigurimit të cilësisë, mbështetur nga testimi adekuat i dosjeve të përzgjedhura për auditim, duhet të përfshijë një vlerësim të përputhshmërisë me standardet e aplikueshme të auditimit dhe kërkesat për pavarësi, kuantitetin dhe kualitetin e resurseve të shpenzuara, pagesave të auditimit të ngarkuara dhe sistemin e brendshëm të kontrollit të cilësisë për firmën e audituar; (g) shqyrtimi i sigurimit të cilësisë duhet t'i nënshtrohet një raporti i cili duhet të përmbajë konkluzionet kryesore të shqyrtimit të sigurimit të cilësisë; (h) shqyrtimet e sigurimit të cilësisë duhet të bëhen së paku çdo gjashtë vite; (i) rezultatet e përgjithshme të sistemit për sigurim të cilësisë duhet të publikohen çdo vit; (j) rekomandimet e shqyrtimit të cilësisë duhet të zbatohen nga auditori statutor ose firma e auditimit brenda një periudhe të arsyeshme. Nëse rekomandimet e referuara në pikën (j) nuk zbatohen, atëherë auditori statutor ose firma e auditimit duhet t'i nënshtrohet sistemit të masave disiplinore ose ndëshkimeve të referuara në nenin 30.	shoqatës i plotëson kërkesat e direktivave të auditimit të Bashkimit Evropian.	
--	---	--

2. Në përputhje me procedurën e referuara në nenin 48(2), Komisioni mund të miratojë masat zbatuese për të ngritur besimin e publikut në funksionin e auditimit dhe për të siguruar zbatimin uniform të pikave (a), (b) dhe (e) deri në (j) të paragrafit 1.		
<i>Neni 30</i> Sistemet e hetimeve dhe ndëshkimet 1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të vendosin sistem efektive të hetimit dhe ndëshkimeve për të detektuar, korrigjuar dhe parandaluar ekzekutimin jo-adekuat të auditimit statutor. 2. Pa paragjykuar regjimet e përgjegjësisë civile të Shteteve Anëtare, ato mund të parashohin ndëshkime efektive, proporcionale zbindëse për të respektuar auditorët statutor dhe firmat e auditimit, aty ku auditimet statutor nuk janë kryer në përputhje me dispozitat e miratuara për zbatim të kësaj Direktive. 3. Shtetet Anëtare duhet të parashohin që masat dhe ndëshkimet e ndërmarra dhe të imponuara mbi auditorët statutor dhe firmat e auditimit të zbulohen në mënyrë adekuate para publikut. Ndëshkimet duhet të përfshijnë mundësinë e revokimit të licencës.	Neni 14 Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së 1. Funksionet e KKRF-së janë: 1.5. mbikëqyrë edukimin e vazhdueshëm, sigurimin e kualitetit dhe sistemit disiplinor; Neni 15 Komisionet e KKRF-së 1. KKRF-ja do të caktojë komisione sipas nevojës për të siguruar zbatimin e standardeve ndërkombëtare përkatëse të BE-së “<i>Acquis Communautaire</i>” duke përfshirë direktivat nr. 78/660/EEC, nr. 83/349/EEC dhe nr. 84/253/EEC të BE-së. 2.4. hetime dhe disiplinë; Neni 16 Mbikëqyrja e Shoqatave të kontabilistëve dhe auditorëve 1. KKRF-ja kërkon nga shoqatat e licencuara profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve	Ligji nuk përmban dispozita për aplikim të ndëshkimeve ndaj ekzekutimit joadekuat të auditimeve statutor. Nuk ka dispozitë që licenca mund të revokohet në rast të shkeljes së kërkesave për pavarësi, etikë dhe sigurim të cilësisë. Nuk ka dispozita për zbulim publik të këtyre masave të ndërmarra kundër auditorëve për punë të dobët.

	që të prezantojnë këto dokumente: 1.3. raportin në lidhje me rezultatet e hetimeve të shoqatës duke përfshirë edhe procedurat disiplinore Neni 17 Raportimi i KKRF 3. KKRF-ja publikon deklarata me shkrim për politikën, aktet nënligjore që do të ndihmojnë në zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe të auditimit në Kosovë, standardeve profesionale dhe të edukimit, kërkesat për pavarësinë e auditorit, duke përfshirë këtu edhe rishikimet e jashtme për siguri të cilësisë dhe procedurat disiplinore. Neni 21 Kushtet 8. KKRF-ja do të revokojë licencën e një firme të huaj ose vendore të auditimit, ose auditorit i cili është i licencuar në pajtueshmëri me këtë ligj në çdo kohë, nëse firma e auditimit ose auditori nuk do të jetë më anëtar i një shoqate të licencuar profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, ose e shkel pavarësinë e auditorit, etikën dhe kërkesat për sigurimin e cilësisë të përcaktuara nga KKRF-ja.	
--	--	--

<i>Neni 32</i> Parimet e mbikëqyrjes publike 1. Shtetet Anëtare duhet të vendosin një sistem efektiv të mbikëqyrjes publike për auditorët statutor dhe firmat e auditimit në bazë të parimeve të përcaktuara në paragrafët 2 deri në 7. 2. Të gjithë auditorët statutor dhe firmat e auditimit duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes publike. 3. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të qeveriset nga jo-praktikuesit të cilët janë njohuri në fushat relevante për auditim statutor. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të lejojnë një numër të vogël të praktikuesve të angazhohen në qeverisjen e sistemit të mbikëqyrjes publike. Personat e angazhuar në qeverisjen e sistemit të mbikëqyrjes publike duhet të përzgjidhen në bazë të një procedure transparente dhe të pavarur të nominimit. 4. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të ketë përgjegjësinë finale për mbikëqyrjen e: (a) certifikimit dhe regjistrimit të auditorëve statutor dhe firmave të auditimit; (b) miratimit e standardeve të etikës profesionale, kontrollin e brendshëm të cilësisë të firmave të auditimit, dhe të vetë auditimit; dhe (c) arsimimit të vazhdueshëm, sigurimit të cilësisë dhe sistemeve hetuese dhe disiplinore. 5. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të ketë të drejtën, nëse është e domosdoshme, për të bërë hetime në lidhje me auditorët statutor dhe firmat e auditimit dhe të drejtën për të ndërmarrë veprime adekuate.	Neni 13 Përbërja 1. KKRF-ja është organ i pavarur profesional, siç përcaktohet me dispozitat e këtij ligji. 2. KKRF-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë. Kryesuesi dhe anëtarët e tjerë të KKRF-së me propozim të institucionit emërohen nga Qeveria, të cilët do të përfaqësojnë institucionin si në vijim: 2.1. një (1) anëtar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës; 2.2. një (1) anëtar nga universitetet që ofrojnë arsimim superior universitar me lëndë mësimore në kontabilitet dhe auditim; 2.3. një (1) anëtar nga Ministria e Financave; 2.4. një (1) anëtar nga shoqatat profesionale e licencuar nga KKRF-ja; 2.5. tre (3) anëtarë nga komuniteti i biznesit, që kanë njohuri dhe përvojë në financa dhe administrim biznesi; 3. Kryesuesi i KKRF-së e as anëtarët nuk duhet të mbajnë funksione publike dhe të jenë të emëruar politik. 4. Anëtarët e KKRF-së do të emërohen për një periudhë tri (3) vjeçare, me të drejtë të riemërimit por nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate. 5. Personat e emëruar në KKRF duhet t'i plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme të	Ligji parasheh që KFRC të jetë përgjegjëse për mbikëqyrjen publike. Ligji nuk tregon qartë që sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të qeveriset nga jo-praktikuesit. (për shembull një profesor universiteti mund të jetë edhe praktikues i auditimit). Direktiva kërkon që anëtarët e sistemit të mbikëqyrjes publike të kenë njohuri në fushat relevante për auditim statutor. Ligji kërkon që anëtarët e KFRC të posedojnë shkallë universitare në kontabilitet, financa, administrim biznesi ose juridik dhe së paku tetë (8) vite përvojë të punës në fushën e kontabilitetit, financave dhe auditimit. (Si përshtatet diploma nga juridiku me këto kërkesa, posaçërisht tani kur Ligji kërkon diplomë në kontabilitet, financa dhe administrim biznesi për të hyrë në këtë profesion)? Tre nga katër anëtarët e Këshillit janë anëtar të komunitetit të biznesit që janë të njohur me financat dhe administrimin e biznesit por pyetja qëndron se si do ta përmbushin ata kërkesën e përvojës së punës 8 vjeçare në kontabilitet, financa dhe auditim. Ligji nuk përmban referencë për opsionin e praktikuesve në sistem.
--	--	--

6. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të jetë transparent. Kjo duhet të përfshijë publikimin e programeve vjetore të punës dhe raporteve të aktiviteteve. 7. Sistemi i mbikëqyrjes publike duhet të financohet në mënyrë adekuate. Financimi për sistemin e mbikëqyrjes publike duhet të jetë i sigurt dhe pa kurrfarë ndikimi nga auditorët statutor ose nga firmat e auditimit.	kualifikimit: 5.1. të kenë diplomë universitare në kontabilitet, financa, administrim të biznesit ose në juridik; 5.2. së paku tetë (8) vjet përvojë në fushën e kontabilitetit, financave dhe auditimit; 5.3. reputacion të mirë dhe aftësi profesionale përkatëse; 6. Qeveria me propozim të institucioneve sipas paragrafit 2. të këtij neni mund të shkarkojë Kryesuesin dhe anëtarët e KKRF-së për: 6.1. shkelje të rëndë të ligjit apo humbje të aftësisë së punës; 6.2. kur me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar për vepër penale më shumë se gjashtë (6) muaj; 6.3. administrim ligjor, falimentim apo likuidim të detyrueshëm nga gjyqi apo autoriteti kompetent të cilësdo kompani që është në pronësi apo kontrollohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ky anëtar; 6.4. nëse është në lidhje martesore apo lidhje familjare deri në shkallën e dytë me një (1) anëtar tjetër apo zyrtar të KKRF-së; 7. Kryesuesi apo anëtari i KKRF-së, dorëheqjen me shkrim ia afron Qeverisë për procedurë të mëtejme. 8. Në rast pushimi nga puna, në rast vdekje apo dorëheqje nga KKRF-ja, Qeveria duhet	Ligji nuk përmban referencë që KKRF duhet të ketë të drejtën, nëse është e domosdoshme, për të bërë hetime në lidhje me auditorët statutor dhe firmat e auditimit dhe të drejtën për të ndërmarrë veprime adekuate. Ligji kërkon që KKRF të publikojë raportin vjetor të punës ndërsa raportet e aktivitetit i dërgohen vetëm Qeverisë pa kërkesë për publikim. KKRF financohet nga buxheti i Kosovës, të hyrat vetanake si dhe nga donacionet. Kjo mund të hap derën për auditorët statutor ose firmat e auditimit pasi që donacionet mund të vijnë nga ata. "Të hyrat vetanake" deri më sot ende nuk janë interpretuar, d.m.th a mund KKRF të caktojë detyrime financiare për firmat dhe auditorët të cilët i rregullon apo jo?
--	--	---

	të emërojë një anëtar të ri jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë. Anëtari i emëruar si më sipër do të shërbejë për periudhën e mbetur në vend të anëtarit që ka zëvendësuar dhe mund të rizgjidhet. 9. Mbledhjet e KKRF-së mbahen vetëm nëse janë të pranishëm, së paku pesë (5) anëtarë. Këshilli do të marrë vendim nëse votojnë shumica e thjeshtë e anëtarëve që janë të pranishëm. Në rast të votave të barabarta, vota e Kryesuesit të këshillit është vendimtare. 10. KKRF-ja mblidhet sipas nevojës. 11. KKRF-ja do të mbështetet nga një numër i mjaftueshëm i personelit për ushtrimin e funksionit të tij siç është specifikuar në paragrafin 3. të nenit 14 dhe nenin 15 të këtij ligji. 12. Çdo anëtar i KKRF-së merr një honorar për mbledhjet e mbajtura dhe do t'i kompensohen shpenzimet e arsyeshme të cilat janë krijuar si rezultat i takimeve ose punëve të KKRF-së. Procedura e kompensimit përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri. 13. KKRF-ja financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, të hyrat vetanake dhe donacionet. 14. KKRF-ja për punën e vet nxjerr rregulloren e punës.	
--	--	--

	Neni 14 Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së 1. Funksionet e KKRF-së janë: 1.1. të hartojë dhe aprovojë Standardet e Kontabilitetit të Kosovës në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit SNK/SNRF dhe direktivat relevante të BE-së; 1.2. mbikëqyrë dhe zbaton standardet e auditimit në përputhje me SNA dhe direktivat relevante të BE-së; 1.3. licencimi dhe mbajtja e regjistrit të auditorëve dhe firmave audituese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit; 1.4. adoptimi i standardeve të etikës profesionale, kualitetit të brendshëm të firmave audituese; 1.5. mbikëqyrë edukimin e vazhdueshëm, sigurimin e kualitetit dhe sistemit disiplinor; 2. KKRF-ja nostrifikon certifikatat ndërkombëtare të auditorëve dhe kontabilistëve. 4. Për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi të veta sipas këtij Ligji, Këshilli mbështetet nga një sekretari administrative (në tekstin vijues “Sekretaria”) e përbërë prej udhëheqësit dhe nëpunësve të tjerë administrativ. 5. Udhëheqësi dhe nëpunësit e Sekretarisë	
--	--	--

	zgjidhen dhe shkarkohen sipas Ligjit për shërbimin civil. 6. Obligohet KKRF-ja që të prezantoj pasqyrat financiare për Shoqëritë tregtare nëse një gjë e tillë kërkohet nga Administrata Tatimore e Kosovës. Neni 16 Mbikëqyrja e Shoqatave të kontabilistëve dhe auditorëve 1. KKRF-ja kërkon nga shoqatat e licencuara profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve që të prezantojnë këto dokumente: 1.1. një kopje të “Kodit të etikës”; 1.2. raport të shoqatës që tregon programin për sigurimin e cilësisë; 1.3. raportin në lidhje me rezultatet e hetimeve të shoqatës duke përfshirë edhe procedurat disiplinore dhe 1.4. raport se si programi për kualitetin e shoqatës i plotëson kërkesat e direktivave të auditimit të Bashkimit Evropian. Neni 17 Raportimi i KKRF-së 1. KKRF-ja pas 31 dhjetorit të çdo viti dhe deri më 30 qershor, duhet që t’i dorëzojë Qeverisë raport për: 1.1. punët e KKRF-së dhe të komisioneve të	
--	---	--

	tij; 1.2. arritjet e objektivave të caktuara për vitin fiskal që ka përfunduar; 2. KKRF publikon raportin vjetor të punës. 3. KKRF-ja publikon deklarata me shkrim për politikat, aktet nënligjore që do të ndihmojnë në zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe të auditimit në Kosovë, standardeve profesionale dhe të edukimit, kërkesat për pavarësinë e auditorit, duke përfshirë këtu edhe rishikimet e jashtme për siguri të cilësisë dhe procedurat disiplinore. 4. KKRF-ja publikon udhëzues shoqërive tregtare për të zbatuar standarde të caktuara (SNK/SNRF), të përshtatshme për shoqëritë tregtare. 5. Standardet, politikat dhe aktet nënligjore tashmë të lëshuara nga Bordi Kosovar mbi Standardet për Raportim Financiar, do të jenë në fuqi derisa të ndryshohen nga KKRF-ja. 6. Standardet e kontabilitetit dhe auditimit si dhe aktet nënligjore dhe dokumentet tjera të lëshuara nga KKRF-ja, do të publikohen në faqen e internetit të KKRF-së, sipas Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve. 7. KKRF-ja mbanë regjistrin publik të të gjithë auditorëve dhe firmave të auditimit.	
--	---	--

<i>Neni 33</i> Bashkëpunimi ndërmjet sistemeve të mbikëqyrjes publike në nivel të Komunitetit Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që aranzhimet rregullative për sistemet e mbikëqyrjes publike lejojnë bashkëpunimin efektiv në nivel të Komunitetit në lidhje me aktivitetet mbikëqyrëse të Shtetit Anëtar. Në këtë drejtim, secili Shtet Anëtar duhet të caktojë një subjekt në mënyrë specifike si përgjegjëse për të siguruar atë bashkëpunim.		Nuk ka referencë në Ligj.
<i>Neni 34</i> Njohja reciproke e aranzhimeve rregullative ndërmjet Shteteve Anëtare 1. Aranzhimet rregullative të Shteteve Anëtare duhet të respektojnë parimet e rregullimit dhe mbikëqyrjes së vendit në fjalë nga Shteti Anëtar në të cilin auditori statutor ose firma e auditimit është certifikuar dhe subjekti i audituar ka zyrën e vet të regjistruar. 2. Në rast të auditimit statutor të llogarive të konsoliduara, Shteti Anëtar që kërkon auditim statutor të llogarive të konsoliduara nuk mund të imponojë kërkesa shtesë në lidhje me auditimin statutor rreth regjistrimit, shqyrtimit të sigurimit të cilësisë, standardeve të auditimit, etikës profesionale dhe pavarësisë së një auditori statutor ose firme të auditimit që kryen auditimin statutor të subsidiaritetit të themeluar në një Shtet Anëtar tjetër.		Nuk ka referencë në këtë Ligj.

3. Në rast se kompania, letrat me vlerë të së cilës tregtohen në treg të rregulluar në një Shtet Anëtar tjetër prej atij në të cilin kompania ka zyrën e regjistruar, Shteti Anëtar në të cilin tregtohen letrat me vlerë nuk mund të imponojë kërkesa shtesë në lidhje me auditimit statutor rreth regjistrimit, shqyrtimit të sigurimit të cilësisë, standardeve të auditimit, etikës profesionale dhe pavarësisë së një auditori statutor ose firme të auditimit që kryen auditimin statutor të llogarive vjetore ose të konsoliduara të asaj kompanie.		
<i>Neni 35</i> Emërimi i autoriteteve kompetente 1. Shtetet Anëtare duhet të emërojnë një ose më shumë autoritete kompetente për qëllimet e detyrave të parapara në këtë Direktivë. Shtetet Anëtare duhet të informojë Komisionin për emërimin e tyre. 2. Autoritetet kompetente duhet të organizohen në atë mënyrë që të shmanget konflikti i interesit.		KFRC është autoriteti kompetent për qëllimet e detyrave të parapara me Ligj. Anëtarët e Këshillit nuk mund të mbajnë pozitë publike e as të jenë të emëruar politik.
<i>Neni 36</i> Sekreti profesional dhe bashkëpunimi rregullativ ndërmjet Shteteve Anëtare Autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare përgjegjëse për certifikim, regjistrim, sigurim të		Nuk ka referencë për sekretin profesional dhe bashkëpunimin rregullativ ndërmjet Shteteve Anëtare.

cilësisë, inspektim dhe disiplinë duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin sa herë të jetë e nevojshme me qëllim të kryerjes së përgjegjësisë përkatëse të tyre sipas kësaj Direktive. Autoritetet kompetente në një Shtet Anëtar përgjegjëse për miratim, regjistrim, sigurim të cilësisë, inspektim dhe disiplinë duhet të kërkojnë ndihmë nga autoritetet kompetente në Shtetet Anëtare tjera. Në veçanti, autoritetet kompetente duhet të shkëmbejnë informatat dhe të bashkëpunojnë në hetime të ndërlidhura me kryerjen e auditimeve statutore. 2. Obligimi i sekretit profesional duhet të vlejë për të gjithë personat e punësuar ose që kanë qenë të punësuar nga autoritetet kompetente. Informatat e mbuluara nga sekreti profesional nuk duhet t'i zbulohen asnjë personi ose autoriteti tjetër përveç siç kërkohet me procedurat ligjore, rregullative dhe administrative të një Shteti Anëtar. 3. Paragrafi 2 nuk duhet të parandalojë autoritetet kompetente nga shkëmbimi i informatave konfidenciale. Prandaj, informatat e shkëmbyera duhet të mbulohen nga obligimi i sekretit profesional të cilës i nënshtrohen personat e punësuar ose ish të punësuar nga autoritetet kompetente. 4. Pas kërkesës dhe pa vonesa të paarsyeshme, autoritetet kompetente duhet të përcjellin çdo informatë të kërkuar për qëllimet e referuara në paragrafin 1. Nëse është e domosdoshme, autoritetet kompetente që pranojnë një kërkesë të		
---	--	--

tillë duhet të ndërmarrin masat e domosdoshme, pa vonesa të paarsyeshme, për të mbledhur informatat e kërkuara. Informatat e shkëmbyera duhet të mbulohen nga obligimi i sekretit profesional të cilës i nënshtrohen personat e punësuar ose ish të punësuar nga autoritetet kompetente. Nëse autoriteti kompetent i kërkuar nuk është në gjendje të përcjellë informatat e kërkuara pa vonesa të paarsyeshme, atëherë duhet të informojë autoritetin kompetent kërkuar për arsyet në fjalë. Autoritetet kompetente mund të refuzojnë të përgjigjen në kërkesën për informata në rastet kur: (a) dorëzimi i informatave mund të efekt të kundërt në sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Shtetit Anëtar të kërkuar ose shkelë rregullat e sigurisë kombëtare; ose (b) janë iniciuar procedurat ligjore në lidhje me veprimet e njëjta dhe kundër auditorëve statutor ose firmave të auditimit të njëjta para autoriteteve të Shtetit Anëtar të kërkuar; ose kur është marrë aktvendimi në lidhje me veprimet e njëjta dhe kundër auditorëve statutor ose firmave të auditimit të njëjta nga autoritetet e Shtetit Anëtar të kërkuar. Pa paragjykuar obligimet të cilave duhet t’iu nënshtrohen në procedurat gjyqësore, autoritetet kompetente të cilat pranojnë informata sipas paragrafit 1 mund t’i përdorin ato vetëm për ushtrim të funksioneve të tyre brenda spektrit të kësaj Direktive dhe në kontekstin e procedurave administrative ose gjyqësore që lidhen në mënyrë specifike me ushtrimin e atyre funksioneve.		
--	--	--

5. Në rastet kur një autoritet kompetent konstaton se janë duke u bërë, ose janë bërë, aktivitete në kundërshtim me dispozitat e kësaj Direktive brenda territorit të një Shteti Anëtar tjetër, atëherë autoriteti në fjalë duhet të informojë autoritetin kompetent të Shtetit Anëtar tjetër rreth atij konstatimi në mënyrë sa më specifike që është e mundur. Autoriteti kompetent i Shtetit Anëtar tjetër duhet të ndërmerr veprime adekuate. Duhet të informojë autoritetin kompetent informues rreth rezultatit dhe, aq sa është e mundur, për zhvillimet e rëndësishme të ndërmjetme. 6. Autoriteti kompetent i një Shteti Anëtar mund të kërkojë që të bëhet një hetim nga autoriteti kompetent i një Shteti Anëtar tjetër në territorin e kësaj të fundit. Më tutje, mund të kërkojë që disa nga stafi i vet të shoqërojnë stafin e autoritetit kompetent të Shtetit Anëtar tjetër gjatë hetimeve. Hetimi, nga fillimi deri në fund, duhet t'i nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm të Shtetit Anëtar në territorin e së cilës kryhet hetimi. Autoritetet kompetente mund të refuzojnë të veprojnë pas kërkesës për hetim siç është paraparë në nën-paragrafin e parë ose me kërkesë për shoqërim të stafit nga personi i autoritetit kompetent të një Shteti Anëtar tjetër siç parashihet në nën-paragrafin e dytë në rastet kur: (a) dorëzimi i informatave mund të efekt të kundërt në sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Shtetit Anëtar të kërkuar ose shkelë rregullat e sigurisë kombëtare; ose		
--	--	--

(b) janë iniciuar procedurat ligjore në lidhje me veprimet e njëjta dhe kundër personave të njëjtë para autoriteteve të Shtetit Anëtar të kërkuar; ose kur është marrë aktvendimi në lidhje me veprimet e njëjta mbi personat e tillë nga autoritetet e Shtetit Anëtar të kërkuar. 7. Komisioni mund të miratojë masat zbatuese me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente rreth procedurave për shkëmbim të informatave dhe modaliteteve për hetimet ndër-kufitare të parapara në paragrafët 2 deri në 4 të këtij neni. Ato masa, të dizajnuara për të ndryshuar elementet jo-esenciale të kësaj Direktive, përmes plotësimit të saj, duhet të miratohen në përputhje me procedurën rregullative me rishikimin e referuar në nenin 48(2a).		
<i>Neni 37</i> Emërimi i auditorëve statutor ose firmave të auditimit 1. Auditori statutor ose firma e auditimit duhet të emërohet nga takimi i përgjithshëm i aksionarëve ose nga anëtarët e subjektit të audituar. 2. Shtetet Anëtare mund të lejojnë sisteme alternative ose modalitete për emërimin e auditorit statutor ose firmës së auditimit me kusht që ato sisteme ose modalitete të jenë të dizajnuara për të siguruar pavarësinë e auditorit statutor ose firmës së auditimit nga anëtarët ekzekutiv të organit administrative ose të organit menaxhues të subjektit të audituar.		Ligji nuk përmban referencë të kësaj dispozite. Ligji mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare kërkon që auditorët e jashtëm të bankave të emërohen nga takimi i përgjithshëm i aksionarëve. Ligji për Shoqëritë Tregtare kërkon që aksionarët e kompanive aksionare të miratojnë auditorët.

<i>Neni 38</i> Shkarkimi dhe dorëheqja e auditorëve statutor ose firmave të auditimit 1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që auditorët statutor ose firmat e auditimit mund të shkarkohen vetëm me arsyetime adekuate. Dallimi në opinione rreth trajtimeve të kontabilitetit ose procedurave të auditimit nuk përbën arsyetim adekuat për shkarkim. 2. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që subjekti i audituar dhe auditori statutor ose firma e audituar të informojë autoritetin(et) përgjegjëse për mbikëqyrje publike rreth shkarkimit ose dorëheqjes së auditorit statutor ose firmës së auditimit gjatë kohëzgjatjes së emërimit dhe të japin shpjegime adekuate për arsyet në fjalë.		Nuk ka referencë në Ligj.
<i>Neni 39</i> Zbatimi mbi subjektet e interesit publik të që nuk janë të listuara Shtetet Anëtare mund të lirojnë subjektet e interesit publik, të cilat nuk kanë lëshuar letra me vlerë të transferueshme për tregti në një treg të rregulluar brenda kuptimit të pikës 14 të nenit 4(1) të Direktivës 2004/39/EC dhe auditorin(ët) statutor ose firmën(at) e auditimit nga një ose më shumë kërkesa të këtij Kapitulli.		N/A

<i>Neni 40</i> Raporti i transparencës 1. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që auditorët statutor dhe firmat e auditimit që kryejnë auditime statutorë të subjekteve të interesit publik të publikojnë në uebfaqet e tyre brenda tre muajve nga fundi i çdo viti financiar, raportet vjetore të transparencës që përfshijnë së paku këto në vijim: a) Përshkrimin e strukturës ligjore dhe pronësinë b) Në rastet kur firma e auditimit i takon një rrjeti, përshkrimin e rrjetit dhe të aranzhimeve ligjore dhe strukturale të rrjetit c) Përshkrimin e strukturës së qeverisjes së firmës së auditimit d) Përshkrimin e sistemit të brendshëm të kontrollit të cilësisë të firmës së auditimit dhe një deklaratë nga organi administrativ ose menaxhues për efektivitetin e funksionimit të saj e) Informatën se ku është bërë shqyrtimi i fundit i sigurimit të cilësisë të referuar në nenin 29 f) Një listë të subjekteve të interesit publik për të cilat firma e auditimit ka kryer auditime statutorë gjatë vitit financiar paraprak g) Një deklaratë rreth praktikave të pavarura të firmës së auditimit që po ashtu konfirmon se është bërë një shqyrtim i brendshëm i përputhshmërisë së pavarësisë h) Një deklaratë rreth politikës të ndjekur nga firma e auditimit rreth arsimimit të		Nuk ka referencë në Ligj.
--	--	----------------------------------

vazhdueshëm të auditorëve statutor të referuar në nenin 13 i) Informatat financiare që tregojnë rëndësinë e firmës së auditimit siç është qarkullimi vjetor total i zbërthyer në pagesa nga auditimi statutor i llogarive vjetore dhe të konsoliduara dhe pagesat e ngarkuara për shërbime të tjera të sigurimit, shërbimeve këshillëdhënëse tatimore dhe shërbimeve tjera që nuk kanë të bëjnë me auditim j) Informatat rreth bazës për pagesë të partnerëve Në raste të jashtëzakonshme, Shtetet Anëtare mund të mos aplikojnë kërkesën nën pikën (f) deri në atë masë sa është e domosdoshme për të zbutur një kërcënim serioz për sigurinë personale të cilido person. 2. Raporti i transparencës duhet të nënshkruhet nga auditori statutor ose firma e auditimit varësisht nga rasti. Për shembull kjo mund të bëhet përmes nënshkrimit elektronik të përcaktuar në nenin 2(1) të Direktivës 1999/93/EC		
<i>Neni 41</i> Komisioni i auditimit 1. çdo subjekt i interesit publik duhet të ketë një komision të auditimit. Shteti Anëtar duhet të përcaktojë nëse komisionet e auditimit duhet të përbëhen nga anëtarë jo-ekzekutiv të organit administrativ dhe/ose anëtarëve të organit mbikëqyrës të subjektit të	Neni 181 (Kompania Aksionare) Komisionet e Bordit Statuti ose rregulloret mund të përcaktojnë, ose drejtorët mund të miratojnë një vendim që themelon një ose më shumë komisione, (komisioni për auditim ose për shqyrtimin e kompensimeve) që do të shqyrtojë, hulumtojë, rekomandojë ose të marrë masa	Nuk ka referencë në Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim. Ligji për Shoqëritë Tregtare parasheh një opsion që kompanitë aksionare të kenë një komision (jo të obligueshëm) të auditimit. Nuk ka kërkesë që së paku

audituar dhe/ose anëtarëve të emëruar nga takimi i përgjithshëm i aksionarëve të subjektit të audituar. Së paku një anëtar i komisionit të auditimit duhet të jetë i pavarur dhe duhet të ketë aftësi në kontabilitet dhe/ose auditim. Në subjektet e interesit publik të cilat përmbushin kriteret e parapara nga neni 2(1), pika (f) e Direktivës 2003/71/EC (1), Shtetet Anëtare mund të lejojnë që funksionet e caktuara për komisionin e auditimit të kryhen nga një organ administrativ ose mbikëqyrës në tërësi me kusht që kur kryesuesi i një organi të tillë është një anëtar ekzekutiv ose ai/ajo nuk është kryesues i komisionit të auditimit. 2. Pa paragjykuar përgjegjësinë e anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse ose të anëtarëve tjerë që janë të emëruar nga takimi i përgjithshëm i aksionarëve të subjektit të audituar, komisioni i auditimit, ndërmjet tjera, duhet të: (a) monitorojë procesin e raportimit financiarë (b) monitorojë efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të kompanisë, auditimin e brendshëm aty ku aplikohet dhe menaxhimit të rrezikut (c) monitorojë auditimit statutor të llogarive vjetore dhe të konsoliduara (d) shqyrtojë dhe monitorojë pavarësinë e auditorit statutor ose firmës së auditimit dhe në veçanti ofrimin e shërbimeve shtesë për subjektin e audituar. 3. Në subjekt të interesit publik, propozimi i organit administrativ ose mbikëqyrës për emërimin e	të tjera jo-detyruese e që janë në kuadër të kompetencës së bordit. Këto komisione mund të përfshijnë edhe anëtarët e bordit të drejtorëve dhe punëtorët e shoqërisë si dhe persona jashtë kompanisë.	një prej anëtarëve të komisionit të jetë i pavarur dhe të ketë aftësi në kontabilitet dhe në auditim. Nuk ka referenca për detyrat e komisionit. Ligji mbi bankat, institucionet mikrofinanciar dhe institucionet financiare jobankare kërkon që bordet e drejtorëve të bankave të themelojnë një komision të auditimit, anëtarët e të cilit përzgjidhen nga drejtorët jo-ekzekutiv dhe ekspertët e jashtëm. Shumica e anëtarëve të komisionit të auditimit duhet të jenë drejtorë jo-ekzekutiv. Së paku një prej anëtarëve të komisionit për auditim duhet të jetë ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit që plotëson kriteret e pavarësisë së drejtorëve në nenin 26, paragrafi 3 të këtij Ligji. Komisioni i Auditimit duhet të: 1.1. të takohet së paku çdo tre muaj dhe në periudha tjera të parapara me akte nënligjore; 1.2. të rekomandojë kontabilitetin e përshtatshëm, kontrollet e brendshme operative dhe administrative; 1.3. të mbikëqyrë pajtueshmërinë e bankës me politikat dhe procedurat; 1.4. të kërkojë dhe rishikojë raportet e krye auditorit të brendshëm të bankës;
---	---	---

auditorit statutor ose të firmës së auditimit duhet të bazohet në një rekomandim të bërë nga komisioni i auditimit. 4. Auditori statutor ose firma e auditimit duhet të raportojnë para komisionit të auditimit rreth çështjeve që shfaqen nga auditimi statutor dhe në veçanti rreth dobësive materiale në kontrollin e brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar. 5. Shtetet Anëtare mund të lejojnë ose të vendosin që dispozitat e parapara në paragrafët 1 deri në 4 të mos aplikohen ndaj subjekteve të interesit publik që ka një organ që kryen funksione relevante të një komisioni të auditimit të themeluar dhe që funksionon në bazë të dispozitave të miratuara nga Shteti Anëtar në të cilin subjekti i audituar është i regjistruar. Në atë rast, subjekti duhet të deklarojë se cili organ ka kryer këto funksione dhe si përbëhet organi. 6. Shtetet Anëtare mund të përjashtojnë obligimin për komisionin e auditimit për: (a) çdo subjekt të interesit publik që është ndërmarrje vartëse brenda kontekstit të nenit 1 të Direktivës 83/349/EEC nëse subjekti vepron në përputhje me kërkesat e paragrafëve 1 deri në 5 të këtij neni në nivel të grupit (b) çdo subjekti të interesit publik që është ndërmarrje kolektive investuese e paraparë në nenin 1(2) të Direktivës 85/611/EEC. Po ashtu, Shtetet Anëtare mund të lirojnë subjektet e interesit publik, qëllimi i vetëm i të cilave është investimi		1.5. të rekomandojë kompensimin për kryeauditorin e brendshëm; 1.6. të monitorojë pajtueshmërinë me këtë ligj dhe me rregulloret ose urdhëresat në fuqi; 1.7. të rekomandojë emërimin e auditorit të jashtëm në përputhje me nenin 54 të këtij ligji; 1.8. të monitorojë performansën e auditorit të jashtëm, të rishikojë raportin e auditorit të jashtëm rreth pasqyrave financiare të bankës dhe ta njoftojë bordin e drejtorëve për të gjitha të gjeturat; dhe 1.9. t'i japë mendime bordit të drejtorëve lidhur me çdo çështje që i është paraqitur nga bordi i drejtorëve, apo të cilën komiteti dëshiron ta adresojë. Ligji mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare po ashtu kërkon nga institucionet mikrofinanciare që të kenë një komision të auditimit i cili përfshin dhe kryesohet nga një anëtar jo-ekzekutiv i Bordit të Drejtorëve dhe së paku një anëtar i komisionit mund të jetë ekspert i jashtëm në fushën e kontabilitetit ose auditimit.
---	--	--

kolektiv i kapitalit të ofruar nga publik, të cilat operojnë mbi parimin e shpërndarjes së rrezikut dhe të cilat nuk synojnë të marrin kontrollit ligjor ose menaxhues mbi asnjë nga bërësit e investimeve në fjalë me kusht që ato ndërmarrje kolektive të investimit të jenë të autorizuar dhe i nënshtrohen mbikëqyrjes nga autoritetet kompetente dhe të kenë funksione depozitare ekuivalente me ato të parapara me Direktivën 85/611/EEC; (c) çdo subjekt të interesit publik orientimi i vetëm i të cilave është të veprojnë si lëshues i letrave me vlerë të mbështetura me asete të përcaktuara në nenin 2(5) të Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 809/ 2004 (2). Në raste të tilla, Shtetet Anëtare duhet të kërkojnë nga subjekti t'i shpjegojnë publikut arsyet për të cilat konsiderojnë se nuk është adekuate të kenë një komision të auditimit ose një organ administrativ ose mbikëqyrës të veshur me funksionet e komisionit të auditimit. (d) çdo institucion kreditor brenda kuptimit të Nenit 1(1) të Direktivës 2000/12/EC aksionet e të cilit nuk pranohen për tregtim në tregun e rregulluar të cilido Shtet Anëtar brenda kuptimit të pikës 14 të nenit 4(1) të Direktivës 2004/39/EC dhe e cila, në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur, ka lëshuar vetëm letra me vlerë të borxhit me kusht që shuma totale nominale e të gjitha letrave me vlerë të borxhit të tilla është nën 100 000 000 Euro dhe që nuk ka publikuar prospektin në bazë të Direktivës 2003/71/EC.		
---	--	--

<i>Neni 42</i> Pavarësia 1. Përveç dispozitave të neneve 22 dhe 24, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që auditorët statutor ose firmat e auditimit që kryejnë auditimin statutor të subjektit të interesit publik: (a) konfirmojnë me shkrim çdo vit para komisionit të auditimit pavarësinë e tyre nga subjekti i interesit publik të audituar (b) deklarojnë çdo vit para komisionit të auditimit çdo shërbim shtesë të ofruar për subjektin e audituar, dhe (c) diskutojnë me komisionin e auditimit kërcënimet për pavarësinë e tyre dhe masat mbrojtëse të aplikuara për zbutjen e atyre kërcënimeve të dokumentuara në bazë të nenin 22(3). 2. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që partnerët kyç të auditimit përgjegjës për bërjen e auditimit statutor të aplikojnë rotacionin nga angazhimi në auditim brenda një periudhe maksimale prej shtatë viteve nga data e emërimit dhe të lejohen të marrin pjesë në auditimin e subjektit të audituar prapë pas një periudhe prej së paku dy vitesh. 3. Auditori statutor ose partneri kyç i auditimit i cili kryen auditim statutor në emër të firmës së auditimit nuk duhet të lejohet të mbajë një pozitë kyçe menaxhues në subjektin e audituar para kalimit të një periudhe prej së paku dy vitesh nga dorëheqja e tij/saj si auditor statutor ose partner kyç i auditimit nga angazhimi në auditim.		Nuk ka referencë të tillë në Ligj. Ligji mbi Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare parasheh që Banka Qendrore mund të përshkruajë përmes një rregulloreje kërkesën për rotacion të auditorëve ose partnerëve të angazhuar të firmave të auditimit pas një periudhe specifike kohore për të siguruar pavarësi të vazhdueshme. BQK duhet të ketë autoritetin që të kërkojë heqjen ose zëvendësimin e një auditori ose që drejtpërsëdrejti të emërojë, shkarkojë ose zëvendësojë një auditor, me shpenzime të bankës për bërjen e ri-auditimit, nëse banka ose auditori nuk respekton kërkesat e këtij neni ose në rastet kur BQK nuk është e kënaqur në mënyrë të arsyeshme me performansën e auditorit.
--	--	---

<i>Neni 43</i> Sigurimi i cilësisë Shqyrtimi i sigurimit të cilësisë të referuar në nenin 29 duhet të bëhet së paku çdo tri vite nga ana e auditorëve statutor ose firmave të auditimit që bëjnë auditimet statutorë të subjekteve të interesit publik.		Ligji nuk i referohet shqyrtimit të sigurimit të cilësisë për auditorët statutor ose firmat e auditimit që kryejnë auditimet statutorë të subjekteve të interesit publik.
<i>Neni 44</i> Miratimi i auditorëve nga vendet e treta 1. Duke iu nënshtruar reciprocitetit, autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar mund të miratojnë një auditor nga një vend i tretë si auditor statutor nëse ai person ka prezantuar dëshmi që ai/ajo i plotëson kushtet ekuivalente me ato të parapara në nenet 4 dhe 6 deri në 13. 2. Autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar para miratimit të një auditori nga një vend i tretë që plotëson kërkesat e paragrafit 1 duhet të aplikojë kërkesat e parapara në nenin 14.	Neni 21 Kushtet 4. KKRF-ja përcakton kriteret të aplikueshme të licencojë auditorë të huaj që të ndërmarrin auditime në Kosovë, të cilët duhet t'i plotësojnë kërkesat minimale të të dhënave në paragrafin 1 të këtij neni.	Këshilli, si autoritet kompetent, mund të lëshojë një licencë të auditimit për auditorët e huaj nëse ata plotësojnë kërkesat.
<i>Neni 45</i> Regjistrimi dhe mbikëqyrja e auditorëve dhe subjekteve të audituara të vendeve të treta 1. Në përputhje me nenet 15 deri 17, autoritetet kompetente të një Shteti Anëtar duhet të regjistrojnë çdo auditor ose subjekt të auditimit të vendit të tretë që dorëzon një raport të auditimit në lidhje me llogaritë vjetore ose të konsoliduara të një		Nuk ka dispozitë të tillë në Ligj.

kompanie të inkuorporuar jashtë Komunitetit, letrat me vlerë të transmetueshme të së cilës janë të pranueshme për tregtim në një treg të rregulluar të atij Shteti Anëtar brenda kuptimit të pikës 14 të nenit 4(1) të Direktivës 2004/39/EC, përveç në rastet kur kompania është lëshues ekskluziv i letrave me vlerë të borxhit të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar të një Shteti Anëtar brenda kuptimit të nenit 2(1)(b) të Direktivës 2004/109/EC (1), denominimin për njësi që është së paku 50 000 euro ose në rast të letrave me vlerë të borxhit të dominuar në një valutë tjetër ekuivalente me datën e lëshimit deri në së paku 50 000 Euro. 2. Nenet 18 dhe 19 duhet të aplikohen. 3. Shtetet Anëtare duhet t'i nënshtrojnë auditorët dhe subjektet e auditimit të regjistruara në vendet e treta, sistemeve të tyre të sigurimit të cilësisë dhe sistemeve të tyre të hetimit dhe ndëshkimeve. Një Shtet Anëtar mund të lirojë një auditor ose subjekt të auditimit të regjistruar në një vend të tretë që t'i nënshtrohet sistemit të sigurimit të cilësisë nëse sistemi i sigurimit të cilësisë së vendit të tretë ose nga një Shtet Anëtar tjetër është vlerësuar si ekuivalent në përputhje me nenin 46 dhe ka bërë një shqyrtim të cilësisë së auditorit ose subjektit të auditimit në fjalë nga një vend i tretë gjatë tri viteve të kaluara. 4. Pa paragjykuar nenin 46, raportet e auditimit rreth llogarive vjetore ose të konsoliduara të referuara në paragrafin 1 të këtij neni të lëshuara nga auditorët ose subjektet e auditimit të vendeve të		KFRC mund të regjistrojë një firmë të huaj të auditimit nëse përmbush
--	--	--

treta nuk janë të regjistruara në Shtetin Anëtar nuk do të kenë fuqi ligjore në atë Shtet Anëtar. 5. Një Shtet Anëtar mund të regjistrojë një subjekt të auditimit të vendit të tretë nëse: (a) përmbush kriteret ekuivalente me ato të parapara në nenin 3(3) (b) shumica e anëtarëve të organit administrativ ose menaxhues të një subjekti të auditimit të vendit të tretë përmbush kërkesat ekuivalente me ato të parapara në nenet 4 deri në 10 (c) auditori nga një vend i tretë që kryen auditim në emër të një subjekti të auditimit nga një vend i tretë i përmbush kërkesat ekuivalente me ato të parapara në nenet 4 deri në 10 (d) auditimet e llogarive vjetore ose të konsoliduara të referuara në paragrafin 1 kryhen në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit siç është referuar në nenin 26 si dhe kërkesat e parapara në nenet 22, 24 dhe 25, ose me standardet dhe kërkesat relevante (e) publikon në uebfaqen e vet një raport vjetor të transparencës që përfshin informatat e referuara në nenin 40 ose që është në përputhje me kërkesat përkatëse të deklarimit 6. Për të siguruar aplikimin uniform të paragrafit 5(d), ekuivalenca e referuar në të duhet të vlerësohet nga Komisioni në bashkëpunim me Shtetet Anëtare dhe duhet të merret vendim nga Komisioni në përputhje me procedurën rregullative të referuar në nenin 48(2). Shtetet Anëtare mund të vlerësojnë ekuivalencën e referuar në paragrafin	Neni 21 Kushtet 5. KKRF-ja licencon firma vendore ose të huaja për auditim nëse: 5.1. ka zyrë në Kosovë; 5.2. krijon një organizatë biznesi të regjistruar në Kosovë, e cila ka të paktën dy (2) auditorë të licencuar sipas këtij ligji; 5.3. është e menaxhuar nga auditorë që janë anëtarë të një shoqate të licencuar profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve në Kosovë. 6. KKRF-ja aprovon një firmë auditimi të huaj apo vendore vetëm nëse është në përputhshmëri me ligjin mbi shoqëritë tregtare dhe biznesi është i regjistruar si: 6.1. një biznes individual me auditorin si udhëheqës; 6.2. një ortakëri e përgjithshme ose e kufizuar me të gjithë partnerët udhëheqës; 6.3. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me shumicën e të drejtave të votimit të mbajtur nga udhëheqësit kështu që, nën statutin e firmës, t'iu mundësohet partnerëve	kërkesat e parapara me Ligj. Ligji nuk kërkon nga firma që të publikojë raportin e transparencës (shih edhe komentet për nenin 3 të Direktivës).
--	---	---

5(d) të këtij neni për aq sa Komisioni nuk ka marrë vendim të tillë. Në këtë kontekst, Komisioni mund të miratojë masa me qëllim të vendosjes së kriterëve të përgjithshme ekuivalente në përputhje me kërkesat e parapara në nenet 22, 24, 25 dhe 26 të cilat janë të aplikueshme për të gjitha vendet e treta dhe të cilat duhet të përdoren nga Shtetet Anëtare gjatë vlerësimit të ekuivalencës në nivel kombëtar. Kriteret nuk mund të tejkalojnë kërkesat e parapara në nenet 22, 24, 25 dhe 26. Ato masa, të dizajnuara për të amendamentuar elementet jo-esenciale të kësaj Direktive përmes plotësimit të saj, duhet të miratohen në përputhje me procedurën rregullative me shqyrtimin e referuar në neni 48(2a).	kyç t'i drejtojnë politikat e tyre të përgjithshme apo ta ndryshojnë statutin e saj. 7. Personat të cilët janë të licencuar nga KKRF-ja si auditorë të huaj, mund të bëhen udhëheqës të një firme audituese të regjistruar në Kosovë, nëse ata mbajnë së paku shumicën e të drejtave të votimit në bordin menaxhues ose t'i mbajnë të drejtat e tilla që nën statutin e firmës iu mundëson atyre t'i drejtojnë politikat e tyre të përgjithshme apo ta ndryshojnë statutin e saj.	
<i>Neni 46</i> Përfshirja në rast të ekuivalencës 1. Shtetet Anëtare mund të mos aplikojnë ose të modifikojnë kërkesat e nenit 45(1) dhe (3) në bazë të reciprocitetit vetëm nëse auditorët ose subjektet e auditimit të vendit të tretë i nënshtrohen sistemeve të mbikëqyrjes publike, sigurimit të cilësisë dhe hetimeve dhe ndëshkimeve në vendin e tretë që janë në përputhje me kërkesat ekuivalente të neneve 29, 30 dhe 32. 2. Për të siguruar aplikimin uniform të paragrafit 1, ekuivalenca e referuar në të duhet të vlerësohet nga Komisioni në bashkëpunim me Shtetet Anëtare dhe duhet të merret vendim nga Komisioni në përputhje me procedurën rregullative të referuar në nenin		Nuk ka dispozitë të tillë në Ligj.

48(2). Shtetet Anëtare mund të vlerësojnë ekuivalencën e referuar në paragrafin 1 të këtij neni ose të mbështeten të vlerësimet e bëra nga Shtetet Anëtare tjera për aq sa Komisioni nuk ka marrë vendim të tillë. Nëse Komisioni vendos që kërkesa e ekuivalencës e referuar në paragrafin 1 të këtij neni është plotësuar, mund të lejojë auditorët dhe subjektet e auditimit të fjalë që të vazhdojnë me aktivitetet e tyre të auditimit në përputhje me kërkesat e Shtetit Anëtar relevant gjatë një periudhe adekuate tranzicionale. Në këtë kontekst, Komisioni mund të miratojë masa me qëllim të vendosjes së kriterëve të përgjithshme ekuivalente në përputhje me kërkesat e parapara në nenet 22, 24, 25 dhe 26 të cilat janë të aplikueshme për të gjitha vendet e treta dhe të cilat duhet të përdoren nga Shtetet Anëtare gjatë vlerësimit të ekuivalencës në nivel kombëtar. Kriteret nuk mund të tejkalojnë kërkesat e parapara në nenet 22, 24, 25 dhe 26. Ato masa, të dizajnuara për të amendamentuar elementet jo-esenciale të kësaj Direktive përmes plotësimit të saj, duhet të miratohen në përputhje me procedurën rregullative me shqyrtimin e referuar në neni 48(2a). 3. Shtetet Anëtare duhet t'i përcjellin Komisionit: (a) vlerësimet e tyre rreth ekuivalencës së referuar në paragrafin 2, dhe (b) elementet kryesore të aranzhimeve të tyre bashkëpunuese me sistemet e vendit të tretë të mbikëqyrjes publike, sigurimit të cilësisë dhe hetimeve e ndëshkimeve në bazë të paragrafit 1.		
--	--	--

<i>Neni 47</i> Bashkëpunimi me autoritetet kompetente të vendeve të treta 1. Shtetet Anëtare mund të lejojnë transferin e dokumenteve të punës ose dokumenteve tjera të auditimit të autoritetet kompetente të një vendi të tretë, të cilat mbahen nga auditorët statutor ose firmat e auditimit, të miratuara nga ato, me kusht që: (a) ato dokumente të punës ose dokumente tjera të auditimit ndërlidhen me auditimin e kompanive që cilat kanë lëshuar letra me vlerë në atë vend të tretë ose të cilat përbëjnë pjesë të një grupi që lëshon llogari statutorë të konsoliduara në atë vend të tretë (b) transferi bëhet përmes autoriteteve kompetente të brendshme tek autoritetet kompetente të atij vendi të tretë dhe me kërkesë të tyre (c) autoritetet kompetente të një vend të tretë në fjalë plotësojnë kushtet e deklaruara në mënyrë adekuate në përputhje me paragrafin 3 (d) ekzistojnë aranzhime të punës në bazë të reciprocitetit të miratuara ndërmjet autoriteteve kompetente në fjalë (e) transferi i të dhënave personale në një vend të tretë bëhet në përputhje me Kapitullin IV të Direktivës 95/46/EC. 2. Aranzhimet e punës të referuara në paragrafin 1(d) duhet të sigurojnë që: (a) arsyetimi për qëllimin e kërkesës për dokumente punuese ose dokumente tjera të auditimit të dorëzohet nga autoritetet kompetente		Nuk ka dispozitë të tillë në Ligj.
--	--	---

(b) personat e punësuar ose ish të punësuar nga autoritetet kompetente të vendit të tretë që pranon informatat t'i nënshtrohen obligimeve të sekretit profesional (c) autoritetet kompetente të vendit të tretë mund të përdorin dokumentet punuese dhe dokumentet tjera të auditimit vetëm për ushtrimin e funksioneve të tyre të mbikëqyrjes publike, sigurimit të cilësisë dhe hetimeve që i plotësojnë kërkesat ekuivalente me nenet 29, 30 dhe 32 (d) kërkesa nga një autoritet kompetent i një vendi të tretë për dokumente të punës ose dokumente tjera të auditimit të mbajtura nga auditori statutor ose firma e auditimit mund të refuzohen — nëse dorëzimi i atyre dokumenteve të punës do të kishte ndikim të kundërt në sovranitetin, sigurinë ose rendin publik të Komunitetit ose të Shtetit Anëtar të kërkuar, ose — nëse tanimë janë iniciuar procedura gjyqësore në lidhje me të njëjtat veprime dhe kundër personave të njëjtë para autoriteteve të Shtetit Anëtar të kërkuar. 3. Për të siguruar aplikim uniform të paragrafit 1(c), plotësimi adekuat i kushteve i referuar në të duhet të vlerësohet nga Komisioni në bashkëpunim me Shtetet Anëtare dhe Komisioni duhet të merr vendim në përputhje me procedurën rregullative të referuar në nenin 48(2). Shtetet Anëtare duhet të ndërmarrin masat e domosdoshme për respektimin e Vendimit të Komisionit. Vlerësimi i tillë i adekuat duhet të bazohet në kërkesat e nenit 36 ose		
---	--	--

rezultate funksionale ekuivalente në esencë. çdo masë e ndërmarrë në këtë kontekst, e dizajnuar për të amendamentuar elementet jo-esenciale të kësaj Direktive përmes plotësimit të saj dhe që synon të lehtësojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente duhet të miratohet në përputhje me procedurën rregullative me shqyrtimin e referuar në nenin 48(2a). 4. Në raste të jashtëzakonshme dhe përmes përjashtimit nga paragrafi 1, Shtetet Anëtare mund të lejojnë që auditorët statutor dhe firmat e auditimit të miratuara nga ato të transferojnë dokumentet e punës dhe dokumentet tjera të auditimit drejtpërsëdrejti te autoritetet kompetente të një vendi të tretë me kusht që: (a) hetimet janë nisur nga autoritetet kompetente në atë vend të tretë (b) transferimi nuk është në konflikt me obligimet me të cilat auditorët statutor dhe firmat e auditimit janë të kërkuar t'i respektojnë në lidhje me transferimin e dokumenteve të punës dhe tjera të auditimit në autoritetin kompetent të brendshëm (c) ekzistojnë aranzhime punuese me autoritetet kompetente të atij vendi të tretë që i mundëson autoriteteve kompetente në atë Shtet Anëtar qasje të drejtpërdrejt reciproke në dokumentet e punës dhe dokumente tjera të auditimit të subjekteve të auditimit të atij vendi (d) autoriteti kompetent kërkuar i vendit të tretë informon paraprakisht autoritetin kompetent të brendshëm për auditorin statutor ose firmën e		
---	--	--

auditimit për çdo kërkesë të drejtpërdrejtë për informata përfshirë arsyet për këtë, dhe (e) kushtet e referuar në paragrafin 2 janë respektuar. 5. Komisioni mund të specifikojë rastet e jashtëzakonshme të referuara në paragrafin 4 të këtij neni me qëllim të lehtësimit të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe për të siguruar zbatimin uniform të paragrafit 4 të këtij neni. Ajo masë, e dizajnuar për të amendamentuar elementet jo-esenciale të kësaj Direktive përmes plotësimit të saj, duhet të miratohet në përputhje me procedurën rregullative me shqyrtimin e referuar në nenin 48(2a). 6. Shtetet Anëtare duhet të informojnë Komisionin për aranzhimet e punës të referuara në paragrafët 1 dhe 4.		
---	--	--



Centre for Financial Reporting Reform
Europe and Central Asia Region
The World Bank

Praterstrasse 31
1020 Vienna - Austria
T: +43 (0)1 2170 - 700
F: +43 (0)1 2170 - 701
cfr@worldbank.org
www.worldbank.org/cfr